



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
“Inxhinieria e Proceseve Kimike”**

ofruar nga

“Universiteti i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Bujar DIDA

2. Prof. Asoc. Nertil XHAFERAJ

Tetor/2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieria e Proçeseve Kimike” ofruar
nga “Universiteti i Tiranës”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Kimisë Industriale
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Inxhinieria e Proçeseve Kimike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Vendimi Nr. 1225, datë 03.09.2008
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 172, datë 13.06.2023
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ETCS
11	Forma e studimit:	Kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Programi nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera.
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 i kornizës Shqiptare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021 – 2022: PAE/PAK : 12/4 2022 – 2023 : PAE/PAK : 12/4 2023 – 2024 : PAE/PAK : 11/1 2024 – 2025 : PAE/PAK : 11/0
18	Numri i studentëve:	2021 – 2022: 37 Studentë 2022 – 2023 :19 Studentë 2023 – 2024 : 28 Studentë
19	Komente / të tjera	Nuk ka




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), pas marrjes në dorëzim të raportit të vlerësimit të brendshëm dhe dokumentacionit shoqërues të përgatitur nga Departamenti i Kimisë Industriale (DKI), realizoi vizitën dyditore në Fakultetin e Shkencave të Natyrës më 07–08 maj 2025. Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi takime me drejtuesit e fakultetit dhe departamentit, stafin akademik, studentët, përfaqësues të sekretarisë mësimore, zyrës së karrierës, burimeve njerëzore, marrëdhënieve me jashtë dhe bibliotekës. Gjithashtu u inspektuan auditorët, laboratorët dhe mjediset mbështetëse për zhvillimin e programit.

1. Ofrimi i programit të studimit

Programi MSc *Inxhinieria e Proceseve Kimike* është ndërtuar në përputhje me misionin e Universitetit të Tiranës dhe objektivat akademike e profesionale të Departamentit të Kimisë Industriale (DKI). Ai synon të përgatisë specialistë me kompetenca të thelluara në projektimin, zhvillimin dhe optimizimin e proceseve kimike dhe biokimike, duke integruar dijet teorike me aftësitë praktike. Kurrikula është e harmonizuar me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (niveli 7) dhe me kërkesat e tregut të punës, si kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Programi është i organizuar në 120 ECTS, i shpërndarë në dy vite akademike, dhe garanton zhvillim të aftësive për punë kërkimore, si edhe përfshirje në projekte inovative. Ai është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë 2021–2026 dhe me strategjitë zhvillimore të UT (2018–2023; 2023–2028).

2. Organizimi, drejtimi dhe administrimi

Programi ka një strukturë të qartë organizative, ku janë përcaktuar lëndët bazë, integruese, karakterizuese dhe përmbyllëse. Drejtimi i programit bëhet nga organet e UT, FSHN dhe DKI, në përputhje me Statutin e Universitetit dhe ligjin në fuqi (Ligji 80/2015). Për procesin mësimor dhe shkencor janë ngritur komisione të posaçme në departament që mbikëqyrin përditësimin e syllabus-eve, organizimin e praktikave profesionale dhe ndjekjen e progresit të studentëve. Kujdestarët akademikë luajnë rol kyç në orientimin e studentëve gjatë gjithë ciklit të studimit. Administrata ndihmuese (sekretaria mësimore, zyra e karrierës, zyra e marrëdhënieve me jashtë) mbështet programin në mënyrë të vazhdueshme, duke siguruar përputhjen me standardet e cilësisë dhe lehtësimin e procedurave akademike.

3. Mësimdhënia, mësimnxënia dhe kompetencat

Stafi akademik i angazhuar në program përbëhet nga pedagogë me eksperiencë të gjerë akademike e kërkimore: 4 profesorë doktorë, 4 profesorë të asociuar, 2 doktorë shkencash dhe 1 kandidat për doktoratë. Ata mbulojnë fusha kyçe si termodinamika dhe kinetika e proceseve, modelimi

kompjuterik, inxhinieria e mjedisit, proceset e ndarjes dhe projektimi i impianteve kimike. Procesi mësimor ndërthur leksionet teorike me seminare, laboratorë të specializuar dhe projekte praktike. Pjesë e formimit janë edhe punët kërkimore dhe temat e diplomës që lidhen ngushtë me industrinë kimike dhe mjedisore. Vlerësimi i studentëve bazohet në parime transparence, me mundësi ankimi dhe mbështetje të plotë nga strukturat akademike.

4. Burimet njerëzore dhe infrastruktura

Programi zhvillohet në mjedise të specializuara: laboratorë të inxhinierisë kimike dhe proceseve, laboratorë të kimisë organike dhe inorganike, si dhe laboratorë informatike me softuerë për modelimin e proceseve. Pajisjet laboratorike dhe instrumentet shkencore janë të përshtatshme për kryerjen e eksperimenteve dhe praktikave, ndërkohë që infrastruktura është modernizuar për të përmbushur kërkesat e programit. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione publike dhe kompani private ofrojnë studentëve mundësi praktike profesionale dhe qasje në mjedise industriale reale. Mbështetja nga stafi ndihmës garanton organizim efikas të praktikave laboratorike dhe mirëmbajtje të mjediseve.

5. Studentët dhe mbështetja akademike

Procesi i rekrutimit të studentëve është transparent, në përputhje me kuadrin ligjor dhe kriteret e përcaktuara nga UT. Studentët informohen që në fillim për strukturën e programit, për mundësitë e mobilitetit akademik dhe për opsionet e karrierës pas diplomimit. Numri i studentëve të regjistruar ka variuar nga 19 deri në 37 në periudhën 2021–2024, duke treguar stabilitet dhe interes të vazhdueshëm. Studentët përfitojnë këshillim akademik për zgjedhjen e lëndëve dhe temave të diplomës, si dhe mbështetje nga zyra e karrierës dhe marrëdhënieve me jashtë. Ata marrin pjesë gjithashtu në praktika, projekte kërkimore dhe aktivitete të organizuara nga departamenti, duke i lidhur aftësitë e tyre me tregun e punës.

6. Sigurimi i brendshëm i cilësisë

Mekanizmat e sigurimit të brendshëm të cilësisë funksionojnë në mënyrë të qëndrueshme përmes raporteve periodike, komisioneve të departamentit dhe instrumenteve të matjes së performancës së mësimdhënies (pyetësorë studentorë, vlerësime të brendshme dhe analiza krahasimore). Studentët dhe alumni janë të përfshirë në procesin e vlerësimit përmes takimeve të rregullta dhe konsultimeve mbi përmbajtjen e programit. Përveç kësaj, bashkëpunimi i ngushtë me industrinë dhe institucionet publike siguron përshtatjen e programit me zhvillimet më të fundit shkencore, teknologjike dhe tregtare. Rezultatet e vlerësimeve përdoren për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së programeve dhe të praktikave mësimore.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u formua dhe u trajnua në përputhje me standardet dhe procedurat e përcaktuara nga ASCAL, me qëllim vlerësimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u formua dhe u trajnua në përputhje me standardet dhe procedurat e përcaktuara nga ASCAL, me qëllim vlerësimin e programit të studimit Master Profesional në “Inxhinieria e Proceseve Kimike” të ofruar nga Departamenti i Kimisë Industriale, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.

Procesi i vlerësimit përfshiu shqyrtimin e dokumentacionit të përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm dhe realizimin e vizitave në institucion më datë 07-08 Maj, 2025. Ekspertët e jashtëm të angazhuar në këtë proces ishin Prof. As. Bujar Dida dhe Prof. As. Nertil Xhaferraj, të cilët u asistuan gjatë gjithë procedurës nga përfaqësuesja e ASCAL, Znj. Denisa Bogdani.

Gjatë procesit të vlerësimit, GVJ ka përdorur katër nivele për të vlerësuar përmbushjen e standardeve të programit të studimit: (1) standardet nuk përmbushen, (2) standardet përmbushen pjesërisht, (3) standardet përmbushen kryesisht, dhe (4) standardet përmbushen plotësisht. Vlerësimi është realizuar përmes takimeve të drejtpërdrejta me Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Drejtuesin e Departamentit të Kimisë Industriale, stafin akademik dhe studentët e këtij masteri, NJSBC, zyrën e këshillimit të karrierës, zyrën e burimeve njerëzore, zyrën e marrëdhënieve me jashtë, Erasmus+ dhe të projekteve, sekretarinë mësimore dhe bibliotekën.

Për realizimin e vlerësimit të përmbushjes së kriterëve për akreditimin e programeve të studimit, GVJ ka mbështetur procesin në ligjet dhe aktet nënligjore për arsimin e lartë në Shqipëri, si dhe në informacionin e marrë nga takimet dhe dokumentacionin e ofruar nga institucioni.

Pas shqyrtimit të të gjitha të dhënave dhe informacionit të mbledhur, është hartuar një raport i vlerësimit të jashtëm, i cili është dërguar për shqyrtim nga institucioni përkatës.

Universiteti i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 09.09.2025, përmes sistemit AMS si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës Nr. 162/23 Prot., datë 10.09.2025. IAL nuk ka sjellë komente lidhur me draft-raportin sikurse parashikohen në afatet e agjendës pavarësisht njoftimeve të lëna në sistemin AMS nga ASCAL. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave i Nivelit të Dytë në “Inxhinierinë e Proceseve Kimike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Tiranës, në përputhje me misionin dhe objektivat e tij institucionalë, ofron programe studimi në të tre ciklet akademike: Bachelor, Master i Shkencave dhe Doktoratë. Këto programe janë të konceptuara për të kontribuar në zhvillimin e arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe promovimin e kulturës kombëtare. Në përputhje me Statutin e Universitetit të Tiranës dhe të Fakultetit të Shkencave Natyrore, si dhe bazuar në dokumentacionin përkatës (Evidencat 1.1, 1.2.1, 1.2.2, 1.3, 1.3.1, 1.2.3, 1.4 dhe 1.5), programet e studimit të ofruara nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Përkundrazi, ato synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare, duke reflektuar angazhimin e institucionit për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë shqiptare.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Studimit Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike” është konceptuar dhe zbatuar në përputhje të plotë me qëllimet strategjike, misionin dhe fushën e veprimtarisë akademike të Universitetit të Tiranës, siç përcaktohen në Statutin e UT. Ky program pasqyron gjithashtu objektivat specifike të Departamentit të Kimisë Industriale, të formalizuara në Rregulloren e Departamentit. Programi synon përgatitjen dhe formimin profesional të specialistëve në fushën e inxhinierisë kimike, duke respektuar standardet akademike dhe duke iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Hartimi dhe ofrimi i tij mbështetet në dokumentacionin institucional përkatës (Evidencat 1.1, 1.5 dhe 1.6), duke garantuar përputhshmërinë me misionin dhe orientimin akademik të institucionit.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregulloreve të Institucionit dhe në	Programi i Studimit Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike” është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me strategjinë e zhvillimit institucional të Universitetit të Tiranës, duke respektuar dispozitat e Statutit (Evidenca 1.1) dhe të Rregulloreve të

përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	UT (Evidenca 1.3). Ky program pasqyron misionin, vizionin dhe objektivat strategjike të universitetit, të artikuluar në Planet Strategjike për periudhat 2018–2023 dhe 2023–2028 (Evidenca 1.2.2 dhe 1.2.3), si dhe në Strategjinë Institucionale për Mësimdhënien (Evidenca 1.2.4). Në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe me nenin 71, pika 3 të Statutit të UT, programi është ndërtuar duke u mbështetur në fushat prioritare akademike të institucionit dhe në strategjinë e zhvillimit të Departamentit të Kimisë Industriale (Evidenca 1.7). Programi synon të ofrojë një formim të plotë akademik dhe profesional në fushën e inxhinierisë kimike, duke përmblusur kërkesat e tregut të punës dhe duke kontribuar në ruajtjen dhe forcimin e vlerave akademike e shkencore kombëtare (Evidenca 1.5 dhe 1.8). Struktura e programit është ndërtuar sipas standardeve më të mira të cilësisë dhe përputhet me kriteret ligjore për nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me një ngarkesë prej 120 kreditesh dhe kohëzgjatje dy vite akademike (Evidencat 1.9 dhe 1.10). Përmblajtja përfshin lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe kërkimore, duke garantuar përgatitje të avancuar teorike dhe praktike (Evidencat 1.11.1 dhe 1.11.2).
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i Studimit Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike” është konceptuar dhe zhvilluar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe strategjik të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë: <i>Ka përputhshmëri me kuadrin ligjor dhe strategjitë kombëtare:</i> • Programi mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, si dhe në Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë 2021–2026 (Evidenca 1.2.1), duke reflektuar prioritetet e zhvillimit arsimor dhe shkencor në nivel kombëtar. • Në zbatim të dokumenteve strategjike të Universitetit të Tiranës për periudhat 2018–2023 dhe 2023–2028, programi synon përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës akademike, duke adresuar sfidat dhe kërkesat e ekonomisë së tregut, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar (Evidenca 1.8, 1.8.1, 1.8.2.a,b,c). <i>Integrohet me kërkimin shkencor, inovacionin dhe zhvillimin teknologjik:</i> • Strategjia e programit orienton drejt forcimit të lidhjes ndërmjet arsimit, kërkimit shkencor dhe inovacionit, duke promovuar bashkëpunimin me sektorin privat dhe institucionet e tjera, si

	dhe duke u përshtatur me nevojat dinamike të tregut të punës dhe zhvillimit shoqëror (Evidenca 1.21). - Në këtë kontekst, Departamenti i Kimisë Industriale ka hartuar Planin Strategjik të vet (Evidenca 1.7), në përputhje me objektivat kombëtare dhe institucionale të zhvillimit. <i>Ka mbështetje institucionale dhe konkurrueshmëri globale:</i> - Bazuar në nenin 8, pika 6 të Statutit të Universitetit të Tiranës, programi kontribuon në realizimin e misionit të universitetit në fushat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke zhvilluar projekte dhe iniciativa që mbështesin zhvillimin kombëtar dhe që janë të konkurrueshme në nivel rajonal dhe global (Evidenca 1.1)
Konkluzione	<i>Programi i Studimit Master i Shkencave "Inxhinieria e Proceseve Kimike", i ofruar nga Universiteti i Tiranës, është hartuar dhe zhvilluar në përputhje të plotë me misionin, vizionin dhe strategjitë e institucionit, si dhe me kuadrin ligjor dhe strategjitë kombëtare të arsimit të lartë. Programi respekton interesat kombëtare dhe synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore shqiptare.</i> <i>Në mënyrë specifike:</i> Përputhja me Misionin dhe Fushën e Institucionit: Programi është i ndërtuar në linjë me misionin dhe objektivat strategjike të Universitetit të Tiranës dhe të Departamentit të Kimisë Industriale, duke u fokusuar në përgatitjen e specialistëve të kualifikuar në fushën e inxhinierisë së proceseve kimike. Përputhja me Strategjinë për Zhvillim: Programi respekton Statutin, Rregulloren dhe Planin Strategjik të UT për periudhat 2018–2023 dhe 2023–2028, duke garantuar zhvillimin e qëndrueshëm akademik dhe shkencor, në përputhje me fushat prioritare të institucionit. Përshtatja me Strategjitë Kombëtare dhe Prirjet Globale: Hartimi dhe zhvillimi i programit bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 dhe në Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë 2021–2026. Programi reflekton tendencat globale në kërkim, inovacion dhe teknologji, duke synuar aftësimin e studentëve për tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar. Respektimi i Kuadrit Ligjor dhe Standardeve të Cilësisë: Struktura e programit (lloji i lëndëve, kreditet, përmbajtja e syllabus-eve, projekti përmbyllës) është ndërtuar në përputhje me VKM-të përkatëse dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, duke garantuar një diplomë të njohur dhe të vlerësuar kombëtare dhe ndërkombëtare. Mbështetja në Interesin Kombëtar dhe Konsolidimin Kulturor: Përmbajtja dhe drejtimi i programit kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë së vendit, përparimin teknologjik dhe

	<i>ruajtjen e identitetit akademik shqiptar, në përputhje me interesat kombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Departamenti i Kimisë Industriale, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, dëshmon qartësisht se zotëron përvojën, kapacitetet dhe burimet e nevojshme për të ofruar me cilësi të lartë programin Master Shkencor “Inxhinieria e Proceseve Kimike”, në përputhje të plotë me fushën akademike të programit. Programi mbështetet nga një staf akademik i kualifikuar me ekspertizë të thelluar në inxhinieri kimike, i përbërë nga: 4 Profesorë Doktor 4 Profesorë të Asociuar 2 Doktorë Shkencash 1 kandidat për doktoratë Titullarët e lëndëve mbulojnë fusha kyçe të disiplinës, si: - Modelimi dhe simulimi i proceseve kimike - Proceset e ndarjes - Inxhinieria kimike mjedisore - Projektimi i impianteve Kualifikimet dhe përputhshmëria me fushën akademike janë të dokumentuara në evidencat përkatëse (Evidenca 2.26, 2.6). Programi mbështetet edhe nga kontributi i stafit ndihmës të specializuar për zhvillimin e punëve laboratorike, siç dokumentohet në (Evidenca 2.33). Per bashkëpunime akademike dhe me industrinë Departamenti angazhon profesorë të ftuar dhe lektorë me përvojë të gjerë në industrinë dhe akademinë e inxhinierisë kimike, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. (Evidenca 2.37, 3.4, 1.21). Në bazë të të gjitha evidencave të paraqitura, institucioni demonstroi se ka kapacitetet e duhura akademike, përvojën profesionale dhe burimet njerëzore për të ofruar programin Master “Inxhinieria e Proceseve Kimike” në përputhje me standardet e kërkuara.

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësish kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) në Universitetin e Tiranës ofron aktualisht 42 programe studimi në ciklin e parë dhe të dytë, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë disiplinash shkencore, duke përfshirë njohuri bazë dhe të avancuara, teorike dhe praktike. Këto programe janë të orientuara drejt fushave prioritare akademike të njësish kryesore dhe përputhen me orientimin strategjik të vetë Universitetit të Tiranës (Evidenca 1.1, 1.5, 1.9). Programi Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike” është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të FSHN-së, si dhe me fushën e veprimtarisë së Departamentit të Kimisë Industriale, që është njësia përgjegjëse për zbatimin e tij. Disiplina që mbulon ky program janë të klasifikuara sipas standardeve dhe kodifikimeve kombëtare dhe evropiane për programet e ciklit të dytë në fushën e inxhinierisë kimike (Evidenca 1.5, 1.14). Stafi akademik i angazhuar në program zotëron ekspertizë të thelluar në fushat specifike të inxhinierisë kimike dhe disiplinave të ndërlidhura, duke siguruar koherencë të plotë ndërmjet përmbajtjes kërkimore, mësimdhënies dhe strukturës akademike të programit (Evidenca 1.14). Programi është ndërtuar në përputhje me parimet e organizimit akademik, duke respektuar shpërndarjen e krediteve në aktivitetet formuese dhe duke garantuar cilësinë sipas udhëzimeve kombëtare dhe direktivave evropiane për arsimin e lartë. Ai përmbush standardet e ASCAL dhe të Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (Evidenca 1.9, 1.11.1, 1.18, 1.19). Nëpërmjet këtij programi, studentët fitojnë njohuri të thelluara në fushat kryesore të inxhinierisë kimike, duke ndërtuar një bazë solide për vazhdimin e studimeve në nivelin e doktoratës, brenda ose jashtë vendit. Programi gjithashtu ofron perspektiva reale punësimi në institute kërkimore dhe kompani kombëtare e ndërkombëtare, duke dëshmuar lidhjen funksionale ndërmjet përmbajtjes akademike dhe nevojave të tregut të punës (Evidenca 2.36).
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësish bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë	Programi i Studimit Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike” zhvillohet brenda fushës akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në përputhje të plotë me veprimtarinë e Departamentit të Kimisë Industriale, që është njësia bazë përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e tij (Evidenca 2.36). Ky përcaktim mbështetet në nenin 25, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë, ku roli i departamentit si njësi bazë për mësimdhënie dhe kërkim shkencor është qartësisht i përcaktuar.

bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i përket ciklit të dytë të studimeve dhe është i klasifikuar në nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (Evidenca 1.1), duke siguruar përputhje të plotë ndërmjet fushës së programit dhe fushës akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse. Ai nuk është program ndërdisiplinor, por i specializuar brenda fushës së inxhinierisë kimike, në përputhje me profilin shkencor të Departamentit të Kimisë Industriale dhe orientimin akademik të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Struktura e programit është ndërtuar sipas udhëzimeve kombëtare për organizimin akademik, duke përfshirë: - Veprimtari të formimit bazë - Veprimtari karakterizuese - Disiplina ndërdisiplinore/integruese (lëndë me zgjedhje) - Veprimtari plotësuese - Detyrime përmbyllëse (Evidenca 1.9; Evidenca 1.11.1) Kohëzgjatja e programit është dy vite akademike, me një ngarkesë totale prej 120 kreditesh ECTS. Pas përmbushjes së kërkesave akademike, studentët diplomohen me titullin Master i Shkencave në "Inxhinierinë e Proceseve Kimike" (Evidenca 1.10.3; Evidenca 1.20; Evidenca 1.10.4).
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	N/A
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Universiteti i Tiranës, në kuadër të zhvillimit profesional të studentëve dhe të diplomuarve, ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore, kërkimore dhe ndërmarrje private, duke fuqizuar veprimtarinë akademike dhe praktike të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN). (Evidenca 5.19–5.22) Në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (Ligji Nr. 23/2018), FSHN bashkëpunon ngushtësisht me sektorin privat dhe institucionet kërkimore për të ofruar trajnime profesionale dhe praktika për studentët dhe të diplomuarit. (Evidenca 1.21–1.22) Ky bashkëpunim siguron ndërthurje efektive mes arsimit dhe tregut të punës, ku punëdhënësit kontribuojnë në organizimin e praktikave, trajnimeve dhe seminareve. (Evidenca 1.22.1–1.22.5) Aktivitetet si workshop-e, leksione të hapura, simpoziume dhe konferenca zhvillohen rregullisht në FSHN, duke përmirësuar

	formimin profesional dhe orientimin praktik të studentëve. (Evidenca 1.23–1.24.3) Studentët e diplomuar ruajnë lidhje aktive me institucionin, duke marrë pjesë në projekte kërkimore dhe konferenca, çka mundëson zhvillim të vazhdueshëm profesional edhe pas diplomimit. (Evidenca 1.25–1.25.3)
Konkluzione	<i>Përputhja me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore:</i> programi i studimit "Inxhinieria e Proceseve Kimike" është plotësisht në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe, si një program ndërdisiplinor, siguron bashkëpunim me njësitë e tjera të përshtatshme. Ky bashkëpunim përforcon përshtatshmërinë e programit me kërkesat kombëtare dhe evropiane dhe mundëson integrimin e disiplinave të ndryshme të inxhinierisë kimike për të ofruar një bazë të fortë akademike dhe profesionale. <i>Koherenca e fushës akademike dhe kërkimore me kriteret e kualifikimit:</i> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe kërkesat evropiane. Ky përputhshmëri siguron se programi ofron një edukim të kualifikuar dhe të kërkuar nga tregu, i cili mundëson zhvillimin e njohurive të thelluara dhe aftësive profesionale që janë thelbësore për studentët që duan të kontribuojnë në kërkimin shkencor dhe industrinë kimike. <i>Bashkëpunimi me punëdhënësit dhe mundësitë për trajnime profesionale:</i> evidenton angazhimin e Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës për të krijuar mundësi trajnimi praktike dhe profesionale në bashkëpunim me sektorin privat dhe institucionet kërkimore. Ky bashkëpunim kontribuon në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve dhe në mundësitë e tyre për punësim, duke forcuar lidhjet ndërmjet akademisë dhe tregut të punës. <i>Përkushtimi ndaj zhvillimit të studentëve edhe pas diplomimit:</i> Universiteti ofron mundësi vazhdimi të trajnimeve dhe aktiviteteve shkencore edhe pas diplomimit përmes angazhimit të studentëve në konferenca dhe projekte kërkimore. Ky angazhim vazhdon të sigurojë zhvillimin e aftësive profesionale të të diplomuarve dhe mundëson lidhje të qëndrueshme me institucionin dhe stafin akademik. Në përfundim, programi i studimit "Inxhinieria e Proceseve Kimike" është i strukturuar në përputhje me kërkesat e arsimit të lartë dhe të tregut të punës, duke ofruar mundësi të thelluara për zhvillimin e aftësive akademike dhe profesionale të studentëve dhe të diplomuarve.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda Universitetit të Tiranës (UT) rregullohen nga Statuti dhe Rregullorja, duke siguruar funksionimin efektiv të programeve përmes ndarjes së qartë të detyrave dhe përgjegjësi ndërmjet njësive akademike (Evidenca 1.1). Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN), Dekanati koordinon oraret, ngarkesat mësimore dhe bashkërendimin ndërdepartamental për lëndët e përbashkëta (Evidenca 1.26). Ai miraton kuotat, kriteret e pranimit dhe propozimet për programet, të cilat i përcjell Senatit Akademik (Evidenca 1.27–1.28). Për çdo program emërohet një kujdestar akademik, përgjegjës për përditësimin e syllabuseve dhe mbikëqyrjen e përmbajtjes mësimore (Evidenca 1.29–1.30). Në Departamentin e Kimisë Industriale, komisione ad hoc menaxhojnë procedura si transferimet, diplomimet dhe kërkesat buxhetore (Evidenca 1.31–1.34). Zëvendës Dekani për kërkimin shkencor koordinon raportimin e veprimtarisë akademike dhe kërkimore, e cila pasqyrohet në raportet vjetore të fakultetit dhe universitetit (Evidenca 1.35). Studentët përfaqësohen përmes këshillave studentore dhe marrin pjesë në vendimmarrje institucionale. UT ka ngritur gjithashtu një Komision të posaçëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe marrëdhëniet me studentët, duke garantuar komunikim të vazhdueshëm dhe përfshirje aktive (Evidenca 1.36–1.37).
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë (neni 3, pika 4, c), që garanton të drejtën për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendase dhe të huaja, programi i studimit Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike” realizon objektivat e tij akademikë dhe kërkimorë përmes bashkëpunimit të gjerë ndërinstitucional (Evidenca 1.2; 1.21). Universiteti i Tiranës (UT) ka nënshkruar 42 marrëveshje në kuadër të Erasmus+ KA107 gjatë periudhës 2019–2024, duke vendosur

	marrëdhënie me mbi 100 universitete jashtë vendit (Evidenca 1.48). Këto marrëveshje përfshijnë shkëmbime akademike, projekte të përbashkëta kërkimore, trajnime dhe mobilitet të stafit dhe studentëve. Në kuadër të bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, Departamenti i Kimisë Industriale (DKI) është përfshirë në projekte si NETCHEM (ICT në arsimin e kimisë analitike) (Evidenca 1.38.1), projektin “NanoAlb Ignite” për zgjidhje inovative gjatë pandemisë (Evidenca 1.38.2), si dhe në projekte të financuara nga programe ndërkufitare si INTERREG dhe PHAREM për trajtimin e ujërave të ndotura spitalore (Evidenca 1.38.3). Bashkëpunimet e tjera përfshijnë partneritet me Universitetin e Hohenheim (Gjermani) në fushën e përpunimit bimor (Evidenca 1.38.4), projekte në fushën e energjive të rinovueshme (Evidenca 1.38.5), valorizimin e mbetjeve ushqimore për bioenergjji (Evidenca 1.38.6), lidhësit gjeopolimerikë dhe materiale të qëndrueshme ndërtimi (Evidenca 1.38.7; 1.38.8), cilësinë e ajrit në mjediset urbane (Evidenca 1.38.9), dhe shkollat verore ndërkombëtare GEM-SILKWAY (Evidenca 1.38.10). DKI gjithashtu ka bashkëpunuar me institucione kombëtare si Albanian University në projektin për vlerësimin e ndotjes së ajrit të brendshëm në shkolla 9-vjeçare në Shqipëri, financiar nga AKKSHI (Evidenca 1.38.11).
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Edhe pse Programi Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike” nuk përfshin praktikën e detyruar në kurrikulë, Fakulteti dhe Universiteti kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione e kompani për zhvillimin e praktikave mësimore në programet e Ciklit të Dytë (Evidenca 1.22; 1.35). Studentët e vitit të dytë kryejnë një praktikë të organizuar 1–2 javore në terren, zakonisht në muajin qershor, me qëllim njohjen me mjedisin industrial dhe lehtësimin e integritetit të tyre në tregun e punës. Gjithashtu, disa studentë zhvillojnë praktika individuale nëpërmjet lejes institucionale pranë industrive të ndryshme (Evidenca 2.26).
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Kimisë Industriale përgatit periodikisht raporte analitike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, të integruara në raportin vjetor të analizës së departamentit dhe të diskutuara në mbledhjet përkatëse (Evidenca 1.35, 1.39, 1.40). Këto raporte vlerësojnë mobilitetet hyrëse dhe dalëse të stafit akademik, shpërndarjen e eksperiencave të fituara si dhe ndikimin në

	zhvillimin e kërkimit shkencor dhe përmirësimin e procesit mësimor.			
Konkluzione	1. Marrëdhëniet e brendshme institucionale Institucioni siguron funksionimin e programit nëpërmjet ndarjes së detyrave dhe bashkëpunimit ndërmjet njësive akademike e administrative, me analiza periodike të punës dhe përfshirjen e studentëve nëpërmjet këshillave studentore dhe strukturave institucionale (Evidenca 1.1–1.37). 2. Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar për objektivat formues Programi realizon objektivat e tij akademike dhe kërkimore nëpërmjet marrëveshjeve me universitete, institute dhe kompani brenda e jashtë vendit, përmes mobilitetit, projekteve të përbashkëta dhe aktiviteteve të përbashkëta me partnerë (Evidenca 1.2, 1.21, 1.35, 1.38). 3. Praktikrat profesionale dhe lidhja me tregun e punës Megjithëse praktika nuk është pjesë e detyruar e kurrikulës, studentët zhvillojnë praktikë të organizuar në terren dhe në industrinë përkatëse nëpërmjet marrëveshjeve të nënshkruara nga fakulteti dhe universiteti (Evidenca 1.22, 1.35, 2.26). 4. Vlerësimi i përfitimeve nga bashkëpunimet Njësia përkatëse harton raporte vjetore që analizojnë përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, si mobiliteti, shkëmbimi i eksperiencës dhe ndikimi në cilësinë e procesit mësimor e kërkimor (Evidenca 1.35, 1.39, 1.40).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i Studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri të Proceseve Kimike” është një program i ciklit të dytë, me kohë të plotë, i klasifikuar në nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe i koduar 72MS0711SH (Evidenca 2.1.1). Ai zbatohet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) (Evidenca 2.1). Struktura e programit është ndërtuar sipas VKM-ve përkatëse (nr. 41/2018, nr. 879/2019, nr. 185/2021) dhe përmban 120 kredite ECTS, të shpërndara në dy vite akademike me një ngarkesë totale prej 3000 orësh (Evidenca 1.3, 1.9). Orët ndahen si më poshtë: - Viti I: 720 orë në auditor / 780 jashtë auditorit - Viti II: 615 orë në auditor / 885 jashtë auditorit Programi përfshin pesë grupe veprimtarish formuese (Evidenca 1.1, 1.9, 2.2) dhe 120 kredite gjithsej: <table border="1" data-bbox="662 929 1300 1176"> <thead> <tr> <th>Veprimtaria Formuese</th><th>Kredite</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Lëndë Bazë</td><td>6</td></tr> <tr> <td>Lëndë Karakterizuese</td><td>66</td></tr> <tr> <td>Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese</td><td>13</td></tr> <tr> <td>Lëndë Plotësuese</td><td>5</td></tr> <tr> <td>Detyrime Përmbyllëse (Tezë Diplome)</td><td>30</td></tr> </tbody> </table> Të gjitha lëndët janë të dokumentuara në syllabus, kurrikulën përmbledhëse dhe planin mësimor (Evidenca 1.9, 1.10.1, 1.10.2). Tipologjia e lëndëve, orët mësimore dhe mënyra e vlerësimit janë të përcaktuara qartë për çdo semestër. Programi hartohet nga Universiteti dhe miratohet nga Senati Akademik (Evidenca 1.5). Në përfundim, studentët mbrojnë diplomën dhe pajisen me titullin “Master i Shkencave në Inxhinieri të Proceseve Kimike” dhe Suplementin e Diplomës (Evidenca 1.10.4). Ndryshimet në strukturë lejohen deri në 20%, me miratim institucional (Evidenca 2.3.1.1).	Veprimtaria Formuese	Kredite	Lëndë Bazë	6	Lëndë Karakterizuese	66	Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese	13	Lëndë Plotësuese	5	Detyrime Përmbyllëse (Tezë Diplome)	30
Veprimtaria Formuese	Kredite												
Lëndë Bazë	6												
Lëndë Karakterizuese	66												
Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese	13												
Lëndë Plotësuese	5												
Detyrime Përmbyllëse (Tezë Diplome)	30												
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale,	Programi i studimit "Master Shkencor në Inxhinieri të Proceseve Kimike" synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të vepruar në një spektër të gjerë profesionale të lidhura me industrinë kimike, përpunuese, ushqimore dhe ambientale. Programi ofron njohuri të thelluara teorike dhe praktike, të cilat lidhen ngushtë me kërkesat bashkëkohore të tregut të punës dhe kërkimit shkencor (Evidenca 1.6, 1.7, 1.8, 1.35). Në përputhje me nivelin 7 të KSHK-së dhe standardet e BE-së, ky program i ciklit të dytë i pajis studentët me njohuri të avancuara në												

të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	fushën e proceseve kimike dhe aftësi për të kuptuar në mënyrë kritike teoritë dhe parimet shkencore e inxhinierike (Evidenca 1.10, 1.10.1, 1.10.4). Ai përfshin analiza të thelluara të proceseve të transportit, kinetikës dhe katalizës, projektimit dhe optimizimit të impianteve, si dhe përdorimin e software-ve inxhinierike për modelim e simulim të proceseve industriale (Evidenca 1.6, 1.10.1, 1.13.2). Studentët aftësohen për të zgjidhur probleme komplekse dhe të paparashikueshme përmes eksperiencës laboratorike, punës në grup dhe projekteve me fokus praktik e kërkimor (Evidenca 1.10.1, 1.13.1, 1.13.2). Laboratorët modernë dhe marrëveshjet me aktorë institucionalë e privatë krijojnë një ambient zhvillimi të plotë profesional dhe aplikativ (Evidenca 1.13.1, 1.22, 1.35). Programi përgatit inxhinierë kimistë të aftë për të punuar në: • industri prodhuese dhe përpunuese, • laboratorë kërkimorë e kontrolli cilësie, • institucione publike, bashki e struktura mjedisore (Evidenca 1.7, 1.8, 1.10). Përmbajtja e çdo moduli (syllabuset) është e ndërtuar për të siguruar kompetenca të avancuara, me literaturë bashkëkohore dhe metodologji mësimore që synojnë zhvillimin e pavarur të studentëve në nivel kërkimor dhe aplikativ (Evidenca 1.10.1, 2.25).
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i Studimit Master Shkencor në Inxhinierinë e Proceseve Kimike ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse. Praktika profesionale është një komponent kyç i programit, duke ofruar mundësi për zhvillimin e aftësive kërkimore dhe mësimore përmes seancave laboratorike, të cilat janë një pjesë e rëndësishme e orëve të programit. Gjatë këtyre orëve, studentët përvetësojnë aftësi eksperimentale dhe praktike, duke aplikuar teoritë dhe metodat që përpunohen në leksione dhe seminare (Evidenca 2.3, 2.3.1, 2.3.2, 1.9, 2.22). Për trajnime të mëtejshme, Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme për praktika profesionale dhe internship-e (Evidenca 1.21, 1.22, 2.5). Studentët mund të realizojnë praktika profesionale me kompani si Balkan Finance Investment Group dhe në industri të tilla si “Gjergj Kastrioti”, “Stela”, etj. (Evidenca 1.21). Detyrimi përmbyllës i diplomës ka 300 orë mësimore dhe 30 kredite, ku studentët udhëhiqen për punime aplikative dhe eksperimentale, me fokus në industrinë kimike në Shqipëri (Evidenca 1.9).

	Në përfundim të programit, studentët fitojnë diplomën "Master i Shkencave në Inxhinieri të Proceseve Kimike". Mbrojtja e diplomës zhvillohet në sezonet e përcaktuara nga Dekanati.
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	N/A
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N/A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	N/A




Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i Studimit “Master në Inxhinieri të Proceseve Kimike” i Fakultetit të Shkencave të Natyrës është i harmonizuar me programet e ngjashme të ciklit të dytë që ofrohen në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, duke respektuar kërkesën që përmbajtja të jetë të paktën 70% e ngjashme (Evidenca 2.4, 2.39). Në nivel kombëtar, program i ngjashme ofrohet nga Universiteti Politeknik i Tiranës (Bachelor në Inxhinieri Kimike) Në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet evropiane, programet e ciklit të dytë garantojnë kualifikim të barabartë për studentët (Evidenca 1.10.2). Pranimi për degë të dytë realizohet nga komisione ad hoc, të cilat vlerësojnë ngjashmërinë e krediteve dhe përmbajtjes akademike (Evidenca 2.39). Ndërkombëtarizimi luan rol kyç në harmonizimin e strukturave akademike dhe në nxitjen e mobilitetit profesional. Programe të ngjashme ndërkombëtare ofrohen nga Universiteti i Prishtinës, Universiteti Teknik i Danimarkës, Imperial College London (Evidenca 2.41, 2.50). Këto programe mbulojnë lëndë thelbësore si termodinamika kimike, dinamikat e proceseve dhe optimizimi i proceseve industriale, duke siguruar përputhje tematike dhe metodologjike.
Kriteri 8.Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i Studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri të Proceseve Kimike” në Universitetin e Tiranës është kodifikuar sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve zyrtare të publikuara nga Ministria e Arsimit, në përputhje me Udhëzimin Nr. 31, datë 15.11.2022 “Për procedurat e kodifikimit të programeve të studimit” (Evidenca 2.1.1). Programi mban kodin unik 72MS0711SH, i cili pasqyron ciklin, fushën dhe nivelin e kualifikimit. Fakulteti i Shkencave të Natyrës është njësia përgjegjëse për zbatimin e procedurave të kodifikimit, në përputhje me rregulloret e UT dhe udhëzimet e MAS. Programi i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (Ligji Nr. 23/2018) (Evidenca 1.9), dhe lëndët e tij janë të kodifikuara sipas strukturës së përcaktuar në Udhëzimin Nr. 41 (24.01.2018) dhe VKM Nr. 185 (25.03.2021) (Evidenca 2.22; 1.10.2), duke përfshirë: - Lëndë Bazë - Lëndë Karakterizuese - Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese - Lëndë Plotësuese

	- Detyrime Përmbyllëse			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N/A			
Konkluzione	1. Përmbajtja dhe Standardizimi i Programeve të Studimit: Programet e studimit të ciklit të dytë Master janë hartuar dhe strukturuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke siguruar përmbajtje dhe nivel të ngjashëm me programe të tjera ndërkombëtare. Kjo ndihmon në harmonizimin e cilësisë dhe përgatitjes profesionale të studentëve, duke lehtësuar mobilitetin akademik dhe profesional (Evidenca 2.4, 2.41, 2.39). 2. Kodifikimi i Programeve dhe Lëndëve: Kodifikimi i programeve të studimit dhe lëndëve është realizuar në përputhje me udhëzimet dhe rregulloret përkatëse të Ministrisë së Arsimit, duke siguruar identifikimin e qartë të fushave të studimit dhe klasifikimin e lëndëve sipas standardeve të njohura. Ky proces siguron që struktura e programit të jetë e organizuar dhe e përshtatshme me kërkesat e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (Evidenca 1.11.1, 1.11.2, 1.11.3). 3. Përgatitja e Studentëve dhe Ndërkombëtarizimi: Programet e studimit të ciklit të dytë janë të dizajnuara për të siguruar një formim të lartë akademik dhe praktik, duke i ofruar studentëve mundësi për t'u përfshirë në trajnime dhe praktika profesionale të nivelit të lartë. Ndërkombëtarizimi dhe përputhshmëria e programeve të studimit me praktikat dhe kërkesat ndërkombëtare kontribuojnë në rritjen e konkurrencës dhe vlefshmërisë së diplomave në tregun global (Evidenca 2.50, 2.41, 1.9, 2.39). 4. Qasja e Integruar dhe Evaluimi i Programit: Me një strukturë të qartë dhe kodifikim të përshtatshëm, programi siguron që lëndët dhe aktivitete akademike të jenë të lidhura ngushtë me nevojat e industrisë dhe kërkesat e tregut të punës. Procedurat e transferimit të studentëve dhe ekuivalentimi i krediteve ndihmojnë në ruajtjen e cilësisë dhe standardeve të përbashkëta mes programeve të ndryshme studimi, duke garantuar një nivel të lartë të përgatitjes dhe aftësive profesionale për studentët (Evidenca 1.9, 2.39, 2.18, 1.14).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																				
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe me Statutin e Universitetit të Tiranës (Evidenca 1.1). Fakulteti përbëhet nga 8 departamente dhe një qendër kërkimore dhe ofron programe studimi në ciklet e parë, të dytë dhe të tretë (Evidenca 1.12). Fakulteti përbëhet nga 8 departamente dhe një qendër kërkimore: - Departamenti i Biologjisë; - Departamenti i Bioteknologjisë; - Departamenti i Fizikës; - Departamenti i Informatikës; - Departamenti i Kimisë; - Departamenti i Kimisë Industriale; - Departamenti i Matematikës; - Departamenti i Matematikës Së Aplikuar; - Qendra Kërkimore e Florës & Faunës. Strukturat akademike dhe organizative miratohen nga Rektorati dhe Senati i Universitetit të Tiranës (Evidenca 2.17). FSHN realizon misionin e tij përmes aktiviteteve mësimore dhe kërkimore, duke garantuar një infrastrukturë të përshtatshme dhe punësimin e personelit akademik sipas kërkesave ligjore (Evidenca 1.13, 1.13.1). Departamenti i Kimisë Industriale ka akredituar dy programe të ciklit të parë dhe ka marrë vlerësim pozitiv për to (Evidenca 2.12; Vendimi BA Nr. 141, 142 datë 24.11.2023). Programet e studimit dhe aktivitetet e FSHN përputhen me ligjin dhe akreditimet përkatëse (Evidenca 2.5). <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>3</td><td>2</td><td>3</td><td>2</td><td>4</td><td>-</td></tr></table>	Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	3	2	3	2	4	-
Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024																
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK															
Prof.Dr.	3	2	3	2	4	-															

	<table><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>4</td><td>2</td><td>4</td><td>2</td><td>3</td><td>2</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>10</td><td>3</td><td>10</td><td>3</td><td>9</td><td>3</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>2</td><td>4</td><td>2</td><td>6</td><td>1</td><td>3</td></tr><tr><td>Totali</td><td>19</td><td>11</td><td>19</td><td>13</td><td>17</td><td>8</td></tr></table>	Prof. Asoc.	4	2	4	2	3	2	Dr./PhD.	10	3	10	3	9	3	Msc.	2	4	2	6	1	3	Totali	19	11	19	13	17	8
Prof. Asoc.	4	2	4	2	3	2																							
Dr./PhD.	10	3	10	3	9	3																							
Msc.	2	4	2	6	1	3																							
Totali	19	11	19	13	17	8																							
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës, si njësi kryesore, dhe Departamenti i Kimisë Industriale, si njësi bazë, përmbushin detyrimet ligjore në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, duke angazhuar personel ndihmës akademik dhe administrativ për realizimin e praktikave mësimore dhe laboratorike (Evidenca 1.16, 2.11). Struktura organizative e FSHN përfshin njësi mbështetëse si dega IT dhe dega mësimore për të garantuar funksionimin efektiv të programeve të studimit (Evidenca 1.12, 2.33, 2.34). Në përbërje të Departamentit të Kimisë Industriale janë 4 staf ndihmës akademik me karakter mësimor dhe 1 staf administrativ, të gjithë me arsim të lartë në fusha përkatëse dhe me përvojë të gjatë në laboratorë dhe aktivitete mbështetëse për mësimdhënie dhe kërkim shkencor (Evidenca 1.16, 2.7 Tabela 2 ASCAL).																												
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Kimisë Industriale, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master në Inxhinieri e Proceseve Kimike, ka caktuar një koordinatör programi në përputhje me Rregulloren e UT dhe atë të Departamentit (Evidenca 1.3; 1.5). Koordinator, që njëkohësisht është edhe Përgjegjës i Departamentit, është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit, si dhe për mbikëqyrjen e praktikave profesionale dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë (Evidenca 1.5; 2.30; 2.31; 2.32). Në mbështetje të tij, veprojnë përgjegjës të grupeve mësimor-kërkimore të cilët bashkëpunojnë në hartimin dhe zbatimin e ngarkesës mësimore dhe kërkimore (Evidenca 2.12; 2.13; 2.14). Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron gjithashtu strukturë mbështetëse, përfshirë kujdestarë studentësh dhe zëvendës dekanë të specializuar për kurrikulat, kërkimin shkencor dhe ciklin e tretë (Evidenca 1.1; 1.29).																												
Konkluzione	<i>1. Përmbushja e detyrimeve ligjore për personelin ndihmës akademik dhe administrativ: Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Kimisë Industriale përmbushin në mënyrë të plotë detyrimet ligjore duke angazhuar personel të kualifikuar ndihmës akademik dhe administrativ për mbështetjen e praktikave mësimore, laboratorike dhe veprimtarive të tjera. Stafi ndihmës ka formim të përputhshëm</i>																												

	me programin dhe përvojë të gjatë profesionale (Evidenca 1.16; 2.11; 2.7). 2. Struktura organizative dhe mbështetëse: Departamenti operon në një strukturë të mirë organizuar dhe të qartë, ku përveç personelit ndihmës, përfshihet edhe personeli administrativ i FSHN (IT, dega mësimore, etj.), duke garantuar mbështetje efektive në zbatimin e programit të studimit (Evidenca 1.12; 2.33; 2.34). 3. Caktimi i koordinatorit të programit të studimit: Për çdo program studimi, Departamenti cakton një koordinator përgjegjës për ecurinë, cilësinë dhe zhvillimin e programit. Për programin Master në Inxhinieri e Proceseve Kimike, roli i koordinatorit përmbushet nga Përgjegjësi i Departamentit, në përputhje me aktet rregulluese të UT dhe ligjin për arsimin e lartë (Evidenca 1.1; 1.3; 1.5). 4. Mbikëqyrja dhe zhvillimi i programeve dhe praktikave: Koordinatorit dhe përgjegjësit e grupeve mësimor-kërkimore planifikojnë dhe ndjekin zbatimin e ngarkesës mësimore dhe kërkimore. Përmes analizave vjetore dhe raportimeve, sigurohet cilësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm i programit (Evidenca 1.5; 2.13; 2.14; 2.15). 5. Roli mbështetës i fakultetit dhe strukturave të tjera: Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron mbështetje institucionale përmes kujdestarëve të studentëve dhe tre zëvendës dekanëve të specializuar për kurrikulat, kërkimin shkencor dhe ciklin e tretë të studimeve, duke garantuar ndërlidhjen e qëndrueshme ndërmjet veprimtarive mësimore dhe atyre zhvillimore (Evidenca 1.1; 1.29).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Kimisë Industriale, si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave "Inxhinieri e Proceseve Kimike", disponon informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të përmbledhur si më poshtë: Korniza institucionale dhe rregullatorë: Statuti i Universitetit të Tiranës (Evidenca 1.1), Rregullorja e UT (Evidenca 1.3), Rregullorja e Departamentit të Kimisë

	Industriale (Evidenca 1.5), Rregullorja e Programit të Studimit (Evidenca 1.6). • Plani mësimor dhe organizimi i programit: Plani i programit të studimit është hartuar dhe strukturuar sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 dhe VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 (Evidenca 1.9; 2.20; 1.11.3). Programi përmban ndarjen në vite, semestra dhe kreditimin sipas ECTS (Evidenca 1.9, Evidenca 2.19 – Tabela 4 ASCAL). • Struktura e lëndëve: Lëndët janë të ndara sipas veprimtarive formuese: lëndë bazë (1), karakterizuese (12), ndërdisiplinore integruese (1), me zgjedhje (4), plotësuese (1) (Evidenca 1.9; 2.2 – Tabela 9 ASCAL; Evidenca 2.20). • Programet e lëndëve (syllabus-et): Të hartuara dhe nënshkruara nga titullarët përkatës, të formatuara sipas VKM-ve përkatëse (Evidenca 1.10.1; 1.11.1; 1.11.2; 1.11.3). • Personeli akademik dhe burimet njerëzore: Evidencuar në Evidenca 1.14; 1.17; 2.6. • Kriteret e pranimit dhe përfundimi i studimeve: Evidenca mbi kriteret e pranimit (Evidenca 1.28) dhe modeli i diplomës dhe suplementit (Evidenca 1.10.4). • Rregullimi i veprimtarive formuese: Programi përfshin aktivitete mësimore në auditor dhe studim individual, me ndarje të qartë të orëve të leksioneve, seminareve, ushtrimeve dhe laboratorëve për secilën lëndë, sipas rregullores së departamentit (Evidenca 1.6; 1.9; 1.10). • Përmirësimi i vazhduar: Raportet ndërmjet veprimtarive formuese janë përmirësuar në përputhje me VKM Nr. 41 dhe ndryshimet e saj (Evidenca 1.6; 1.11.1).
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i Studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri të Proceseve Kimike” përmban planin mësimor (Evidenca 1.9) dhe syllabus-et përkatëse (Evidenca 1.10.1), ku pasqyrohet ndarja semestrale e lëndëve, ngarkesa mësimore dhe mënyrat e vlerësimit. Ngarkesa mësimore është e strukturuar sipas standardeve kombëtare dhe përfshin: - Orë në auditor (leksione, seminare, laboratorë, vlerësim i vazhduar): 1335 orë- Viti I: 720 orë dhe - Viti II: 615 orë (Evidenca 1.9; 2.21; 2.22; 1.6) - Orë jashtë auditorit (përgatitje, detyra kursi, punime diplome): 1665 orë- Viti I: 780 orë, - Viti II: 885 orë (Evidenca 1.6; 1.9) - Ngarkesa javore mesatare: 20–25 orë (Evidenca 1.9)

	Vlerësimi i studentëve përfshin pjesëmarrjen aktive (5–10%) dhe provimin përfundimtar me shkrim, sipas përcaktimeve në syllabus-et përkatëse (Evidenca 1.10.1; 2.17).
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit Master në “Inxhinieri e Proceseve Kimike” përmban informacion të plotë për kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Pranimi realizohet në bazë të Ligjit Nr. 80/2015, udhëzimeve vjetore të MAS, Rregullores së Universitetit të Tiranës dhe Rregullores së Programit të Studimit (Evidenca 1.3; 1.6; 1.28). Studentët informohen përmes aktiviteteve orientuese, takimeve me staf akademik dhe kujdestarët e lëndëve, si dhe përmes Zyrës së Sigurimit të Cilësisë dhe Karrierës pranë FSHN, e cila ofron informacion për kriteret e pranimit, rregullat e transferimit, ekuivalentimit dhe zhvillimin e karrierës (Evidenca 2.23; 1.36; 1.37). Transferimi i studimeve dhe njohja e krediteve mundësohet në përputhje me rregulloret institucionale dhe kombëtare, brenda UT apo me institucione të tjera të arsimit të lartë (Evidenca 1.6; 2.39). Departamenti i Kimisë Industriale, si njësi bazë, siguron dokumentacion të plotë për studentët: informacion mbi institucionin, programin e studimit, strukturën përgjegjëse, rregulloret (Evidenca 1.5; 1.6), planin mësimor me ndarjen sipas viteve, semestrave, krediteve dhe lëndëve (Evidenca 1.9; 2.20), syllabus-et (Evidenca 1.10.1), kuadrin akademik (Evidenca 1.14; 2.19), si dhe suplementin e diplomës (Evidenca 1.10.4).
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabus-et) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i Studimit “Master në Kimi Industriale dhe Mjedisore” përmban për secilën lëndë syllabus-in përkatës, të hartuar nga personeli akademik çdo vit akademik, në përputhje me formatin e miratuar në VKM Nr. 41/2018, pika 2.8, dhe me strukturën e programit (Evidenca 1.10.1). Çdo syllabus përmban informacion të detajuar mbi: - Ngarkesën mësimore: orë leksioni, seminari, laborator dhe praktika - Kreditet dhe semestrin e zhvillimit - Tipologjinë dhe statusin e lëndës - Pedagogun përgjegjës - Mënyrën e vlerësimit (pjesëmarrje, detyra, provim përfundimtar) - Literaturën bazë dhe të rekomanduar Informacioni i syllabus-it u komunikohet studentëve në fillim të vitit akademik dhe versionet e përmbledhura publikohen në faqen zyrtare të FSHN (Evidenca 1.10.1; 403), duke siguruar transparencë dhe qasje të plotë në të gjithë komponentët formues të programit, brenda dhe jashtë auditorit.

Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Programi i Studimit i ciklit të dytë i nënshtrohet një procesi të vazhdueshëm përmirësimi dhe përditësimi, bazuar në zhvillimet akademike dhe kërkesat e tregut të punës. Në fillim të çdo viti akademik, planifikohen dhe miratohen ndryshimet eventuale në planin mësimor dhe syllabus-et, në përputhje me rregulloret e Universitetit të Tiranës dhe procedurat e Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave (Evidenca 2.30; 2.31; 1.10.1). Ndryshimet miratohen nga Senati Akademik, dhe nëse përmbajtja tejkalon 20%, procedohen për miratim pranë Ministrisë së Arsimit (Evidenca 2.32). Pas miratimit, dokumentacioni arkivohet në dosje të plota në gjuhën shqipe dhe anglisht, duke garantuar transparencë dhe përputhje me standardet akademike ndërkombëtare (Evidenca 2.31; 2.41).			
Konkluzione	Struktura dhe Organizimi Akademik: Programi përmban planin mësimor të detajuar dhe syllabus-et për çdo lëndë, duke përfshirë komponentët formues, ngarkesën mësimore, si dhe përshkrimin e orëve në auditor dhe jashtë tij, në përputhje me formatet e miratuara (Evidenca 1.9; 1.10.1; 2.17). Informimi dhe Mbështetja e Studentëve: Studentët informohen rregullisht mbi kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit, përmes orientimit akademik, takimeve me kujdestarët dhe platformave zyrtare të institucionit (Evidenca 1.3; 1.6; 1.28; 2.23). Transparenca dhe Dokumentacioni Akademik: Programi ofron dokumentacion të plotë në shqip dhe anglisht, duke përfshirë informacion mbi përmbajtjen e lëndëve, personelin akademik, rregulloret, infrastrukturën dhe kriteret e vlerësimit, të aksesueshme për të gjithë studentët (Evidenca 1.10; 1.13.1; 1.14; 2.17). Përmirësim dhe Përditësim i Vazhdueshëm: Përmbajtja e programit përditësohet çdo vit për të reflektuar zhvillimet akademike dhe kërkesat e tregut të punës. Ndryshimet miratohen nga strukturat përkatëse dhe arkivohen në dy gjuhë, duke ruajtur standardin dhe transparencën institucionale (Evidenca 2.30–2.32; 2.41).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi Master “Inxhinieri e Proceseve Kimike” është emërtuar, strukturuar dhe organizuar në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës, si dhe me Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë (Evidenca 1.1; 1.3). Emërtimi pasqyron fushën e Shkencave Natyrore dhe përputhet me drejtimet strategjike akademike të institucionit (Evidenca 1.7). Përmbajtja mësimore siguron formim të përgjithshëm dhe të specializuar në inxhinieri kimike, përmes lëndëve bazë, karakterizuese dhe integruese, të ndërtuara sipas kërkesave të tregut të punës (Evidenca 1.9; 2.2). Komponentët praktikë janë të pranishëm në shumicën e lëndëve, veçanërisht në vitin e parë, duke përfshirë laboratorë dhe ushtrime (Evidenca 2.4; Tabela 13 ASCAL). Programi mbështetet nga infrastruktura dhe staf i kualifikuar, në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit dhe Rregulloren përkatëse (Evidenca 1.6; 1.7). Leksionet, seminarët dhe praktikat laboratorike nxisin mendimin kritik dhe zhvillimin e aftësive teknike e profesionale (Evidenca 2.3; 2.43). Të dhënat nga sondazhet tregojnë se shumica e studentëve të diplomuar janë të punësuar gjatë ose pas studimeve, kryesisht në sektorin privat dhe administratën publike (Evidenca 1.8.3; 1.8.4; 2.42). Departamenti ka integruar ish-studentë në pozita akademike dhe ndihmëse (Evidenca 1.15; 2.6). Programi ofron gjithashtu bazë të qëndrueshme për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë, brenda dhe jashtë vendit (Evidenca 2.36), duke garantuar thellim të njohurive dhe zhvillim të mëtejshëm profesional.															
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Struktura e programit dhe përmbushja e objektivave formuese Programi i studimit Master Shkencor “Inxhinieri e Proceseve Kimike” zhvillohet përgjatë dy viteve akademike (120 ECTS). Ai përbëhet nga tre semestra formimi teorik (nga 30 ECTS) dhe një semestër final i dedikuar për realizimin e tezës së diplomës (30 ECTS) (Evidenca 2.2). Shpërndarja e lëndëve dhe moduleve sipas kategorive në ECTS për programin e studimit është si më poshtë: <table><tr><th>Kategoria</th><th>Tipi</th><th>ECTS</th><th>%</th><th>Standardi</th></tr><tr><td>A</td><td>Lëndë Bazë</td><td>6</td><td>5%</td><td>5-10 %</td></tr><tr><td>B</td><td>Lëndë karakterizuese</td><td>60</td><td>50%</td><td>30-40 %</td></tr></table>	Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi	A	Lëndë Bazë	6	5%	5-10 %	B	Lëndë karakterizuese	60	50%	30-40 %
Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi												
A	Lëndë Bazë	6	5%	5-10 %												
B	Lëndë karakterizuese	60	50%	30-40 %												

C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	19	15.83%	20-30 %
D	Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale	5	4.167%	10%
E	Detyrime përmbyllëse/ Provimi përfundimtar	30	25%	10-20 %

Plani mësimor ofron një shpërndarje të balancuar të njohurive bazë (p.sh. Parimet e ekuilibrave kimikë), të atyre karakterizuese (p.sh. Modelimi i proceseve, Inxhinieria e proceseve ushqimore, Transporti i masës, Dinamika e proceseve) si dhe të lëndëve integruese dhe me zgjedhje (p.sh. Shkenca e materialeve, Simulimi dhe optimizimi i proceseve) (Evidenca 1.9). Lëndët janë të strukturuar në përputhje me kreditet dhe ngarkesën orare, duke përfshirë leksione, seminare dhe orë laboratorike (Evidenca 2.2; Evidenca 1.9).

Programi përmban gjithsej 1335 orë mësimore: 720 orë në vitin e parë dhe 615 orë në vitin e dytë (Evidenca 1.9). Nga 12 lëndët bazë dhe karakterizuese, 6 përfshijnë komponentë laboratorikë, që fuqizojnë aftësimin profesional dhe të nxënit aktiv përmes punës së pavarur dhe analizës shkencore të të dhënave (Evidenca 2.4).

Në semestrin e katërt, studenti angazhohet me punimin e diplomës mbi një temë kërkimi shkencor përmes 300 orëve në auditor dhe 450 orëve jashtë auditorit (Evidenca 2.29). Temat ofrohen nga grupet kërkimore të Departamentit të Kimisë Industriale dhe shpallen në bashkëpunim me stafin akademik, duke i lejuar studentit të zgjedhë sipas interesit dhe fushës së specializimit. Kjo përgatitje u jep atyre mundësinë të kontribuojnë në projekte kërkimore, të prezantojnë në konferenca dhe të zhvillojnë aftësi të thelluara në kërkimin shkencor (Evidenca 1.23).

Përgjatë çdo viti, përgjegjësi i programit përpilohet raportin vjetor mbi arritjet dhe rezultatet e të nxënit dhe kërkimit, që shërben si mekanizëm vlerësimi për përmirësimin e vazhdueshëm të programit (Evidenca 1.35). Fakulteti mbështet gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në konferenca e publikime shkencore (Evidenca 2.24).

Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Struktura dhe përputhshmëria e programit me profilin e studimit Programi Master Shkencor në “Inxhinieri e Proceseve Kimike” është ndërtuar në përputhje me profilin shkencor të programit dhe krahasohet pozitivisht me programe të ngjashme ndërkombëtare (Evidenca 2.41). Ai është i harmonizuar me sistemin evropian të krediteve ECTS dhe udhëzimet kombëtare e ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë (Evidencat 1.9; 1.11.1; 1.18; 2.2; 2.4). Struktura përfshin 17 lëndë që mbulojnë aspekte teorike, praktike dhe laboratorike. Nga këto, 9 lëndë përmbajnë komponentë laboratorikë, me një raport mesatar teori/seminar/praktikë afërsisht 2:1:2, duke siguruar aplikim të njohurive teorike në kontekste reale (Evidenca 1.9). Raporti ndërmjet përmbajtjes teorike dhe praktikës laboratorike reflekton qartë profilin inxhinierik të programit dhe mbështet zhvillimin e aftësive profesionale. Diplomantët e programit janë të përgatitur për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë apo për angazhim profesional në institucione kërkimore dhe industri jashtë vendit, duke reflektuar standarde krahasueshme me ato të programeve master shkencorë ndërkombëtarë (Evidencat 2.18; 2.36).
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja e veprimtarive formuese dhe mundësimi i mobilitetit, transferimit dhe punësimit Programi Master Shkencor në “Inxhinieri e Proceseve Kimike” është ndërtuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015 dhe Deklaratën e Bolonjës, duke zbatuar sistemin ECTS që garanton mundësi transferimi dhe mobiliteti brenda dhe jashtë vendit. Çdo kredit përfaqëson 25 orë pune, ku më shumë se gjysma i dedikohet punës së pavarur të studentit (Evidenca 1.7; 1.9; 2.20). Struktura e programit përfshin veprimtari formuese si leksione, seminare, ushtrime, laboratorë dhe punë individuale. Nga 17 lëndë gjithsej, 9 përfshijnë komponentë laboratorikë, me një raport të përgjithshëm teori/praktikë që siguron aftësim profesional të studentëve (Evidenca 1.9). Orët praktike zënë rreth 39% të totalit të orëve mësimore, duke garantuar aplikimin e njohurive teorike në mjedise laboratorike të pajisura dhe me grupe të vogla pune (10–15 studentë) për të rritur efikasitetin (Evidencat 1.13.2; 2.38). Ndërtimi i këtij raporti formues (47% praktikë në vitin e parë dhe 22.8% në të dytin) mbështet arritjen e objektivave të profesionit të inxhinierit kimist dhe përgatitjen për punësim. Gjithashtu, përfshirja e studentëve në punë kërkimore përmes tezës së diplomës kontribuon në angazhimin real praktik dhe kërkimor (Evidenca 1.9).

	Programi është i krahasueshëm me struktura homologe ndërkombëtare, çka ka mundësuar ekuivalentime për transferime studimesh apo degë të dyta (Evidencat 2.39; 2.39.1). Diplomantët e këtij programi ndjekin studime Doktoraturë ose punësohen në institucione kërkimore dhe kompani brenda e jashtë vendit (Evidencat 2.18; 2.36).
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Përditësimi i syllabus-eve dhe përputhshmëria me tregun e punës Syllabuset e lëndëve në programin Master Shkencor “Inxhinieri e Proceseve Kimike” përditësohen rregullisht në përputhje me zhvillimet e fushës dhe kërkesat e tregut të punës (Evidenca 1.10.1; 2.25). Përditësimet përfshijnë rishikimin e përmbajtjes, objektivave mësimorë dhe literaturës, duke përdorur burime të fundit shkencore dhe profesionale. Literatura ndahet në bazë dhe ndihmëse, me rreth 70% të lëndëve të mbuluara nga tekste në gjuhën shqipe të përgatitura nga stafi akademik. Në disa lëndë përdoren leksione të përditësuara me materiale bashkëkohore, që lejojnë përshtatje ndaj zhvillimeve teknologjike dhe shkencore. Planet mësimore përditësohen deri në masën 20% sa herë kërkohet, duke ruajtur standardin dhe përshtatshmërinë me programet homologe (Evidenca 2.30; 2.31; 1.30). Ky përditësim i vazhdueshëm siguron përfitimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të nevojshme për punësim në sektorë të ndryshëm: industri kimike, ushqimore, farmaceutike, energjetike, të materialeve, mbetjeve dhe kërkimit shkencor. Programi formon inxhinierë kimistë të kualifikuar për tregun vendas dhe ndërkombëtar dhe përgatit studentët për studime të mëtejshme në ciklet pasardhëse (Evidenca 1.10; 2.2 Tabela 9 ASCAL).
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi Master në “Inxhinieri e Proceseve Kimike” – Përmbajtja dhe Kompetencat e Fituara, Programi i ciklit të dytë Master Shkencor në “Inxhinieri e Proceseve Kimike” është projektuar për të garantuar përftimin e njohurive të thelluara, aftësive praktike dhe kompetencave profesionale në përputhje me zhvillimet bashkëkohore dhe kërkesat e tregut të punës (Evidenca 1.10; 1.9; 2.2 – Tabela 9 ASCAL). Studentët aftësohen për punë kërkimore dhe projektim të pavarur, përvetësojnë përdorimin e literaturës shkencore në gjuhë të huaj dhe përgatiten profesionalisht si inxhinierë kimistë, të gatshëm për sfidat teknologjike bashkëkohore. Diploma ofron mundësi të gjera punësimi në industri të ndryshme: kimike, ushqimore, farmaceutike, energjetike, menaxhimit të mbetjeve, si dhe në kërkim shkencor dhe institucione akademike.

	Objektivat dhe përmbajtja e programit janë të dokumentuara në formatin e plotë të programit mësimor dhe të aksesueshme në faqen zyrtare të Departamentit të Kimisë Industriale.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e Programit dhe Përshtatja me Tregun e Punës Programi Master Shkencor në "Inxhinieri e Proceseve Kimike" ofron formim të thelluar teorik dhe praktik në fusha kyçe të inxhinierisë kimike, duke përfshirë proceset industriale, transportin e masës, nxehtësisë dhe lëvizjes, kinetikën, katalizën, si dhe kontrollin dhe optimizimin e proceseve në përputhje me standardet evropiane (Evidenca 1.6; 1.10; 1.47). Struktura modulare e programit siguron transferim të qëndrueshëm njohurish dhe përgatit studentët për punësim apo studime të mëtejshme. Sipas anketave të realizuara (Evidenca 1.8.3; 1.8.4), shumica e të diplomuarve janë punësuar me kohë të plotë në administratë publike dhe sektorin privat, në vend ose jashtë tij. Të dhëna të vlefshme për gjurmimin e karrierës përfitohen edhe nga rrjeti Alumni.
Konkluzione	1. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara: Programi Master Shkencor në "Inxhinieri e Proceseve Kimike" është konceptuar për të siguruar një formim të plotë teorik dhe praktik në fushat bazë dhe të avancuara të inxhinierisë kimike. Struktura modulare, literatura e përditësuar dhe përfshirja e teksteve të shkruara nga stafi akademik mundësojnë përftimin e kompetencave të nevojshme për një inxhinier kimist bashkëkohor. (Evidenca 1.10, 1.9, 2.2) 2. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e tregut të punës: Përmbajtja lëndore përmbush kërkesat e tregut përmes përgatitjes së studentëve me njohuri të avancuara për proceset industriale dhe teknologjitë bashkëkohore. Të dhënat nga anketat dhe rrjeti Alumni tregojnë shkallë të lartë punësimi të studentëve, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, brenda dhe jashtë vendit. (Evidenca 1.6, 1.8.3, 1.8.4, 1.47) 3. Syllabuset (programet e lëndëve/moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës: Syllabuset rishikohen dhe përditësohen rregullisht, duke reflektuar zhvillimet e fundit shkencore dhe teknologjike si dhe përputhjen me legjislacionin në fuqi. Literatura e përdorur ndahet në bazë dhe të rekomanduar, dhe rreth 70% e lëndëve ofrojnë tekste mësimore në gjuhën shqipe. Për disa lëndë, përdoren leksione të shkruara që pasurohen me informacion të ri. (Evidenca 1.10.1, 2.25, 2.31).

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e programeve të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ky proces realizohet përmes konsultimeve të rregullta me: • Institucione partnere akademike dhe kërkimore, kombëtare dhe ndërkombëtare, që kontribuojnë me ekspertizë dhe përditësim të njohurive shkencore (Evidenca 1.19, 2.37, 2.37.1); • Aktorë nga tregu i punës, si punëdhënës, përfaqësues të industrive, agjenci punësimi dhe shoqata profesionale, të cilët ndihmojnë në përcaktimin e aftësive dhe njohurive që kërkohen në praktikë (Evidenca 1.21, 1.22, 1.22.1, 1.22.2, 1.22.3, 1.22.4, 1.22.5); • Studentë të diplomuar (ALUMNI), që ofrojnë informacion mbi ndikimin e programit në karrierën e tyre dhe japin sugjerime për përmirësime (Evidenca ALUMNI); • Projekte bashkëpunimi ndërkombëtar, veçanërisht në kuadër të Erasmus+ KA107, përmes të cilave UT ka vendosur marrëveshje me mbi 100 universitete (2019–2023) për shkëmbime dhe zhvillim programor (Evidenca 1.8, 1.8.1, 1.8.3); • Aktivitete dhe Panairë Karriere, që krijojnë ura lidhëse me sektorët industrialë dhe ofrojnë mundësi praktikash dhe punësimi për studentët (Evidenca 1.22, 1.42, 2.45, 2.46). Shembuj konkretë përfshijnë marrëveshje bashkëpunimi të Departamentit të Kimisë Industriale me kompani si “Gjergj Kastrioti”, “Lufra”, “Integrated Energy”, etj. (Evidenca 1.22)
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e	Fakulteti i Shkencave të Natyrës përfshin aktivisht studentët dhe strukturat e tyre përfaqësuese në diskutime për përmirësimin e programeve të studimit, përmes takimeve të rregullta, forumeve,

diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	seminareve dhe konsultimeve me stafin akademik dhe administrativ (Evidenca 1.23). Strukturat studentore luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin dhe adresimin e nevojave të tyre akademike. Gjithashtu, institucioni mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar (ALUMNI), të cilët japin informacion të vlefshëm për cilësinë e mësimdhënies dhe përshtatjen e programeve me kërkesat e tregut të punës (Evidenca ALUMNI, 2.42, 2.47). Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) organizon takime periodike me ALUMNI për të reflektuar mbi përvojat e tyre profesionale dhe për të nxitur përmirësime konkrete në përmbajtjen e programeve (Evidenca 1.12, 2.34, 1.25).
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione publike e private.	Njësia përgjegjëse në FSHN përmirëson dhe përditëson programet e studimit në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushat përkatëse dhe kërkesat e tregut të punës, në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione publike e private (Evidenca 1.22, 1.30, 2.45). Ndryshimet në plan program realizohen rregullisht, deri në 20%, përmes rishikimit të përmbajtjes lëndore, metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit (Evidenca 2.30, 2.31). Ky proces mbështetet edhe nga kontributi i ALUMNI, organizimi i workshopeve, pjesëmarrja në konferenca dhe projekte të përbashkëta me aktorë të tregut dhe industrisë (Evidenca 1.25, 2.47). Bashkëpunimi me shoqata profesionale si Shoqata e Kimistëve, Urdhri i Mjekëve, qendra kërkimore dhe kompani, ndihmon në përcaktimin e prioriteteve dhe përshtatjen e programeve me standardet ndërkombëtare dhe nevojat aktuale të tregut të punës (Evidenca 1.38, 1.38.6).
Konkluzione	<i>Institucioni angazhon në mënyrë të vazhdueshme studentët dhe strukturat e tyre përmes takimeve, forumeve dhe aktiviteteve të tjera konsultative, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Studentët e diplomuar (ALUMNI) përfshihen aktivisht në këtë proces përmes kontakteve të rregullta dhe pjesëmarrjes në aktivitete si orë të hapura, workshop-e dhe projekte kërkimore. Këto kontribute shërbejnë si reflektim praktik mbi përshtatshmërinë e programeve me tregun e punës dhe sfidat profesionale. Roli i DSBCK në FSHN garanton strukturimin dhe ndjekjen e këtyre proceseve në mënyrë institucionale dhe të dokumentuar.</i> <i>Njësia përgjegjëse në FSHN demonstroi një angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin dhe përditësimin e programeve të studimit, në përputhje me zhvillimet shkencore, teknologjike dhe kërkesat e tregut të punës. Ky proces realizohet nëpërmjet</i>

	bashkëpunimit me rrjete profesionistësh, shoqata profesionale (p.sh., Shoqata e Kimistëve, Urdhra të Mjekëve), institucione publike dhe private, si dhe qendra kërkimore dhe kompani. Ndryshimet në planet mësimore kryhen në mënyrë të rregullt dhe të dokumentuar, duke reflektuar inpute nga ALUMNI dhe aktorë të jashtëm. Përshatja e programeve synon të garantojë përgatitjen profesionale dhe konkurruese të studentëve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit "Master i Shkencave në Inxhinieri të Proceseve Kimike" përcakton qartë prioritetet dhe objektivat e tij kryesorë në dokumente zyrtare si Rregullorja e programit dhe e Departamentit (Evidencat 1.5, 1.6), në përputhje të plotë me objektivat madhorë të institucionit (Evidencat 1.1, 1.2.1–1.2.4). Plani Strategjik i Departamentit thekson zhvillimin e kërkimit shkencor, mësimdhënien bashkëkohore dhe bashkëpunimin me sektorët ekonomikë e socialë (Evidenca 1.4). Objektivat përfshijnë: 1. Formimin e ekspertëve të kualifikuar në fushën e proceseve kimike; 2. Nxitjen e kërkimit shkencor dhe inovacionit për të adresuar nevojat e industrisë dhe shoqërisë (Evidencat ALUMNI, 1.23, 2.27); 3. Zhvillimin e aftësive drejtuese dhe menaxheriale të studentëve (Evidencat 2.36, ALUMNI). Programi synon përgatitjen e kuadrove që përmbushin kërkesat e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar për zhvillim të qëndrueshëm dhe teknologji innovative.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia bazë (Departamenti i Kimisë Industriale në FSHN), në përputhje me Statutin e UT (Neni 7), nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke respektuar lirinë akademike të stafit dhe specifikën e programit të studimit Master në Inxhinieri të Proceseve Kimike (Evidencat 1.1, 1.5). Departamenti funksionon nëpërmjet grupeve mësimore-kërkimore, të cilat marrin pjesë në hartimin e strategjisë, përmirësimin e

	programeve mësimore dhe kërkimore, si dhe përcaktimin e kriterëve të pranimit të studentëve (Evidenca 1.44). Drejtuesi i Departamentit dhe aktet rregullatorë të UT udhëheqin këtë proces (Evidenca 1.1). Njësia siguron zhvillimin e planit mësimor, organizimin e trajnimeve dhe seminareve (Evidencat 1.9, 1.13), si dhe orienton kërkimin drejt nevojave të industrisë dhe shoqërisë (Evidencat 1.10, 1.43, 2.24). Përkujdeset për zhvillimin e projekteve kërkimore, alokimin e burimeve financiare dhe promovon bashkëpunimin ndërkombëtar (Evidencat 2.40, 1.38). Liria akademike garantohet dhe mbrohet si një element themelor për mësimdhënie cilësore dhe kërkime të avancuara.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit Master në Inxhinieri të Proceseve Kimike në Universitetin e Tiranës nxit dhe motivon studentët për angazhim në studime kërkimore, duke ofruar mundësi konkrete për përfshirjen e tyre në projekte brenda dhe jashtë institucionit (Evidencat 1.35, 2.15, 1.43, 2.27). Studentët kontribuojnë në tema diplome të lidhura me kërkime të aplikuara dhe bashkëpunime me industrinë, si dhe marrin pjesë në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare (Evidencat 1.23, 5.5.1). Programi promovon gjithashtu mobilitetin akademik dhe përfshirjen në projekte kërkimore ndërkombëtare përmes marrëveshjeve si Erasmus+ (Evidenca 1.23.1, 2.37), dhe mbështet studentët me bursa dhe fonde për kërkime të pavarura (Evidenca 5.14). Këto aktivitete përforcojnë zhvillimin profesional dhe përgatitin studentët për karriera në kërkimin shkencor dhe sektorin industrial, duke nxitur gjithashtu përgjegjësi shoqërore dhe kontribut në zgjidhjen e sfidave bashkëkohore.
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Departamenti i Kimisë Industriale mbështet financiarisht nga Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore dhe shkencore (Evidenca 1.34; 1.35; 2.48). Kjo mbështetje përfshin financimin e projekteve kërkimore, pajisjeve laboratorike dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore (Evidenca 2.27; 2.27.1), me mbi 50 punime të mbështetura gjatë periudhës 2021–2024. Departamenti administron gjithashtu të ardhura nga projekte bashkëpunimi me industrinë, organizata ndërkombëtare dhe donatorë të jashtëm, të cilat kanë kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe pajisjeve laboratorike (Evidenca 2.49; 1.38). Të ardhura shtesë sigurohen edhe nga kurse dhe trajnime të specializuara (Evidenca 1.41).

	Studentët dhe stafi përfitojnë mbështetje përmes bursave dhe programeve të mobilitetit si Erasmus+, duke ndihmuar në zhvillimin profesional dhe rritjen e cilësisë akademike në fushën e inxhinierisë kimike (Evidenca 2.37; 2.37.1; 2.8).			
Konkluzione	<i>Departamenti i Kimisë Industriale në Universitetin e Tiranës siguron një mbështetje të qëndrueshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve studimore, kërkimore dhe shkencore, falë fondeve të alokuara nga institucioni dhe menaxhimit efikas të të ardhurave shtesë. Kjo mbështetje ka mundësuar realizimin e një numri të konsiderueshëm punimesh shkencore, përmirësimin e infrastrukturës laboratorike dhe pjesëmarrjen aktive të stafit dhe studentëve në konferenca e mobilitete ndërkombëtare. Përfshirja në projekte bashkëpunimi me industrinë dhe organizatat e huaja ka krijuar kushte të favorshme për inovacion dhe ngritje të kapaciteteve kërkimore. Këto faktorë kontribuojnë ndjeshëm në rritjen e cilësisë akademike dhe në zhvillimin profesional të studentëve dhe stafit në fushën e Inxhinierisë Kimike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Departamenti i Kimisë Industriale (DKI), si njësi përgjegjëse, mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja përmes burimeve financiare, infrastrukturës laboratorike dhe nxitjes së bashkëpunimit me struktura të tjera kërkimore brenda dhe jashtë Universitetit të Tiranës, për të realizuar objektivat akademike të programit të studimit (Evidenca 1.35; 6.17). Në kuadër të programit institucional “UT–Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”, personeli akademik me kohë të plotë përfitoi mbështetje për projekte konkurruese, ku anëtarë të DKI janë shpallur fitues (Evidenca 2.40; 2.40.2). Projektet dhe bashkëpunimet raportohen rregullisht në dokumentet vjetore të FSHN dhe janë të listuara në kriterin 2 të këtij standardi, si dhe në faqen zyrtare të fakultetit (Evidenca 2.8).
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin	Njësia përgjegjëse angazhohet për të përmbushur kërkesat për analiza dhe projekte kërkimore-shkencore nga institucione të ndryshme, duke angazhuar personelin akademik dhe studentët në realizimin e këtyre objektivave. Kjo përfshin bashkëpunim të ngushtë me institucione akademike, organizata shkencore dhe

akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	kompani private, si dhe ofrimin e mundësive për angazhim të studentëve dhe personelit në projekte kërkimore ndërkombëtare dhe kombëtare (Evidenca 1.22, 2.48). Pjesëmarrja e personelit akademik dhe studentëve në projekte kërkimore, si në kuadër të projekteve si “Adrion” dhe projekte të tjera të mbështetura nga BE dhe donatorë të tjerë, mundëson zhvillimin e aftësive praktike dhe kërkimore (Evidenca 2.37, 2.15). Aktivitetet kërkimore janë të integruara në kurrikulat e programeve të studimit, duke përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe duke krijuar mundësi për bashkëpunim ndër-institucional dhe shkëmbim eksperiencash (Evidenca 1.10.2, 1.38). Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, njësia promovon zhvillimin e kapaciteteve kërkimore të stafit akademik dhe studentëve, duke ofruar mundësi trajnimi dhe kurse të avancuara që ndihmojnë në përmirësimin e aftësive shkencore dhe kërkimore (Evidenca 2.29, 2.43). Ky angazhim kontribuon në përgatitjen e studentëve për karrierat profesionale dhe zhvillon aftësitë e tyre për kërkimin shkencor dhe industrinë.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Departamenti i Kimisë Industriale, si njësi përgjegjëse, organizon konferenca, workshop-e dhe aktivitete shkencore që mbështesin objektivat e programit të studimit dhe zhvillimin profesional të studentëve dhe stafit akademik. Aktivitetet si workshop-et e projektit Adrion dhe shkolla verore në kuadër të projektit Transnational Master in Renewable Energies kontribuojnë në shkëmbimin e njohurive dhe rritjen e kapaciteteve profesionale (Evidenca 2.27; 2.15). Studentët marrin pjesë aktive në konferenca dhe kanë mundësi të publikojnë punimet e tyre kërkimore, duke u angazhuar në veprimtari që nxisin zhvillimin akademik dhe shkencor (Evidenca 2.27). Njësia organizon gjithashtu kurse trajnimi dhe seminare në fusha kërkimore dhe teknologjike, të cilat përmirësojnë cilësinë akademike dhe nxisin bashkëpunimin ndërkombëtar (Evidenca 1.41; 1.7).
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi Master në Inxhinieri Kimike është konceptuar për të formuar profesionistë konkurrues në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës, duke kombinuar njohuri teorike me aftësi praktike në përputhje me kërkesat e industrisë dhe zhvillimet bashkëkohore (Evidenca 1.41; 2.29; 2.46). Përmes praktikave profesionale, projekteve kërkimore dhe bashkëpunimeve me sektorin privat, studentët përgatiten për të

	udhëhequr iniciativa, për të zgjidhur probleme komplekse dhe për t'u integruar në institucione kërkimore dhe organizata ndërkombëtare (Evidenca 2.18; 2.36). Programi nxit gjithashtu zhvillimin e aftësive ndërkulturore dhe lidhshirësit përmes mobilitetit akademik dhe përfshirjes në aktivitete shumëdisiplinore (Evidenca 1.47; 1.48). Cilësia e qëndrueshme e programit ka mundësuar punësimin e diplomantëve në pozita drejtuese në industri, duke e pozicionuar atë si një nga programet më të kërkuara në treg (Evidenca 1.42; ALUMNI).			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	N/A			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	N/A			
Konkluzione	Programi i studimit ofron formim akademik dhe praktik cilësor, duke përgatitur profesionistë të aftë për t'u integruar me sukses në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Kurrikula është e orientuar nga tregu, duke i mundësuar studentëve të zhvillojnë aftësi teknike, kërkimore dhe menaxheriale të kërkuara nga punëdhënësit. Bashkëpunimi me industrinë dhe institucionet ndërkombëtare ndihmon në rritjen e punësimit dhe përgatitjen për mjedise shumë kulturore. Pjesëmarrja në praktika profesionale dhe projekte kërkimore përforcon njohuritë dhe aftësitë e studentëve, duke i bërë ata më konkurrues në tregun e punës. Të diplomuarit nga programi arrijnë pozicione të rëndësishme profesionale dhe akademike, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, çka dëshmon suksesin dhe efektivitetin e programit.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, mësim nxënies dhe transmetimit të dijeve në programin Master i Shkencave "Inxhinieria e Proceseve Kimike" përfshijnë leksione, seminare, punë laboratorike, detyra kursi, ese, projekte, praktika profesionale e klinike, tema diplome dhe orë të hapura (Evidenca 1.9, 1.10.1). Këto forma janë të përcaktuara në syllabus-et e lëndëve, të cilat hartohen në përputhje me Statutin e UT (Evidenca 1.1), Rregulloren e Departamentit të Kimisë Industriale (Evidenca 1.5), Rregulloren e programit të studimit (Evidenca 1.6), si dhe VKM nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019 (Evidenca 1.3, Tabela 13). Çdo syllabus përfshin: programin e studimit, ngarkesën (kreditet dhe orët mësimore për leksione, seminare, laboratorë), tipologjinë dhe llojin e lëndës, semestrin, pedagogun, temat, format e kontrollit të njohurive dhe literaturën bazë e të rekomanduar (Evidenca 1.6, Evidenca 1.10.1). Një kredit përfaqëson 25 orë, që përfshijnë mësim në auditor dhe punë individuale të studentit (Evidenca 1.3, 1.6, Tabela 13 ASCAL). Universiteti i Tiranës ka miratuar gjithashtu udhëzues për përdorimin e mësimin në distancë (Evidenca 3.1), të zbatuar gjerësisht gjatë viteve akademike 2019–2021 (Evidenca 1.3), të shoqëruar nga rregullore për zhvillimin e provimeve online (Evidenca 3.2) dhe manuali për përdorimin e platformës dixhitale (Evidenca 3.3). Në mbështetje të metodave bashkëkohore, pranë Departamentit të Kimisë Industriale është ngritur Laboratori i Inxhinierisë së Proceseve Kimike në kuadër të projektit për infrastrukturën kërkimore të miratuar nga AKKSHI në qershor 2019 (Evidenca 1.13.1, 1.13.2, 1.13.3).

	Për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe shkëmbimit të përvojave, UT ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi që mundësojnë organizimin e leksioneve të hapura me profesorë vendas dhe të huaj (Evidenca 2.37, 3.4, 1.24.2). Ndërkohë, projektet kërkimore si NETCHEM dhe ADRION (Evidenca 1.38.1, 1.23, 1.38) shërbejnë si mbështetje për inovacionin dhe përforcimin e lidhjes mes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik dhe ndihmës akademik i programit Master i Shkencave "Inxhinieria e Proceseve Kimike" respekton Statutin dhe Rregulloren e UT për zhvillimin e mësimdhënies dhe vlerësimin e studentëve (Evidenca 1.1, 1.3). Në përputhje me Rregulloren e programit (Evidenca 1.6) dhe Strategjinë e Mësimdhënies (Evidenca 1.2.4), përdoren metoda të ndryshme për t'iu përgjigjur stileve të larmishme të të nxënit, duke kombinuar formimin teorik me atë praktik (Evidenca 1.6, 1.9). Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve, ushtrimeve, punëve laboratorike, detyrave dhe projekteve, të cilat zhvillohen si me mbështetjen e pedagogut, ashtu edhe në mënyrë të pavarur nga studenti (Evidenca 1.10.1). Studentët mund të fitojnë deri në 25% të vlerësimit total përmes këtyre aktiviteteve (Evidenca 1.10.1). Leksionet zhvillohen edhe në format digjital (PowerPoint, video projektor), ndërsa të gjitha godinat janë të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike për lehtësimin e mësim nxënies (Evidenca 2.25, 1.13, 3.5). Grupi i vogël laboratorik (maksimumi 15 studentë) mundëson një qasje të personalizuar, ku secili realizon eksperimente individualisht (Evidenca 2.3, 3.6). Procesi i vlerësimit përfshin testime në auditor, detyra, projekte kursi dhe provime përfundimtare, sipas përshkrimeve në syllabus (Evidenca 1.6, 1.10.1). Platforma Microsoft Teams dhe adresat zyrtare të emailit sigurojnë qasje të gjerë në materiale dhe komunikim të vazhdueshëm me pedagogët (Evidenca 3.3, 3.7, 3.7.1–3.7.7). Gjithashtu, stafi organizon orë konsultimesh për të ofruar mbështetje individuale sipas nevojës, duke krijuar një ambient të hapur dhe gjithëpërfshirës për studentët (Evidenca 1.6, 3.7.2).
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Universiteti i Tiranës, përmes politikave institucionale dhe strukturave përkatëse, mbështet zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe didaktik të stafit akademik në funksion të përmbushjes së rezultateve të të nxënit (Evidenca 1.2.2, 1.2.3, 1.2.4). Qendra Virtuale për Zhvillimin Profesional ofron trajnime periodike mbi metoda bashkëkohore të mësimdhënies,

	menaxhimin e klasës dhe integrimin e teknologjisë (Evidenca 3.8, 3.9). Institucioni inkurajon pjesëmarrjen në programe ndërkombëtare si Erasmus+, MEVLANA etj., përmes të cilave promovon shkëmbimin e eksperiencës akademike, mobilitetin dhe përfshirjen në projekte të përbashkëta (Evidenca 1.21). Platforma si Microsoft Teams dhe trajnimet përkatëse mbështesin përdorimin e teknologjisë në funksion të përmirësimit të përvojës mësimore (Evidenca 3.3). Gjatë periudhës së pandemisë, UT zbatoi mësimin në distancë, duke miratuar rregullore, udhëzues dhe manuale për zhvillimin e mësimdhënies online dhe duke trajnuar stafin për këtë qëllim (Evidenca 3.1, 3.2, 3.3, 3.10). Infrastruktura laboratorike moderne në Departamentin e Kimisë Industriale përmirëson aftësitë praktike të stafit dhe studentëve (Evidenca 1.13.1, 1.13.2). Gjithashtu, FSHN aplikon mekanizma të vlerësimit të vazhdueshëm të performancës didaktike të stafit përmes informacionit të studentëve dhe indikatorëve të matshëm (Evidenca 1.35), duke kontribuar në përmirësim të qëndrueshëm të cilësisë në mësimdhënie.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i përfshirë në programin Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike” në Departamentin e Kimisë Industriale përbëhet nga pedagogë të kualifikuar dhe të specializuar sipas lëndëve përkatëse (Evidenca 1.14, 1.15, 1.16, 2.6, 1.17). Ata zotërojnë tituj dhe grada shkencore që garantojnë kompetencë në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të avancuara. Procesi mësimor zhvillohet përmes metodave të kombinuara tradicionale dhe bashkëkohore: leksione me diskutim bashke me studentet, seminare, laboratorë praktikë dhe vlerësim të vazhduar (Evidenca 2.3, 2.3.1, 1.10.1). Këto metoda nxisin pjesëmarrjen aktive të studentëve, mendimin kritik dhe autonominë në të nxënë. Seancat laboratorike dhe detyrat e kursit ofrojnë mundësi për punë të pavarur dhe përfshirje në hulumtime, duke forcuar ndjenjën e përgjegjësisë dhe kreativitetit (Evidenca 2.3.2, 3.11, 1.36). Studentët marrin udhëheqje dhe mbështetje të vazhdueshme nga pedagogët, përmes komunikimit të drejtpërdrejtë dhe mjeteve digjitale si Microsoft Teams dhe emaili zyrtar (Evidenca 3.7.1). Marrëdhëniet ndërmjet stafit dhe studentëve bazohen në respekt të ndërsjellë, etikë profesionale dhe standarde të integritetit

	akademik, të përcaktuara nga Kodi i Etikës i UT (Evidenca 3.12, 1.6).
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës, në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Statutit të UT (Evidenca 1.1), vlerëson dhe përmirëson në mënyrë periodike metodat e mësimdhënies nëpërmjet mekanizmave të brendshëm të cilësisë dhe pjesëmarrjes së studentëve. Studentët përfshihen aktivisht përmes anketave për çdo lëndë në fund të çdo semestri, ku shprehin mendimin mbi cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik (Evidenca 1.12, 3.13). Rezultatet e këtyre anketave analizohen nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe shërbejnë si bazë për përmirësime në mësimdhënie dhe kërkim shkencor (Evidenca 2.42). Studentët kanë përfaqësues në Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës dhe atë të Cilësisë (Evidenca 1.1, Tabela 24 ASCAL), si dhe gëzojnë të drejtën e ankesës për vlerësimet akademike (Evidenca 1.3, 1.6). Gjithashtu, secili student ka kujdestarin e vet akademik, i cili përcjell shqetësimet dhe sugjerimet e tyre tek strukturat përkatëse (Evidenca 1.29).
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Universiteti i Tiranës ka ngritur struktura institucionale që garantojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, përmes bashkërendimit ndërmjet Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSSC) dhe njësite të sigurimit në çdo fakultet (Evidenca 1.1, 3.13). Këto struktura monitorojnë performancën e stafit akademik, organizojnë vlerësime të rregullta përmes pyetësorëve studentorë dhe analizojnë rezultatet për përmirësime të vazhdueshme (Evidenca 2.42, 3.17). FSHN ka një Degë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës që koordinon procesin e vlerësimit dhe përpunon të dhënat statistikore për çdo lëndë studimi (Evidenca 6.5a). Raportet i përcillen Departamentit dhe stafit akademik për reflektim dhe përmirësim të praktikave mësimore (Evidenca 3.16, 6.9). Për të mbështetur zhvillimin profesional të stafit dhe eksperimentimin me metoda inovative të mësimdhënies, UT ka krijuar Qendrën Virtuale për Zhvillimin Profesional dhe Trajnimin (Evidenca 3.8, 3.9) dhe ka miratuar Strategjinë Institucionale për Mësimdhënien (Evidenca 1.2.4). Gjatë pandemisë, janë miratuar udhëzues dhe manuale për mësimin

	online dhe janë organizuar trajnime për staf akademik (Evidenca 3.1–3.3, 3.10). Gjithashtu, me Programin “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”, UT nxit integrimin e kërkimit dhe inovacionit në procesin e mësimdhënies (Evidenca 3.14, 2.40).			
Konkluzione	1. Universiteti i Tiranës ka mekanizma të qartë për vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies përmes pyetësorëve studentorë në fund të çdo semestri. 2. Studentët janë të përfshirë në komisione vendimmarrëse si ai për Sigurimin e Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës. 3. Procesi i vlerësimit bazohet në Statutin e UT dhe në rregulloret përkatëse të programeve të studimit. 4. Të dhënat e mbledhura përpunohen dhe analizohen nga strukturat përkatëse dhe përdoren për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. 5. UT ka krijuar struktura të specializuara si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSSC) dhe Qendra Virtuale për Zhvillimin Profesional, të cilat koordinojnë aktivitetet për përmirësimin e cilësisë. 6. Janë miratuar strategji institucionale dhe manuale vlerësimi për të standardizuar dhe monitoruar performancën e stafit akademik. 7. Fakulteti i Shkencave të Natyrës në bashkëpunim me zyrat përkatëse realizon pyetësorë dhe analiza të detajuara statistikore për çdo program. 8. Personeli akademik trajnohet rregullisht, veçanërisht në fushën e teknologjive të reja dhe metodave moderne të mësimdhënies, përfshirë ato të zhvilluara gjatë periudhës së pandemisë. 9. UT mbështet kërkimin dhe inovacionin përmes programeve të dedikuara që ndërthuren me procesin e mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të	Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale realizohet përmes vlerësimit të vazhduar dhe provimit përfundimtar, me qëllim të matjes së progresit të studentit gjatë studimeve në auditor dhe në mënyrë individuale. Format e

studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	vlerësimit përfshijnë detyra kursi, prezantime, punë në grup, pjesëmarrje dhe aktivizim në seminare e laboratorë. Kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit përcaktohen në dokumentet përkatëse rregullatore: • Rregullorja e Universitetit të Tiranës [Evidenca 1.5], • Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, • Rregullorja e Departamentit të Kimisë Industriale, • Rregullorja e Programit të Ciklit të Dytë “Inxhinieria e Proceseve Kimike”. Mënyra e ndarjes së pikëve dhe format e vlerësimit janë të përshkruara në syllabusin e çdo moduli [Evidenca 1.10.1] dhe pasqyrohen gjithashtu në planet mësimore të çdo viti akademik [Evidenca 1.9,]. Studentët orientohen mbi këto dokumentacione nga kujdestarët akademikë [Evidenca 1.29 – Tabela 15 ASCAL].
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të semestrit, pedagogu i lëndës prezanton strukturën e lëndës për studentët, bazuar në syllabus, duke përfshirë emrin e lëndës, kreditet, emrin e pedagogut, vitin, semestrin, ngarkesën në orë, temat që do të trajtohen dhe mënyrën e vlerësimit të studentëve [Evidenca 1.10.1]. Studentët njoftohen gjithashtu me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit, përfshirë format e provimit (me shkrim apo gojë), numrin e kontrolleve të ndërmjetme, temat e detyrave të kursit, si dhe literaturën e detyruar dhe të rekomanduar. Ky informacion është i detajuar në syllabuset e lëndëve [Evidenca 1.10.1], në Rregulloren e Universitetit të Tiranës [Evidenca 1.3], Rregulloren e Departamentit të Kimisë Industriale [Evidenca 1.5], dhe Rregulloren e Programit Master “Inxhinieria e Proceseve Kimike” [Evidenca 1.6].
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Programi Master “Inxhinieria e Proceseve Kimike” parashikon forma të ndryshme testimi dhe vlerësimi, duke i mundësuar studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në mënyrë të plotë. Vlerësimi realizohet përmes provimeve me shkrim dhe me gojë, detyrave kursi, prezantimeve dhe vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, sipas përshkrimeve në syllabus-in e çdo lënde (Evidenca 1.10.1; 1.9; 3.7.4). Vlerësimi përfundimtar është i kombinuar, duke reflektuar rezultatet nga të gjitha komponentët e kontrollit të dijeve. Tezat e provimit final hartohen nga titullari i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit, duke garantuar standardizim dhe transparencë akademike (Evidenca 1.10.3).

Konkluzione	1. Diversiteti i metodave të testimit dhe vlerësimit: Procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale është i pasur me forma të ndryshme, si testime me shkrim, me gojë, detyra kursi dhe prezantime, që i mundësojnë studentëve të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë semestrit dhe vitit akademik. 2. Vlerësimi dinamik dhe i vazhdueshëm: Testimi dhe vlerësimi janë të strukturuar në një mënyrë dinamike, ku studentët vlerësohen vazhdimisht gjatë vitit akademik, përfshirë testimet dhe aktivitetet në auditor dhe jashtë tij. Ky proces ka për qëllim të reflektojë progresin e studentëve gjatë tërë periudhës së studimit. 3. Përfshirja e komponentëve të ndryshëm në vlerësim: Vlerësimi përfundimtar është një përbërës i rëndësishëm i kontrollit të dijeve, i cili përfshin përqindje të ndryshme të rezultateve nga testimet e ndryshme, si testet ndërmjetësuese dhe provimi final. Kjo ofron mundësi për një vlerësim gjithëpërfshirës të njohurive dhe aftësive të studentëve. 4. Transparenca dhe orientimi për studentët: Informacioni i dhënë përmes syllabuseve, rregulloreve dhe udhëzimeve të detajuara siguron transparencë dhe mundësi orientimi për studentët mbi mënyrat e testimit dhe kriteret e vlerësimit, duke i lejuar ata të përgatiten si duhet për provimet dhe detyrat e kursit. 5. Roli i pedagogëve në procesin e testimit: Pedagogët kanë një rol të rëndësishëm në hartimin e tezave të provimeve dhe udhëzimin e studentëve për procedurat e testimit dhe vlerësimit, duke siguruar që procesi të jetë i drejtë dhe i besueshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale zhvillohet gjatë gjithë vitit akademik dhe përmbyllet me vlerësimin përfundimtar, siç përcaktohet në syllabuset e çdo lënde/moduli (Evidenca 1.10.1). Në lëndët me vlerësim të vazhduar (VLV), studenti testohet 2-3 herë gjatë semestrit, ku çdo testim kontribuon deri në 45% të

	vlerësimi total, ndërsa pjesëmarrja dhe aktivizimi vlerësohen deri në 10% (Evidenca 3.18). Për lëndët që mbyllen me provim, pjesëmarrja dhe aktivizimi zënë 5-10%, praktikat laboratorike 10-25%, dhe provimi final 70-90% të vlerës totale (Evidenca 3.19). Vlerësimi bëhet me sistem pikësh 0–100, i cili konvertohet në notë përfundimtare, ndërsa përqindja për çdo komponent vlerësimi mund të ndryshojë sipas programit dhe natyrës së lëndës (Evidenca 1.5, 1.6; Tabela 15 ASCAL).
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimi, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Universiteti i Tiranës ka zbatuar sistemin elektronik MS Teams për testimin dhe vlerësimin e studentëve gjatë mësimi në distancë (vitet akademike 2019–2020 dhe 2020–2021), në përputhje me rregulloret institucionale (Evidenca 1.3). Ky sistem ka garantuar transparencë dhe efikasitet në procesin e vlerësimi, duke reduktuar mundësitë për abuzim dhe duke siguruar integritet akademik në përputhje me standardet e cilësisë (Evidenca 3.1–3.3; 3.14).
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin, rregulloren e programit të studimit dhe bazën ligjore në fuqi (Evidenca 1.3, 1.6). Titullari i lëndës harton dhe përditëson çdo vit tezën e provimit, vlerëson studentët dhe cakton notën përfundimtare (Evidenca 1.6). Provimet zhvillohen në prani të të paktën dy pedagogëve, njëri prej të cilëve është titullari, dhe tezat miratohen me firmë nga titullari dhe përgjegjësi i departamentit. Çdo pyetje e provimit është e pikëzuar sipas përcaktimeve në syllabus (Evidenca 3.20).
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i studentit shoqërohet me komente dhe, kur është e nevojshme, me këshilla për përmirësimin e procesit të të nxënit (Evidenca 1.6). Studenti njihet me pikët për çdo pyetje dhe me rezultatin total brenda pesë ditëve nga provimi (Evidenca 3.20). Ai ka të drejtë të kërkojë rishikim të vlerësimi dhe të njihet me përgjigjet e sakta përmes një komisioni vlerësimi (Evidenca 1.3, 1.6).
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Universiteti i Tiranës monitoron autenticitetin e detyrave dhe shmang plagjiaturën e kopjimin, në bazë të Rregullores së UT, Kodit të Etikës dhe Rregullores së programit të studimit (Evidenca 1.3, 1.6, 3.12). Shkeljet ndëshkohen sipas nenit 7 të Kodit të Etikës, që parashikon masa nga tërheqja e vëmendjes deri në pezullim nga mësimi. Po ashtu, UT ka ngritur një grup pune për hartimin e Rregullores së kontrollit antiplagjiaturë (Urdhri i Rektorit nr. 18, datë 15.06.2022; Evidenca 3.21).

Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Vlerësimi i njohurive dhe aftësive të studentëve në Universitetin e Tiranës bazohet në parimin e meritës dhe zhvillohet në përputhje me rregulloret përkatëse dhe Kodin e Etikës (Evidenca 1.3, 1.6, 3.12). Rezultatet shpallen brenda 5 ditëve pune nga provimi dhe procesverbalet dorëzohen në sekretari mësimore brenda 2 ditëve pas trajtimit të ankesave (Evidenca 3.20). Sistemi elektronik “e-student” siguron njoftimin në kohë reale të studentëve për rezultatet (Evidenca 4.17). Provimet online përmes MS-Teams kanë garantuar transparencë dhe vlerësim të drejtë bazuar në meritë (Evidenca 3.2).
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Universiteti i Tiranës garanton të drejtën e studentit për t’u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikimin e tij, në përputhje me rregulloret përkatëse (Evidenca 1.3, 1.5, 1.6). Brenda 48 orëve pas shpalljes së rezultateve, studenti ka të drejtë të kërkojë sqarim apo rishikim të vlerësimit pranë komisionit të provimit. Nëse ka paqartësi të mëtijshme, mund të paraqesë kërkesë me shkrim pranë Përgjegjësit të Departamentit (Evidenca 3.20).
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Çdo ankesë e studentit për procedurën ose rezultatin e provimit paraqitet me shkrim brenda afatit përkatës (24–48 orë) pranë Drejtuesit të Departamentit, i cili kryen verifikimet e nevojshme (Evidenca 1.3, 1.6). Në rast se nuk gjendet zgjidhje, çështja i kalon Dekanit, i cili, nëse është e nevojshme, ngre komision ad-hoc për shqyrtimin e ankesës dhe përcaktimin e vlerësimit përfundimtar. E gjithë procedura është transparente, dokumentohet dhe arkivohet sipas rregulloreve në fuqi.
Konkluzione	<i>Sisteme elektronike për testim dhe vlerësim: Universiteti i Tiranës ka zbatuar sistemin elektronik MS-Teams për zhvillimin e provimeve gjatë mësimin në distancë, duke siguruar transparencë, informim të shpejtë dhe shmangie të abuzimeve në procesin e vlerësimit.</i> <i>Vlerësimi përfundimtar sipas syllabus-it dhe bazës ligjore: Titullari i lëndës është përgjegjës për hartimin dhe vlerësimin e tezës në përputhje me syllabus-in dhe rregulloret. Vlerësimi përfundimtar është i dokumentuar, i verifikueshëm dhe përputhet me bazën ligjore në fuqi.</i> <i>Feedback dhe këshillim për përmirësim: Studenti njihet me pikët për çdo pyetje dhe me vlerësimin përfundimtar brenda afatit. Jepet mundësi për komentim dhe këshillim në funksion të përmirësimit të të nxënit.</i> <i>Parandalimi i plagjiaturës dhe kopjimit: UT zbaton masa për të parandaluar plagjiaturën dhe kopjimin bazuar në Kodin e Etikës dhe rregulloret përkatëse. Masa ndëshkimore merren në rast</i>

	<i>shkeljeje. Është ngritur edhe grup pune për hartimin e rregullores antiplagjaturë.</i> <i>Vlerësimi mbi bazë merite dhe afatesh: Rezultatet e provimeve jepen në kohë dhe bazohen në meritë. Notat publikohet përmes sistemit "e-student". Përdoret edhe vlerësimi me pikë, që konvertohet në notë përfundimtare.</i> <i>E drejta për njohjen dhe rishikimin e vlerësimit: Studenti ka të drejtë të njihet me vlerësimin dhe të kërkojë rishikim brenda 48 orëve. Komisioni i provimit ose Përgjegjësi i Departamentit trajton kërkesën në mënyrë të dokumentuar dhe transparente.</i> <i>Procedura për shqyrtimin e ankesave: Çdo ankesë për zhvillimin ose rezultatin e provimit shqyrtohet fillimisht nga Departamenti. Nëse është e nevojshme, Dekani ngre komision Ad-hoc. E gjithë procedura është transparente, e dokumentuar dhe e arkivuar sipas rregulloreve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieria e Proceseve Kimike" synon të thellojë njohuritë shkencore dhe të zhvillojë aftësitë profesionale e kërkimore të studentëve, në përputhje me standardet më të mira të cilësisë në mësimdhënie dhe prioritetet akademike të institucionit (Evidenca 1.7). Objektivat kryesorë të programit janë: • Formimi i specialistëve të aftë për modelimin, simulimin dhe analizën e proceseve kimike në funksion të një industrie të qëndrueshme dhe inovative (Evidenca 1.7). • Zhvillimi i kompetencave në automatizim dhe teknologji të gjelbra për të rritur efikasitetin dhe për të ulur ndikimin mjedisor (Evidenca 1.7). • Promovimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit në fushat e energjisë, materialeve dhe bioteknologjisë industriale (Evidenca 1.7). • Përgatitja praktike përmes bashkëpunimeve me industrinë, projekteve dhe praktikave profesionale (Evidenca 1.7).

	• Zbatimi i parimeve të sigurisë dhe menaxhimit të rrezikut në projektimin dhe funksionimin e proceseve kimike komplekse (Evidenca 1.7). Përmbushja e këtyre objektivave mbështetet nga një trupë akademike e kualifikuar dhe struktura mësimore bashkëkohore (Evidenca 1.6). Programi përfshin lëndë bazë dhe karakterizuese për një formim të përgjithshëm në inxhinieri kimike, si dhe lëndë integruese dhe plotësuese që pasurojnë profilin profesional të studentëve (Evidenca 1.9; Tabela 9, ASCAL). Orët laboratorike kanë një peshë të konsiderueshme në planin mësimor, me grupe të vogla (10–15 studentë) që garantojnë angazhim praktik dhe zhvillim të aftësive analitike (Evidenca 3.6). Laboratorët janë të pajisur me aparatura moderne që sigurojnë zhvillim cilësor të seancave mësimore (Evidenca 1.13.1). Lëndët me komponentë laboratorikë përfshijnë: • “Proceset e ndarjes në inxhinieri kimike I & II” – 2 orë lab/javë, • “Transporti i Impulsit dhe Nxehësisë” – 2 orë lab/javë, • “Projektimi i proceseve dhe impianteve I & II” – 2 orë lab/javë, • “Inxhinieria e Proceseve të Industrisë Ushqimore” – 3 orë lab/javë, • “Inxhinieria e Proceseve Biokimike” – 1.5 orë lab/javë, • “Shkenca e materialeve” (lëndë integruese) – 3 orë lab/javë, • “Simulimi dhe Optimizimi i Proceseve” (lëndë plotësuese) – 2 orë lab/javë (Evidenca 1.9; Tabela 13, ASCAL). Syllabuset përditësohen rregullisht nga Departamenti i Kimisë Industriale (Evidenca 1.30), ndërsa detyrat e kursit kontribuojnë në thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe mendimit kritik (Evidenca 3.11).
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi Master i Shkencave në Inxhinieria e Proceseve Kimike siguron zhvillimin e kompetencave të avancuara në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit përmes lëndëve “Projektimi i Proceseve dhe Impianteve I & II” si edhe “Simulimi dhe Optimizimi i Proceseve në Inxhinierinë Kimike”. Këto lëndë realizohen në laboratorin e Inxhinierisë Kimike, i cili është i pajisur me 25 kompjuterë dhe me teknologji bashkëkohore që mbështesin mësimdhënien dhe ushtrimet praktike (Evidenca 1.9; Evidenca 1.13.1; Evidenca 1.13.2). Ky laborator, i ngritur në kuadër të “Paktit për Universitetin” (Qershor 2019), u mundëson studentëve

	përpunimin statistikor dhe trajtimin matematikor të të dhënave eksperimentale, duke forcuar aftësitë analitike dhe dixhitale. Të gjitha lëndët ofrohen gjithashtu në gjuhën angleze (Evidenca 1.10.1), dhe stafi akademik zotëron kualifikime gjuhësore dhe profesionale për të garantuar mësimdhënie cilësore në gjuhë të huaj (Evidenca 1.15; Evidenca 2.37). Studentët përfitojnë nga mobiliteti akademik në kuadër të programeve si Erasmus+, duke zhvilluar aftësi ndërkulturore dhe ndërveprim në kontekste ndërkombëtare (Evidenca 2.46). Fakulteti aplikon gjithashtu module të edukimit në distancë, në kuadër të bashkëpunimeve me projekte europiane, duke rritur fleksibilitetin dhe qasjen e studentëve ndaj burimeve moderne të informacionit (Evidenca 1.38.1).
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti janë të përcaktuara qartë në programin e studimit dhe në syllabuset e çdo lënde (Evidenca 1.10.1). Në përfundim të çdo lënde, ato analizohen si pjesë e vlerësimit të vazhduar, përmes pjesëmarrjes në seminare, praktikave laboratorike, kolegiumit, provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit dhe provimit final (Evidenca 1.10.1; Evidenca 2.38; Evidenca 2.3; Evidenca 3.7.4). Pas përfundimit të seancave laboratorike, pedagogët analizojnë rezultatet individuale dhe vlerësojnë përvetësimin e kompetencave të parashikuara në program. Në përfundim të çdo moduli, personeli akademik përsërit materialin teorik e praktik, thekson çështjet kyçe dhe udhëzon studentët për mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të provimit përfundimtar (Evidenca 3.22).
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia në programin Master "Inxhinieria e Proceseve Kimike" bazohet në kompetenca të qarta, të përcaktuara në syllabus-in e çdo lënde (Evidenca 1.10.1), duke ndërthurur formimin teorik me përvojën praktike në laboratorë dhe ambiente profesionale (Evidenca 2.3.2; Tabela 9 & 13 ASCAL). Studentët aplikojnë njohuritë në zgjidhjen e problemeve konkrete dhe analizën e rezultateve gjatë seancave praktike. Personeli akademik nxit diskutimin, punën në grup dhe pjesëmarrjen aktive përmes detyrave të kursit, ushtrimeve dhe leksioneve interaktive, duke krijuar një klimë bashkëpunuese që favorizon mendimin kritik dhe zhvillimin e ideve inovative (Evidenca 3.23; 3.11; 1.10.1). Kërkimi shkencor mbështetet nga projekte kombëtare dhe ndërkombëtare si Erasmus+, NETCHEM, ADRION, etj., ku studentët marrin pjesë në shkolla verore, konferenca dhe seminare,

	duke përfituar nga mobiliteti akademik dhe ndërdisiplinor (Evidenca 1.2.2; 1.38.1; 1.38.5; 1.23; 2.46; Tabela 20 ASCAL). Programi ka lidhje të drejtpërdrejta me tregun e punës përmes marrëveshjeve me kompani si “Gjergj Kastrioti”, “Lufra”, “Integrated Energy” dhe të tjera, të cilat ofrojnë mundësi trajnimi dhe internshipi për studentët (Evidenca 1.22; 1.35; 1.21).
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik efektiv dhe me kontratë në programin Master “Inxhinieria e Proceseve Kimike” angazhohet rregullisht në organizimin dhe zhvillimin e orëve të hapura, seminareve dhe aktiviteteve shkencore, të cilat trajtojnë zhvillimet më të fundit në fushën e shkencës dhe teknologjisë. Këto veprimtari realizohen si pjesë e strukturës së programit të studimit, por edhe jashtë saj, në formë bashkëpunimi me projekte kërkimore, partnerë institucionalë dhe iniciativa ndërkombëtare. Seminaret dhe orët e hapura përfshijnë tema si: teknologjitë e reja në proceset kimike, zgjidhje inovative për industrinë, aplikime të inteligjencës artificiale në modelimin e proceseve, si dhe zhvillime në energjinë e rinovueshme dhe menaxhimin e mbetjeve. Këto sesione udhëhiqen nga pedagogë me eksperiencë kërkimore dhe përfshijnë studentët në diskutime, prezantime dhe analiza praktike. Aktivitetet zhvillohen si brenda mjediseve të fakultetit, ashtu edhe në kuadër të projekteve si Erasmus+, NETCHEM, ADRION, etj., duke mundësuar mobilitet akademik, shkëmbim përvojash dhe përfshirje në rrjete kërkimore rajonale dhe evropiane (Evidenca 1.2.2; 1.38.1; 1.38.5; 1.23; 2.46; Tabela 20 ASCAL). Kjo qasje jo vetëm që përmbush objektivat akademike të programit, por edhe rrit kapacitetet profesionale të studentëve, duke i përgatitur për sfidat e tregut të punës dhe për studime të mëtejshme në nivel doktorature.
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Studentët e programit Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike” inkurajohen të zhvillojnë ide inovative dhe të angazhohen në kërkime të avancuara përmes temave të diplomës dhe pjesëmarrjes në aktivitete shkencore, me mbështetjen e stafit akademik (Evidenca 1.25; Evidenca 1.4). Idetë dhe projektet studentore, veçanërisht ato që lidhen me teknologjitë e reja në industrinë kimike, trajtohen dhe diskutohen në kuadër të Grupit Mësimor-Kërkimor, ku stafi nxit pjesëmarrjen e tyre në mobilitete, konferenca e seminare studentore (Evidenca 1.4; Evidenca 1.25; Evidenca 1.13.1). Universiteti i Tiranës mbështet financiarisht aktivitetet e Këshillave Studentore dhe në bashkëpunim me Fakultetin e

	Shkencave të Natyrës dhe Departamentin e Kimisë Industriale, siguron pajisje laboratorike dhe mbështetje materiale për zbatimin e projekteve inovative studentore (Evidenca 1.1; Evidenca 1.13.1).			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinierinë e Proceseve Kimike garanton zhvillimin e kompetencave në teknologjinë e informacionit, komunikim, ndërveprim, si dhe në gjuhë të huaj, përmes integritetit të lëndëve të specializuara, punës praktike në laboratorë modernë dhe përdorimit të platformave digjitale.</i> <i>Mësimdhënia bazohet në rezultate të të nxënësve të formuluar në formë kompetencash, të cilat shqyrtohen dhe vlerësohen në mënyrë të vazhduar në përfundim të çdo lënde. Pedagogët orientojnë studentët mbi çështjet thelbësore dhe mënyrat e vlerësimit përmes metodave të integruara si seminare, punë laboratorike dhe detyra kursi.</i> <i>Programi mbështet zhvillimin e ideve inovative dhe punës kërkimore të studentëve, duke ofruar mjedise laboratorike të pajisura, përfshirje në projekte kërkimore dhe mbështetje financiare për pjesëmarrje në aktivitete shkencore e mobilitet ndërkombëtar.</i> <i>Mësimdhënia është ndërvepruese dhe praktike, e orientuar drejt zhvillimit të mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve përmes punës në grup, diskutimeve, dhe bashkëpunimit me institucione e kompani partnere. Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës sigurojnë mbështetje institucionale dhe financiare për përfshirjen aktive të studentëve në kërkime dhe inovacion.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Kimisë Industriale hartojnë një procedurë të posaçme për mbrojtjen e temës shkencore përpara diplomimit në programin Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike” (Evidenca 1.5, Evidenca 1.6, Evidenca 1.10.3). Kjo procedurë, së bashku me rregulloren e programit të studimit, rregulloren e diplomimit dhe udhëzimet për shkrimin e diplomës, bëhet publike në faqen elektronike të departamentit ose përmes adresave elektronike përkatëse (Evidenca 1.9).

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik, përfshirë kujdestarët, Përgjegjësin e Departamentit dhe sekretarinë mësimore, asistojnë studentët në prag të diplomimit duke u vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale përkatëse për realizimin e punimit të diplomës, si në mënyrë direkte ashtu edhe përmes faqes zyrtare të FSHN (Evidenca 1.29, Evidenca 1.10.3, Evidenca 3.7.3, Evidenca 1.6, Evidenca 1.8.3).
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Temat e punimit të diplomës bazohen në njohuritë e fituara gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha grup-lëndët e programit (Evidenca 1.6, Evidenca 1.10.3). Komisioni për administrimin e mbrojtjes së diplomës, i ngritur nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratuar nga Dekani (Evidenca 1.6, Evidenca 3.26), vlerëson studentin sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Diplomimit (Evidenca 1.10.3).
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Çdo student mund të zgjedhë një udhëheqës shkencor nga personeli akademik i Departamentit të Kimisë Industriale, i cili ka përvojë në fushën përkatëse të punimit të diplomës (Evidenca 1.10.3). Udhëheqësi orienton dhe asiston studentin në përcaktimin e temës, përgatitjen e propozimit, rekomandimin e literaturës dhe burimeve të tjera, si dhe në përpunimin e rezultateve dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar (Evidenca 1.10.3, Evidenca 1.10.4, Evidenca 3.7.3). Ai gjithashtu garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton përfundimin e punimit përpara paraqitjes së tij para komisionit (Evidenca 1.10.3).
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Departamenti i Kimisë Industriale asiston studentët në realizimin e matjeve, analizave dhe testeve, në përputhje me tematikën dhe fushën e studimit të tyre. Kjo mbështetje ofrohet si në ambientet laboratorike të departamentit, të pajisura me aparatura bashkëkohore (Evidenca 1.13.2; 1.13.3), ashtu edhe në mjediset të jashtme, si p.sh. në Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, kur kërkohet ekspertizë specifike (Evidenca 3.31). Personeli akademik dhe ndihmës akademik udhëheq studentët gjatë procesit eksperimental, duke siguruar cilësi dhe përputhje me objektivat e punimeve të diplomës dhe kërkimit shkencor.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Proçedura e mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të diplomës bazohet në Rregulloren e programit të studimit dhe Rregulloren e Diplomimit (Evidenca 1.6, Evidenca 1.10.3). Mbrojtja zhvillohet në prani të një komisioni Ad-hoc të ngritur nga Përgjegjësi i Departamentit, dhe vlerësimi bëhet bazuar në pikët totale të marra nga studenti (Evidenca 1.1, Evidenca 1.10.3). Në përfundim të provimit, studenti vlerësohet me notë, ku nota 5-10 është kaluese.

	Ky vlerësim pasqyrohet në procesverbalet e firmosura nga anëtarët e komisionit dhe depozitohet në sekretarinë mësimore (Evidenca 3.27).
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të programit të studimit Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike”, pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve akademike, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj (Evidenca 1.1, Evidenca 1.6, Evidenca 1.10.4). Diploma është dokument zyrtar dhe regjistrohet sipas procedurave të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin (Evidenca 1.3). Studentët që përfundojnë me nota dhjeta pajisen me Çertifikatën “Medalje e Artë”, ndërsa ata që kanë 80% nota 10 dhe pjesën tjetër 9, marrin Çertifikatën “Student i Shkëlqyer” (Evidenca 1.3). Pas diplomimit, studenti mund të kërkojë kopje të plotë zyrtare të programit të studimit dhe syllabuseve përkatëse.
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sipas Ligjit 80/2015, neni 101, sekretaria mësimore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës mban regjistrin themeltar të studentëve, i cili përfshin të dhënat personale dhe mbahet në formë të shkruar dhe elektronike, me ruajtje të përhershme (Evidenca 3.28). Ajo është përgjegjëse për administrimin dhe mirëmbajtjen e këtij regjistri. Po ashtu, mbahet regjistri i arritjeve akademike dhe i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave (Evidenca 3.29, Evidenca 1.3, Evidenca 3.30). Informacioni për studentët paraqitet rast pas rasti për palët e interesuara dhe institucione të përkatshme, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të brendshme (Evidenca 4.18).
Konkluzione	Procedura për detyrimet përmbyllëse: Institucioni harton procedura të qarta dhe të detajuara për detyrimet përmbyllëse, duke siguruar që ato të jenë të njohura dhe të publikuara në mënyrë transparente për studentët, duke përfshirë informacionet e nevojshme për përmbylljen e këtyre detyrimeve. Mbështetje dhe asistencë për studentët: Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ofrojnë asistencë të plotë për studentët, duke u siguruar atyre informacion, udhëzime dhe materialet e nevojshme për përmbylljen e detyrimeve përmbyllëse. Ky proces ndihmon në krijimin e kushteve për realizimin e suksesshëm të punimeve të diplomës dhe detyrave të tjera akademike. Komisioni i administrimit të provimit final: Komisioni i posaçëm që administron provimin final është përgjegjës për vlerësimin e njohurive të marra gjatë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët dhe modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës së tyre specifike. Ky proces siguron një vlerësim të drejtë dhe të plotë të performancës akademike të studentëve.

	Ndihma e udhëheqësit të diplomës: Udhëheqësit e diplomës ofrojnë orientim dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët në përcaktimin e temave të punimeve të diplomës, nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre dhe shkrimin e punimeve. Ata sigurojnë që punimi të jetë i plotë dhe i përshtatshëm për t'u paraqitur për vlerësim në komision. Asistenca për matjet, analizat dhe testet: Institucioni ofron mbështetje të plota për studentët që realizojnë matje, analiza dhe teste, duke siguruar mjedise të përshtatshme laboratorike dhe mundësi për kërkime, si brenda institucionit ashtu edhe jashtë tij, në përputhje me tematikën dhe fushën e studimit. Vlerësimi i provimit përfundimtar: Në përfundim të provimit përfundimtar ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë, duke siguruar që vlerësimi të jetë objektiv dhe i bazuar në performancën e tij gjatë gjithë periudhës akademike. Diploma dhe suplementi i diplomës: Pas përfundimit të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të cilat janë të miratuara nga ministria përkatëse. Kjo garanton që diplomimi të jetë i njohur dhe të ofrojë informacion të plotë për programin e studimit të përfunduar. Ruajtja e dokumentacionit dhe paraqitja e informacionit: Institucioni ruan dokumentacionin e studentëve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe siguron që çdo informacion të mund të paraqitet rast pas rasti për palët e interesuara, duke mbajtur një regjistër të saktë dhe të plotë për studentët dhe arritjet e tyre akademike.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	N/A
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave	N/A

klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.				
Kriteri 3. Praktikant profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N/A			
Konkluzione	N/A			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Referuar dokumentacionit të paraqitur, Departamenti i Kimisë Industriale ka pasur një trupë akademike prej 19 anëtarësh me kohë të plotë (2021–2023), numër që në vitin 2023–2024 u reduktua në 17. (Evidenca 2.11; 1.15). Struktura e stafit përfshinte: 3 “Profesorë Doktorë”, 4 “Profesorë të Asociuar”, 10 me gradën “Doktor i Shkencave” dhe 2 asistentë lektorë me diplomë “Master i Shkencave” në proces doktorature. Gjithashtu, 6 punonjës ndihmës akademikë mbështesnin aktivitetet praktike dhe mirëmbanin laboratorët (Evidenca 2.7; 1.16). Në vitin akademik 2024–2025, personeli akademik përbëhet nga 17 anëtarë: 5 “Profesorë Doktorë”, 8 “Profesorë të Asociuar”, 3 “Doktorë

	Shkencash” dhe 1 pedagoge me diplomë “MSc”. Në lidhje me programin e studimit stafi akademik ka pak ndryshime ndër vite (Tabelat 6.1; 6.2; 6.3; 6.4): 2021 – 2022: PAE/PAK : 12/4 2022 – 2023 : PAE/PAK : 12/4 2023 – 2024 : PAE/PAK : 11/1 2024 – 2025 : PAE/PAK : 11/0 Sipas përcaktimeve ligjore (pika 6 neni 59 i Ligjit Nr 80/2015), personeli akademik (PAE dhe PAK), që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Nga sa më sipër konstatohet se në këtë program studimi Master i Shkencave, angazhohet edhe staf akademik me Msc. <i>GVJ rekomandon që, Institucioni në këtë program studimi, të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</i> Stafi ndihmës përbëhet nga 5 persona me arsim të lartë, ku njëri zotëron dy diploma universitare (Evidenca 4.9.2), dhe një tjetër ka përfunduar Shkollën Pasuniversitare (Evidenca 4.9.1). Këta anëtarë marrin pjesë gjithashtu në projekte, trajnime dhe konferenca për zhvillimin profesional (Evidenca 4.9, 1.16). Departamenti përmbush kërkesat ligjore sipas nenit 25 të Ligjit për Arsimin e Lartë, (Evidenca 1.15). Përvoja e gjatë e stafit në mësimdhënie dhe kërkim, si dhe angazhimi në projekte dhe zhvillimin e lëndëve, është një nga pikat e forta të këtij departamenti (Evidenca 1.17; 1.17.1). Fushat kërkimore janë të lidhura ngushtë me programin e studimit dhe zhvillimet bashkëkohore në inxhinieri kimike, duke krijuar një mjedis dinamik dhe të angazhuar (Evidenca 1.7; 2.29; 1.35).		
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Sipas udhëzimit nr. 1, datë 14.1.2020 të Ministrisë së Arsimit, personeli akademik me kohë të plotë duhet të sigurojë të paktën 70% të ngarkesës mësimore në një program studimi (Evidenca 4.1). Në përputhje me këtë kërkesë ligjore, stafi akademik efektiv i Departamentit të Kimisë Industriale mbulon 76% të ngarkesës mësimore në programet që ofron ky departament (Evidenca 2.14; 2.19).		
	Viti Akdemik	PAE	PAK

	2022-2023	75 %	25 %
	2023-2024	91.66% %	8.33% %
	2024-2025	100 %	0 %
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Në përputhje me nenin 72 të Statutit të Universitetit të Tiranës, procesi i punësimit për personelin akademik ndjek të gjitha hapat e përcaktuara nga legjislacioni për Arsimin e Lartë, (Evidenca 1.1). Këto kontrata janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe përfshijnë elementë kyç si të dhënat identifikuese të palëve, vendin e punës, detyrat që do të ushtrohen, datën e fillimit, kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës, orarin dhe kohën e pushimit, si dhe pagën përkatëse. Personeli akademik që angazhohet në programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Kimisë Industriale – qofshin këta efektivë, me kontratë, apo ndihmës akademikë – gëzojnë të gjitha të drejtat që burojnë nga një marrëdhënie e rregullt pune, përfshirë mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore (Evidenca 4.2; 4.3).		
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Rekrutimi i stafit të ri pranë Universitetit të Tiranës realizohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Protokoll-Arshivës në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (Evidenca 1.1; 4.4). Për çdo shpallje, ngrihet një komision ad-hoc i cili, brenda 10 ditëve nga mbyllja e aplikimeve, verifikon nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike të përcaktuara në thirrje (Evidenca 4.4.1). Përzgjedhja zhvillohet në dy faza: shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervista. Vetëm kandidatët që kualifikohen në fazën e parë ftohen për intervistë (Evidenca 1.1; 4.4). Brenda tre ditëve nga intervista, komisioni shpall kandidatin fitues, njoftim që publikohet në mjediset e dekanatit dhe në faqen zyrtare të FSHN (Evidenca 4.5; 1.32; 4.6.1). Brenda 10 ditëve nga shpallja, Rektori nënshkruan kontratën e punës me kandidatin, duke formalizuar marrëdhënien e punës (Evidenca 1.1).		
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Departamenti i Kimisë Industriale mbështetet nga një staf ndihmës akademik prej 5 anëtarësh, të cilët posedojnë kualifikimet dhe përvojën e nevojshme për të asistuar në realizimin e praktikave laboratorike dhe për të mirëmbajtur ambientet laboratorike e mësimore, në përputhje me karakteristikat e veçanta të programit të studimit (Evidenca 1.16). Secili prej tyre është i specializuar sipas fushës apo grupit të lëndëve ku kontribuon drejtpërdrejt (Evidenca 2.7). Të gjithë anëtarët e këtij stafi kanë arsim të lartë,		

	ndërsa një prej tyre zotëron dy diploma universitare (Evidenca 4.9.2). Disa prej tyre janë aktivë edhe në projekte, konferenca dhe trajnime, duke ndihmuar në përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive profesionale (Evidenca 4.9; 4.9.1; 2.37.1). Personeli ndihmës ka gjithashtu një përvojë të konsiderueshme në fushën ku janë të angazhuar (Evidenca 1.16).
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtar në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Përgjegjës për administrimin e të dhënave të personelit akademik të angazhuar në programet e studimit në Universitetin e Tiranës janë Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Protokoll-Arshivës, të cilët funksionojnë në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme (Evidenca 1.3; 4.7). Këto struktura mbajnë dosje individuale për çdo pedagog të brendshëm, ku një kopje u vihet në dispozicion edhe njësisë të Burimeve Njerëzore në fakultete përkatëse (Evidenca 4.6; 4.6.1). Dosja përmban dokumentacionin standard që përfshin kërkesën për punësim, CV-në, diplomën dhe listën e notave, dëshmi për njohjen e gjuhëve të huaja, çertifikata trajnime, tituj dhe grada shkencore, të dhëna bankare, fotokopje të ID-së, librezë pune, formular teknik dhe një fletë inventari të dokumenteve të përfshira, si dhe dokumente të tjera shtesë sipas rastit. Në fillim të çdo viti akademik përcaktohen emrat e stafit akademik dhe ngarkesa individuale, si semestrale ashtu edhe vjetore, për secilin prej tyre që angazhohet në programin Master në "Inxhinieria e Proceseve Kimike" (Evidenca 2.7, 2.19). Planifikimi i aktivitetit vjetor të punës përfshin ndarjen e kohës ndërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe angazhimeve të tjera institucionale e profesionale dokumentohet në raportet vjetore të veprimtarisë së Departamentit të Kimisë Industriale (Evidenca 1.35), ndërsa çdo pedagog përditëson rregullisht të dhënat përkatëse në CV-në personale (Evidenca 2.8).
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Departamenti i Kimisë Industriale (DKI), në bashkëpunim të ngushtë me Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN) dhe Universitetin e Tiranës (UT), ka ndërtuar një mekanizëm të qartë për të siguruar personel të mjaftueshëm, të kualifikuar dhe të specializuar në funksion të realizimit të programit të studimit. Ky personel mbulon jo vetëm procesin e mësimdhënies teorike dhe praktike, por gjithashtu ofron mbështetje, këshillim dhe mbikëqyrje gjatë praktikave profesionale, punimeve të diplomës dhe aktiviteteve të tjera të specializuara, duke garantuar cilësinë dhe seriozitetin e procesit formues të studentëve (Evidenca 1.22). Për të forcuar lidhjen ndërmjet formimit akademik dhe kërkesave të tregut të punës, institucioni ka formalizuar marrëveshje

	bashkëpunimi me kompani dhe institucione të sektorit industrial dhe akademik. Këto marrëveshje, të dokumentuara dhe të arkivuara në mënyrë të rregullt (Evidenca 1.22.1; Evidenca 1.22.2), parashikojnë mbështetje konkrete për studentët gjatë periudhave të praktikës profesionale, duke u ofruar atyre një eksperiencë të drejtpërdrejtë në mjediset e punës. Gjithashtu, marrëveshjet përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e palëve në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e performancës së studentëve, duke siguruar integritimin e teorisë me praktikën dhe krijimin e një baze reale për zhvillimin profesional (Evidenca 1.22.3). Bashkëpunimi ndërmjet universitetit, departamentit dhe partnerëve industrialë ka krijuar një mbështetje të qëndrueshme për zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, duke i ndihmuar ata të përshtaten më lehtë me tregun e punës dhe të rrisin mundësitë e punësimit pas diplomimit (Evidenca 1.22.4; 1.22.5). Çdo student që ndjek praktikë apo përgatit punim diplome ka të caktuar një mentor akademik dhe, kur është e mundur, edhe një mbikëqyrës nga industria, duke u mbështetur nga pedagogë me përvojë dhe kualifikime përkatëse (Evidenca 1.15; 1.17; 1.17.1; 2.29). Përzgjedhja e temës së diplomës bëhet nga vetë studentët në bashkëpunim me profesorin e zgjedhur, ndërsa miratimi dhe caktimi i mentorit final kryhet nga Departamenti i Kimisë Industriale (Evidenca 2.29).
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Për këtë kriter, GVB nuk ka paraqitur ndonjë koment apo argumentim me arsyetimin se aplikohet për programet “Master Profesional”. Në fakt nga leximi me kujdes i kriterit, nënkuptohet që aplikohet si për programet Bachelor ashtu dhe programet Master. Nga dokumenti shqyrtuar dhe evidencat e paraqitura, IAL dhe FSHN kanë marrëveshje specifike për realizimin e praktikave profesionale të studenteve (Evidenca 1.21; 1.22; 1.22.1; 1.22.2; 1.22.3)
Konkluzione	<i>Departamenti i Kimisë Industriale në Universitetin e Tiranës ka një trupë akademike të kualifikuar dhe me përvojë, e cila plotëson kërkesat ligjore dhe profesionale për mbulimin e programit të studimit. Stafit akademik efektiv mbulon përqindjen e kërkuar të ngarkesës mësimore dhe gëzon kontrata pune të rregullta dhe kushte të përshtatshme pune, duke garantuar qëndrueshmëri gjatë gjithë periudhës së akreditimit. Procesi i rekrutimit dhe përzgjedhjes së stafit bazohet në kritere të qarta dhe transparente, ndërsa administrimi i të dhënave të personelit bëhet në mënyrë të strukturuar dhe të përditësuar. Stafit ndihmës akademik është i</i>

	<i>mjaftueshëm dhe i kualifikuar për të mbështetur orët laboratorike dhe mirëmbajtjen e ambienteve mësimore. Institucioni ka bashkëpunime me kompani të industrisë dhe ofron mbështetje për studentët në realizimin e praktikës profesionale dhe punimit të diplomës, përmes mentorëve akademikë dhe mbikëqyrësve nga industria. Gjithashtu, organizohen aktivitete shtesë si seminare, workshope dhe vizita për të forcuar lidhjen ndërmjet teorisë dhe praktikës. Rekomandohet që praktika profesionale të përfshihet në kurrikulën mësimore. Rekomandohet që, Institucioni në këtë program studimi, të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Veprimtaria e Departamentit të Kimisë Industriale (DKI) zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në katër godina (A, B, C, D) dhe dy laboratorë në një godinë njëkatëshe, me një sipërfaqe totale prej 13,223.64 m² (Evidenca 1.13). Këto ambiente ofrojnë kushte të përshtatshme për zhvillimin cilësor të programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieria e Proceseve Kimike”, me një raport prej 4.9 m²/student, që tejkalon standardin ligjor prej 2.5 m²/student sipas VKM nr. 418, datë 10.5.2017 (Evidenca 1.27.1). Godinat përmbajnë zyra, salla leksionesh dhe seminare (totali: 2,571 m²), si dhe laboratorë me një sipërfaqe totale prej 3,475.5 m². Programi Master përdor pesë laboratorë, me një sipërfaqe totale prej 260 m² – katër në godinën A dhe një në godinën B (Evidenca 1.13.2). Këto përfshijnë: Laboratorin e Inxhinierisë Kimike I – 15 poste (40.1 m², godina A) Laboratorin e Inxhinierisë Kimike II (modelim/simulim) – 24 poste (90.2 m², godina A) Laboratorin e Biomassës – (29.5 m², godina njëkatëshe) Laborator për lëndën Shkencë e Materialeve – (51.2 m², godina B) Sallat ku zhvillohen leksionet/seminaret kanë

	kapacitet nga 48 deri në 150 studentë, ndërsa laboratorët 15–24 poste, duke qenë të mjaftueshme për numrin aktual të studentëve të programit (Evidenca 1.27.1.2). Të gjitha ambientet janë të pajisura me infrastrukturën bazë mësimore dhe pajisje laboratorike në funksion të moduleve të programit (Evidenca 4.8).
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës siguron mjedise të përshtatshme për mësimdhënie dhe punë të pavarur, përmes klasave dhe zyrave të pajisura me teknologji bashkëkohore dhe mjete elektronike (Evidenca 1.13). Programi Master në “Inxhinieria e Proceseve Kimike” shfrytëzon salla leksionesh, seminare dhe laboratorë për realizimin e objektivave të tij. Sallat e leksioneve në godinat A, B dhe D janë të pajisura me videoprojektorë fikse, ndërsa për seminarët përdoren edhe pajisje portabël (projektorë dhe kompjuterë) në dispozicion të stafit (Evidenca 4.8; 3.5; 3.5.1). Pajisje të specializuara fikse ndodhen vetëm në laboratorët ku kërkohen për lëndë të veçanta; në raste të tjera përdoren pajisje lëvizëse. Të gjitha godinat kanë akses në rrjet wireless, ndërsa salla 113A shërben si laborator kompjuterik për punë inxhinierike dhe për diplomantët. Stafi ka në dispozicion kompjuterë në zyra, si dhe pajisje për printim e skanim në sallën 109A (Evidenca 1.13.1; 3.5.1).
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës siguron aparatura, pajisje dhe ambiente të përshtatshme, në përputhje me karakteristikat e programit të studimit, për të përmbushur kërkesat e moduleve, formimin teorik dhe praktik të studentëve. Programi Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike” zhvillon pjesën praktike në laboratorë të pajisur me aparatura dhe reagentë sipas nevojave të çdo lënde dhe përmbajtjes së syllabus-it (Evidenca 1.10.1; 1.13.2; 3.5.2). Janë kryer investime të vazhdueshme për përmirësimin e kushteve laboratorike, të cilat janë në gjendje shumë të mirë në shumicën e rasteve. Laboratorët janë rikonstruktuar së fundmi dhe janë pajisur me mobilim të ri dhe sistem aspirimi, si dhe me aparatura specifike për çdo praktikë (Evidenca 1.13.2). Në veçanti, laborator i Inxhinierisë Kimike është përmirësuar me pajisje moderne, në kuadër të një projekti të mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, në kuadër të “Paktit për Universitetin” (Evidenca 4.10).
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të	Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron disa laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me softuer profesional në përputhje me natyrën e programeve të studimit (Evidenca 1.13).

pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në total, janë në dispozicion tetë laboratorë informatike, të vendosur në godinat B dhe C. Çdo departament, përfshirë Kimia Industriale, disponon të paktën një laborator kompjuterik të pajisur me programe specifike që mbështesin mësimdhënien dhe kërkesat e moduleve. Për shembull, në laboratorin mësimor të Inxhinierisë Kimike përdoren softuerë të specializuar për simulim, modelim dhe optimizim të proceseve, si Eindoës, Microsoft Office, Visio, Lingo, Aspen Plus, Hysys dhe MATLAB (Evidenca 1.13.2). Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme dhe administrohen nga staf ndihmës i specializuar për mirëmbajtjen dhe funksionimin e tyre (Evidenca 2.33; 3.5.2).
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	Programi “Master i Shkencave në Inxhinierinë e Proceseve Kimike” ka një profil të theksuar aplikativ, çka bën të domosdoshme zhvillimin e praktikave profesionale në mjediset e industrisë prodhuese. Për të garantuar këtë proces, institucioni ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani të ndryshme, të cilat krijojnë kushte për përfshirjen e studentëve në praktika reale pune (Evidenca 1.22). Krahas këtyre bashkëpunimeve, institucioni ka në dispozicion edhe kapacitete të mjaftueshme të brendshme, që mundësojnë realizimin e aktiviteteve të tjera praktike dhe mësimore në ambientet e tij akademike (Evidenca 1.13.2)
Konkluzione	<i>Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe veçanërisht Departamentit të Kimisë Industriale, ka siguruar një infrastrukturë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për realizimin efektiv të procesit mësimor dhe formimit praktik në programin Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike”. Mjediset mësimore përfshijnë godina të pajisura me salla leksionesh, seminare dhe laboratorë të dedikuar për lëndët specifike, me kapacitet që i përgjigjet numrit aktual të studentëve. Sipërfaqja për student është mbi standardin ligjor, ndërsa infrastruktura didaktike dhe teknologjike (projektorë, kompjuterë, akses interneti, laboratorë kompjuterikë etj.) mbështet zhvillimin e proceseve teorike dhe praktike në përputhje me kërkesat e programeve të studimit. Laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe reagentë në përputhje me syllabus-et, ndërsa janë kryer edhe investime në rikonstruksion dhe pajisje moderne, përfshirë edhe përfitimin nga projekte kombëtare infrastrukturore. Për aspektin e teknologjisë së informacionit, janë të disponueshëm tetë laboratorë informatike të pajisur me</i>

	programe profesionale, përfshirë softuerë të avancuar duke përmbyshur plotësisht kriterin për mjetet digjitale në funksion të mësimdhënies. Lidhur me praktikën profesionale, institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me subjekte të industrisë prodhuese, duke garantuar zhvillimin e praktikave në përputhje me natyrën aplikative të programit. Gjithashtu, zotëron kapacitete të brendshme për zhvillimin e veprimtarive praktike të tjera në ambientet e veta.			
Shkalla e përmbyshjes së standardit	Nuk përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në fillim të çdo viti akademik, pedagogët dorëzojnë në departament syllabuset e lëndëve të tyre, të cilat janë hartuar sipas programit të studimit dhe përmbajnë të dhëna mbi literaturën bazë dhe atë shtesë që u nevojitet studentëve (Evidenca 1.10.1; Tabela 14 ASCAL). Pjesa më e madhe e literaturës kryesore ofrohet në gjuhën shqipe në formën e teksteve mësimore të përgatitura për studentët (Evidenca 2.25; 4.11). Përveç kësaj, materialet e literaturës bazë shpërndahen edhe në version elektronik nëpërmjet platformës Microsoft Teams (Evidenca 3.7). Studentët përfitojnë gjithashtu akses në bibliotekën online të Universitetit të Tiranës, e cila përfshin burime ndërkombëtare si Edward Elgar Journals, IOP, MSP dhe rrjetin COBISS, duke u siguruar një qasje më të gjerë ndaj literaturës shkencore (Tabela 17 ASCAL)
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Literatura kryesore që u ofrohet studentëve përbëhet nga tekste mësimore të hartuara ose të ribotuar vitet e fundit, si dhe nga përmbledhje leksionesh të përditësuara nga stafi pedagogjik (Evidenca 1.10.1; 2.25). Krahës tyre, procesi i mësimdhënies mbështetet edhe nga burime të tjera akademike si botimet periodike, artikuj shkencorë dhe monografi që pasurojnë fondin studimor dhe shërbejnë për të thelluar njohuritë e studentëve (Evidenca 4.12)
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke	Fakulteti i Shkencave të Natyrës u ofron studentëve shërbim në bibliotekën qendrore që ndodhet në godinën B (Evidenca 1.13).

garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Kjo bibliotekë përbën një nga hapësirat më të rëndësishme të Universitetit të Tiranës, jo vetëm për fondin e gjerë të literaturës, por edhe për numrin e madh të studentëve që e përdorin dhe për cilësinë e shërbimeve që ofrohen. Ajo është e organizuar në tre sektorë kryesorë: Fondi i Hapur i Librit, Fondi i Periodikut dhe Fondi Kryesor me banak shërbimi, duke mbuluar një sipërfaqe prej 678.75 m ² dhe me kapacitet prej 140 vendesh për lexues. Studentët kanë mundësi të konsultojnë materiale elektronike dhe burime online, të cilat plotësojnë procesin e studimit. Biblioteka menaxhohet nga katër punonjës, ku merren me ofrimin e shërbimeve bazë dhe menaxhimin e Buletinit të FSHN (Evidenca 4.13.1; 4.14)
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Sipas rregullores, Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Natyrës mbështet procesin mësimor, formimin profesional dhe veprimtarinë shkencore në të gjitha ciklet dhe programet e studimit të ofruara nga fakulteti (Evidenca 4.13). Ajo siguron literaturën fizike të nevojshme për mbulimin e të gjitha këtyre programeve, përfshirë edhe programin Master i Shkencave në “Inxhinieria e Proceseve Kimike”, i cili përfiton nga fondi ekzistues i teksteve mësimore (Evidenca 2.25).
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Universiteti i Tiranës, ofron akses falas në bibliotekën online ULIBRARY (Evidenca 1.2.2; 1.2.3). Gjithashtu, biblioteka e FSHN është integruar në rrjetin COBISS, ndërsa procesi i dixhitalizimit të fondit të saj është në zhvillim dhe deri më tani është regjistruar 4.62% e koleksionit (Evidenca 4.13.1). Përtej këtyre, stafi akademik dhe studentët kanë mundësi të konsultohen me burime online në fushat përkatëse përmes marrëveshjeve që UT ka lidhur me platforma të njohura ndërkombëtare si JSTOR, EDGAR, IOP, ASTM dhe MSP (Tabela 17 ASCAL). Këtyre burimeve mund t’u aksesohet përmes faqeve zyrtare të UT dhe FSHN duke përdorur adresën institucionale të emailit. Manuali për përdorimin e këtyre shërbimeve është gjithashtu i disponueshëm online (Evidenca 4.14).
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Përdoruesve u janë vënë në dispozicion katër kompjuterë me lidhje interneti dhe akses në burime online, të cilët ndodhen në dy prej fondove të hapura të bibliotekës, kjo është verifikuar edhe nga vizita në institucion (Evidenca 4.13.1).
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit	Biblioteka u shërben studentëve dhe stafit akademik gjatë gjithë ditëve të javës, nga e hëna në të premte. Ajo funksionon në tre ambiente të dedikuara për studim dhe shërbim, me orar 08:00–

mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	16:30 nga e hëna në të enjte, dhe 08:00–14:00 ditën e premte (Evidenca 4.13).
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Çdo vit, njësitë bazë të FSHN përcaktojnë nevojat për literaturë të re, me qëllim përditësimin e fondit ekzistues me botime të përditësuar, në mbështetje të programeve të studimit. Kjo qasje reflektohet edhe në buxhetet vjetore të FSHN, ku parashikohen fonde të dedikuara për blerjen e librave, abonimet në biblioteka dhe burime online, si dhe për periodikë shkencorë, në funksion të nevojave specifike të programeve akademike (Evidenca 4.15).
Konkluzione	<i>Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), ofron një mbështetje të strukturuar dhe të mirëorganizuar për literaturën dhe mjediset që i shërbejnë procesit të mësimdhënies dhe të mësimnxënies për të gjitha ciklet dhe programet e studimit, përfshirë programin Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike”. Literatura bazë dhe ndihmëse dorëzohet rregullisht në formën e syllabus-eve nga pedagogët dhe përmban informacion të përditësuar. Tekstet janë të disponueshme në gjuhën e programit dhe shpërndahen si në formë fizike, ashtu edhe digjitale përmes platformës Microsoft Teams. Biblioteka online e UT-së, si dhe burime të tjera ndërkombëtare (JSTOR, IOP, MSP, etj.), janë të aksesueshme falas për studentët dhe stafin përmes adresës institucionale, duke siguruar qasje të barabartë në literaturën bashkëkohore. Biblioteka qendrore e FSHN është një nga më të mëdhatë në universitet, me fond të pasur dhe të larmishëm, dhe ofron mjedise të dedikuara për studim me orar funksional që përputhet me nevojat e studentëve. Është pajisur me literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj, revista shkencore, si dhe kompjuterë me akses në internet për përdorim të lirë nga studentët. Biblioteka është gjithashtu pjesë e rrjetit COBISS dhe ndodhet në proces të dixhitalizimit, me një pjesë të fondit tashmë të regjistruar. Çdo vit, njësitë bazë përcjellin nevojat për pasurimin e fondit letrar dhe buxhetet e FSHN parashikojnë fonde për blerje librash, abonime dhe përditësime të literaturës.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka një sistem të rregullt për menaxhimin e informacionit mbi studentët dhe aktivitetin e tyre akademik, që nga regjistrimi deri në diplomim. Ky proces realizohet nga sekretaria mësimore për programet e ciklit të dytë dhe administrohet si në format elektronik, ashtu edhe fizik (Evidenca 1.3). Menaxhimi i të dhënave bazohet në Rregulloren e Universitetit të Tiranës (Evidenca 1.3) dhe mbështetet nga infrastruktura e zhvilluar e IT-së (Evidenca 4.16; 4.17). Studentët regjistrohen duke dorëzuar dokumentet sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (Evidenca 1.3). Në lidhje me programin Master në “Inxhinieria e Proceseve Kimike”, sekretaria mësimore e FSHN-së është përgjegjëse për mbajtjen e regjistrimit themeltar me të dhënat personale (Evidenca 3.28), regjistrin e notave (Evidenca 3.29) dhe të dhënat mbi diplomat (Evidenca 3.30), të gjitha të përgatitura sipas standardeve shtetërore (Evidenca 4.18). Sekretaria arkivon gjithashtu dokumente si procesverbalet e provimeve (Evidenca 4.19), dosjet e transferimeve (Evidenca 2.39). Aktiviteti mësimor regjistrohet nga pedagogët në regjistrin personal për çdo orë leksioni apo seminar, ndërsa orët laboratorike shënohen në regjistrin e laboratorit (Evidenca 1.3; 2.38). Gjatë pandemisë COVID-19, mësimi online u dokumentua përmes platformës TEAMS (Evidenca 4.20).
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Në Universitetin e Tiranës, menaxhimi i informacionit dhe dokumentacionit të stafit akademik realizohet nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, konkretisht nga Sektori i Burimeve Njerëzore (Evidenca 4.21). Në nivel fakulteti, përditësimi dhe mirëmbajtja e dosjeve personale të stafit akademik është përgjegjësi e Degës së Burimeve Njerëzore pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës (Evidenca 1.3). Të dhënat administrohen kryesisht në format fizik (hard copy), ndërsa pasurimi i tyre bëhet herë pas here edhe në versionin elektronik. Dosjet personale të stafit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme), ndihmës-

	akademik dhe administrativ përfshijnë dokumente të rëndësishme si diplomat e noterizuara, listat e notave, CV-të, kontratat e punës, dokumentacionin e procedurave të punësimit dhe çdo material tjetër të nevojshëm për angazhimin në Universitetin e Tiranës (Evidenca 4.6).
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Në përputhje me Statutin e Universitetit të Tiranës, si dhe me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, UT dhe njësitë e tij kryesore sigurojnë ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave të studentëve dhe stafit mbi bazën e parimit të besueshmërisë (Evidenca 1.1). Për këtë qëllim, janë hartuar një rregullore specifike dhe një udhëzues i privatësisë, të cilët rregullojnë mbrojtjen dhe menaxhimin e sigurt të të dhënave personale (Evidenca 4.22; 4.22.1). Aksesin në këto të dhëna e ka vetëm vetë personi përkatës, dhe ato nuk u kalohen palëve të treta pa pëlqimin e shprehur të zotëruesit. UT përdor mjete teknologjike moderne për të garantuar sigurinë e bazave të të dhënave. Gjithashtu, platforma "e-Student" ofron akses të dedikuar, të sigurt dhe konfidencial për studentët dhe stafin, përmes identifikimit individual në sistem (Evidenca 4.19; 4.23).
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit të informacionit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN) përfshin platformën Microsoft Teams, e cila është integruar për të lehtësuar komunikimin mes pedagogëve dhe studentëve. Në këtë platformë hapen lëndët e programit të studimit Master i Shkencave "Inxhinieria e Proceseve Kimike", dhe studentët regjistrohen në to pasi pajisen me adresë zyrtare emaili nga Universiteti i Tiranës. Administrimi i çdo lënde në platformë bëhet nga pedagogu përkatës, i cili e përdor për të shpërndarë materiale mësimore, për të dhënë detyra, për të kryer vlerësime të vazhduara, për të organizuar anketa, për të bërë njoftime si dhe për të komunikuar me studentët mbi çështje të veçanta të procesit mësimor (Evidenca 3.7). Ndërkohë, komunikimi mes studentëve dhe njësive administrative të fakultetit realizohet përmes faqeve zyrtare të internetit të Universitetit të Tiranës dhe FSHN-së. Këto faqe përmbajnë informacion të organizuar dhe të përditësuar mbi: strukturën dhe historikun e fakultetit, programet e studimit, kriteret e pranimit, legjislacionin, aktivitetin shkencor të stafit akademik, doktoraturat e mbrojtura, si dhe informacione për vitin akademik, oraret, tarifat dhe formularët e vlerësimit nga studentët. Gjithashtu, aty publikohen njoftime administrative dhe akademike si afatet e provimeve, informacionet për bursa, apo thirrjet për aplikim në programe ndërkombëtare si Erasmus+. Komunikimi individual për

	çështje specifike kryhet përmes adresave personale të emailit të siguruar nga Universiteti për të gjithë studentët dhe stafin (Evidenca 4.23).
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit të informacionit në FSHN mundëson monitorimin e aktiviteteve akademike dhe administrative në kohë reale përmes mjeteve si adresat zyrtare të emailit, platforma Teams, faqja zyrtare e FSHN dhe UT, dhe sistemi “e-Student” (Evidenca 4.24; 4.17). Këto mjete përditësohen rregullisht me informacion të rëndësishëm, si ligje, rregullore, vendime dhe aktivitetet akademike e shkencore të stafit, përfshirë projekte, doktoratura dhe orare mësimore. Komunikimi i brendshëm realizohet përmes platformës Teams, dhe takimet online mund të zhvillohen sipas nevojës. Po ashtu, sistemi “e-Student” lejon stafin të menaxhojë provimet dhe studentët të ndjekin progresin e tyre akademik (Evidenca 4.17.1).
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, informacionet për programin e studimit Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike”, si dhe për personelin akademik dhe aktivitetet e Departamentit të Kimisë Industriale, publikohet dhe përditësohet në disa platforma të ndryshme. Këto përfshijnë faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës, faqen e internetit të FSHN, dhe rrjetet sociale të Departamentit të Kimisë Industriale, si Facebook dhe Instagram. Përditësimi i informacionit në faqen e FSHN, që ka lidhje direkte me Departamentin e Kimisë Industriale, realizohet nga një pedagog i këtij departamenti (Evidenca 4.25). Në faqen e internetit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, mund të gjenden të dhëna të detajuara për programet e studimit që ofron fakulteti, duke përfshirë informacion mbi programin Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike”. Kjo përfshin gjithashtu informacion për kërkimin shkencor të zhvilluar në secilin departament, si dhe njoftime të ndryshme administrative, akademike dhe shkencore. Për programin Master i Shkencave “Inxhinieria e Proceseve Kimike”, faqja ofron informacion të detajuar si: Përshkrimi i përgjithshëm i programit, Planet mësimore, Syllabus-et për çdo lëndë të çdo viti akademik, Informacion mbi stafin akademik, duke përfshirë CV-të përkatëse. Për momentin, informacioni është në gjuhën shqipe, por po punohet gjithashtu për ta pasqyruar atë edhe në anglisht, dhe disa pjesë të tij tashmë janë të disponueshme në këtë gjuhë.
Konkluzione	<i>Nga analiza e dokumentacionit dhe evidencave të paraqitura, rezulton se Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) në</i>

	Universitetin e Tiranës ka ngritur dhe funksionon një sistem të brendshëm menaxhimi që mbështet në mënyrë efektive administrimin, informimin dhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar dhe administrativ të programit të studimit Master në “Inxhinieria e Proceseve Kimike”. Sistemi i menaxhimit adreson të gjitha aspektet që lidhen me informacionin e studentëve dhe stafit, duke filluar nga regjistrimi deri në diplomim. Ai përfshin platforma të dedikuara për komunikim dhe shkëmbim informacioni, si Microsoft Teams dhe e-Student, të cilat sigurojnë akses të kontrolluar dhe të sigurt për përdoruesit. Gjithashtu, dokumentacioni i personelit akademik dhe administrativ ruhet dhe përditësohet në përputhje me standardet institucionale. Platformat e përdorura lejojnë gjithashtu monitorim në kohë reale të aktiviteteve akademike dhe administrative, ndërsa informacionet përkatëse publikohen në mënyrë të organizuar dhe të përditësuar në faqet zyrtare të internetit të FSHN dhe Universitetit të Tiranës, me përpjekje të dukshme për ta pasqyruar informacionin edhe në gjuhën angleze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Për të garantuar funksionimin financiar të qëndrueshëm të programeve të ciklit të dytë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, në bashkëpunim me departamentet përkatëse, harton raporte financiare dhe pasqyra të detajuara të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat bëhen pjesë e projekt-buxhetit institucional (Evidenca 4.26). Vlerësimi i kostos së programeve, përfshirë Masterin në “Inxhinieria e Proceseve Kimike”, kryhet nga Universiteti i Tiranës duke marrë në konsideratë nevojat e raportuara nga Departamenti i Kimisë Industriale dhe burimet financiare të disponueshme. Ky është një proces standart që fillon me përgatitjen e një draft-buxheti nga DKI mbi bazën e kërkesave të paraqitura nga pedagogët, i cili i përcillet më pas Dekanatit (Evidenca 4.26). Më tej, Administratori i FSHN përpilon planin financiar të përgjithshëm të Fakultetit, i cili miratohet nga Bordi i

	Administrimit i UT (Evidenca 4.15). Sa i përket tarifave të shkollimit, ato përcaktohen çdo vit nga Universiteti i Tiranës në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore përkatëse, konkretisht VKM nr. 638, datë 22.07.2015, me ndryshimet përkatëse (Evidenca 4.27).
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet	GVJ referuar dokumentacionit dhe raportimit të kriterëve të tjera të këtij standarti ndiqet e njejta procedure për planifikimin e buxhetit (Evidences 4.15; 4.26; 4.28). Universiteti i Tiranës harton një plan buxhetor afatmesëm që përditësohet çdo vit dhe është pjesë e planit strategjik të zhvillimit. Administrata financiare është përgjegjëse për përgatitjen e projekt-buxhetit për njësitë ndihmëse, ndërsa së bashku me projekt-buxhetet e njësisë kryesore, përpilon buxhetin vjetor të universitetit. Çdo vit, departamentet paraqesin kërkesat e tyre pranë dekanateve (Evidenca 4.31; 4.32)
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Për të vlerësuar gjendjen financiare dhe efektivitetin e saj, Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës janë audituar në mënyrë të vazhdueshme nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, si dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe strukturën organizative të UT-së (Evidenca 4.31), është krijuar Sektori i Auditit të Brendshëm, i cili funksionon në varësi të Bordit të Administrimit. Ky sektor realizon auditime të përvitshme dhe harton raporte që dokumentojnë gjendjen e financimit dhe përdorimin efektiv të burimeve. Raportet financiare, të përfshira edhe në programin e transparencës, përmbajnë të dhëna të detajuara për të ardhurat dhe ndarjen e fondeve (Evidenca 4.31).
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Në përfundim të çdo viti akademik, hartohen raporte dhe analiza financiare që dokumentojnë ecurinë e buxhetit dhe ruhen sipas legjislacionit mbi arkivën dhe protokollin (Evidenca 4.31). Këto dokumente përmbajnë të dhëna si mbi realizimin e shpenzimeve dhe të ardhurave të viteve të kaluara, ashtu edhe mbi projeksionet financiare për vitin që pason. Informacioni i përmbledhur në këto raporte u përcillet fillimisht strukturave financiare të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe më pas dërgohet edhe tek Departamenti i Kimisë Industriale nga vetë strukturat financiare të Universitetit të Tiranës. Gjithashtu, në kuadër të planifikimeve financiare

	afatmesme përfshihen edhe ndërhyrjet e posaçme buxhetore, me qëllim sigurimin e mbështetjes së pandërprerë për zhvillimin e programeve të studimit dhe përmirësimin e cilësisë së tyre (Evidenca 4.28; 4.32).			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Natyrës, siguron stabilitet financiar dhe kapacitete të mjaftueshme për të mbështetur zhvillimin e pandërprerë të veprimtarisë akademike dhe institucionale, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në të ardhmen. Qëndrueshmëria financiare e UT garanton arritjen e objektivave dhe realizimin e misionit të tij (Evidenca 4.28; Tabela 18 ASCAL). Kjo mbështetje financiare bazohet në disa burime kryesore: grantet e akorduara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të ardhurat nga tarifat e regjistrimit dhe të shkollimit, si edhe të ardhurat e gjeneruara nga shërbimet e ndryshme që ofron institucioni për palë të treta.			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin dhe evidencat, GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës kanë ngritur një sistem funksional dhe të qëndrueshëm për sigurimin e financimit, i cili mbështet mësimdhënien, kërkimin shkencor, zhvillimin e programeve të studimit si dhe përmbushjen e nevojave institucionale dhe studentore. Planifikimi dhe menaxhimi financiar realizohen në mënyrë të rregullt e transparente, përmes hartimit të plan-buxheteve të detajuara që përfshijnë kostot e personelit, mirëmbajtjen e infrastrukturës, pasurimin e burimeve bibliotekare dhe përfshirjen e projekteve apo granteve të ndryshme. Raportimet vjetore, auditimet e brendshme dhe të jashtme, si dhe dokumentimi i gjendjes financiare shërbejnë si mekanizma të llogaridhënies dhe garantojnë efikasitetin institucional. Mbështetja financiare sigurohet nga burime të ndryshme – kryesisht nga MAS, tarifat e studentëve dhe të ardhurat nga shërbime të tjera – duke ofruar qëndrueshmëri, fleksibilitet dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron programin Master i Shkencave në “Inxhinieri të Proceseve Kimike” në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi (Ligji Arsimi të Lartë Kreu VII, Neni 75 fq. 51, Neni 76 fq. 52 dhe Neni 87-92, fq.57-59). Rregulloret institucionale përcaktojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve, nga regjistrimi fillestar, ndjekja e programit, deri te diplomimi. Ato përfshijnë kriteret e pranimit, procedurat për transferimin e studimeve dhe ndjekjen e një programi të dytë (Evidencat 1.1; 1.3; 1.6; 4.18). Përmes këtyre politikave synohet përzgjedhja e kandidatëve më të kualifikuar, duke u bazuar në arritjet e tyre akademike. Gjithashtu, rregullorja përmban të gjitha detajet mbi organizimin e studimeve dhe strukturën e programit (Evidencat 1.3; 1.6; 4.18). Studentët mbështeten dhe orientohen gjatë gjithë periudhës së studimeve nga Kujdestari Akademik, siç parashikohet në Statutin e Universitetit të Tiranës (Evidenca 1.29).
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Ky program studimi është ndërtuar dhe zbatohet duke respektuar lirinë akademike dhe duke siguruar barazi për të gjithë studentët, në përputhje me legjislacionin aktual. Ai garanton mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët që aplikojnë, duke ofruar akses të drejta në shërbime dhe duke bazuar përzgjedhjen në arritjet akademike. (Evidenca 1.1) Studentët përfitojnë nga mundësia për të marrë udhëzime akademike nga Kujdestarët, të përdorin adresat e emailit të krijuara nga universiteti për komunikim zyrtar dhe të kenë akses në platforma si <i>e-Student</i> dhe Microsoft Teams. (Evidencat 1.1; 1.6; 1.3; 3.3) Studentat përfshihen në Këshillat Studentorë, të cilët promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe përfaqësojnë interesat e tyre në strukturat vendimmarrëse të universitetit. (Evidencat 1.1; 1.23) Përveç aktiviteteve shkencore dhe sociale që organizon universiteti, studentët kanë mundësi të aplikojnë për bursa studimi, ulje tarifash dhe mundësi mobiliteti ndërkombëtar, përfshirë bursat Erasmus. (Evidencat 1.6; 1.3) Ata gjithashtu mund të ankimojnë vlerësimet e provimeve dhe të

	kërkojnë këshillim me psikologun në fakultet. Aktivitetet sportive janë gjithashtu pjesë e mundësive për përfshirje, si brenda dhe jashtë universitetit. (Evidencat 5.1; 5.2) Të gjitha informacionet dhe mundësitë ofrohen në mënyrë të rregullt përmes faqeve zyrtare dhe kanaleve të komunikimit të FSHN.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Siç theksohet edhe në RVB: Departamenti i Kimisë Industriale harton kriteret dhe kuotat për pranimin e studentëve në të gjitha programet e studimit që ofron, duke u bazuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Këto dokumente përgatiten jo më vonë se data 10 dhjetor e vitit pararendës dhe i dërgohen fakultetit, i cili ka detyrimin t'i bëjë publike deri më 20 dhjetor. (Evidencat 1.1; 1.28) Kuotat e përcaktuara parashikojnë gjithashtu përfshirjen e kandidatëve nga trojet dhe nga shtresat e marginalizuara. Kriteret dhe kuotat miratohen nga Senati Akademik i UT-së përpara se të hyjnë në fuqi. (Evidencat 1.27; 5.3)
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimin dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Ky program studimi synon t'u ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme bazë, formim të thelluar inxhinierik dhe aftësi profesionale në fushën e Inxhinierisë së Proceseve Kimike. Të gjitha kriteret (Evidenca 1.28), procedurat e pranimin (Evidenca 5.4), transferimit (Evidenca 1.31), vlerësimit dhe diplomimit (Evidenca 5.5) janë të përcaktuara në rregulloren e programit Master i Shkencave në Inxhinierinë e Proceseve Kimike (Evidenca 1.6, Evidenca 1.10.3), si dhe në rregulloren e përgjithshme të UT (Evidenca 1.3). Këto dokumente janë hartuar në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, dhe janë të publikuara në web e fakultetit dhe Universitetit.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UT/FSHN publikon në faqen zyrtare informacionin mbi aplikimin në programin Master Inxhinierisa e Proceseve Kimike (IPK), përfshirë dokumentacionin e nevojshëm, kuotat dhe kriteret e pranimin. Sipas raportit të GVB dhe dokumentacionit përkatës fakulteti organizon ditë informuese ku pedagogët e programit prezantojnë Masterin IPK për studentët e vitit të tretë në: “Kimi she Teknologji Ushqimore” dhe “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, duke i njohur me përmbajtjen, organizimin dhe mundësitë e punësimit që ofron ky program. (Evidenca 5.7) Këto të dhëna janë të disponueshme edhe në faqen e fakultetit, ndërkohë që studentët nga programe të ndryshme informohen sipas një kalendari të caktuar. Gjatë këtyre aktiviteteve shpërndahen materiale dhe broshura informuese mbi programin Master IPK. (Evidenca 5.8)

Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni përgatit dhe publikon çdo vit përpara fillimit të vitit akademik kriteret (Evidenca 1.28) dhe kuotat (Evidenca 1.27) për përzgjedhjen e kandidatëve në këtë program studimi. Gjithashtu në keto kuota përfshihen kandidatet nga Trojet shqiptare por gjithashtu edhe Kandidate me statusin e jetimet apo nga komunitet e tjera.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Departamenti i Kimisë Industriale zbaton udhëzimet e Ministrisë së Arsimit (Evidenca 5.9) për pranimin në programin Master Inxhinieria e Proceseve Kimike (IPK). Gjithashtu, Departamenti parashikon kuota të veçanta pranimi (Evidenca 5.10; Evidenca 1.27.1) për kategori si: persona me aftësi të kufizuara, jetimë, shtetas të huaj, kandidatë nga trojet shqiptare (Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi), si dhe për ata që kërkojnë program të dytë studimi apo transferim nga institucione të tjera.
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	RVB raporton për ekzistencën e politikave mbështetëse që synojnë studentët nga shtresat në nevojë, si edhe ata me rezultate të larta (Evidenca 5.11), me qëllim përmirësimin e cilësisë së pranimin dhe progresit akademik. UT/FSHN ka përcaktuar kriteret të qarta që lejojnë studentët të përfitojnë bursa gjatë studimeve (Evidenca 5.12). Ndër masat mbështetëse të raportuara përfshihet edhe Karta e Studentit (Evidenca 5.13), e cila ofron një gamë shërbimesh dhe lehtësish për jetën studentore. Për studentët që hasin vështirësi ekonomike, UT mundëson përfitimin e Kredisë Studentore (Evidenca 5.14), e cila mbulon kostot e studimeve të larta.
Konkluzione	<i>Institucioni i Arsimit të Lartë ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura të qarta që mbulojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve, nga pranimi deri te diplomimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të brendshme. Evidencat tregojnë se kriteret e pranimin, përzgjedhjes, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit janë të përcaktuara qartë, të aksesueshme publikisht dhe të zbatuara në praktikë. Vëmendje e veçantë i kushtohet respektimit të barazisë dhe të drejtave të studentëve, përfshirjes së shtresave të marginalizuara, dhe ndihmës financiare në formën e bursave apo kredive studentore. Gjithashtu, janë ndërmarrë masa për të informuar rregullisht publikun dhe kandidatët potencialë mbi kriteret dhe procedurat e pranimin, përmes publikimeve zyrtare dhe aktiviteteve promovuese. Ekzistojnë kuota të përcaktuara për kategori të veçanta të studentëve, përfshirë ata nga trojet shqiptare dhe shtetasit e huaj. Politikat për përzgjedhjen dhe përparimin e</i>

	<i>studentëve janë transparente dhe promovojnë përfshirjen gjithëpërfshirëse dhe mbështetjen akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	IAL dhe FSHN ofron informacion të qartë dhe të aksesueshëm për studentët mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik, kalimin nga një vit në tjetrin dhe detyrimet akademike, sipas Rregullores së programit të studimit (Evidenca 1.6), hartuar nga DKI. Ky informacion publikohet në faqen zyrtare të FSHN. Përmes Rregullores së programit Master në IPK, Rregullores së diplomimit (Evidenca 5.5; 1.10.3) dhe burimeve online, studentët njihen me: • Planin mësimor dhe kreditë përkatëse • Kriteret e vlerësimit dhe sistemin e notave • Afatet dhe rregullat për provimet • Kushtet për diplomim dhe kalim viti Në fillim të çdo viti akademik organizohen takime me Kujdestarin Akademik (Evidenca 1.29), ku studentët informohen mbi strukturën e programit, të drejtat, detyrimet dhe rregullat e ndjekjes dhe vlerësimit. Rregulloret akademike përditësohen herë pas here nga Rektorati/Senati (Evidenca 5.15; 5.16) dhe publikohen në faqet zyrtare, duke u komunikuar studentëve përmes strukturave përkatëse.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Sipas raportit të GVB, FSHN u jep mundësi studentëve të transferohen në programet e saj të studimit, nëse ata kanë përfunduar të paktën një vit akademik në një program të të njëjtit cikël, në institucione të tjera të arsimit të lartë. Kjo mundësi vlen edhe për studentët që dëshirojnë të transferohen nga programe të mëparshme të ciklit të parë, si brenda ashtu edhe jashtë institucionit. Njohja e kualifikimeve ose studimeve të mëparshme, qoftë e plotë apo e pjesshme, bëhet nga komisionet e ngritura nga departamentet përkatëse për ekuivalentimin e lëndëve (Evidenca

	1.31). Këto vendime merren në përputhje me procedurat e parashikuara në Statutin e UT-së (Evidenca 1.1), Rregulloren e UT-së (Evidenca 1.3), si dhe në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri të Proceseve Kimike (Evidenca 1.6).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri të Proceseve Kimike pranë FSHN, studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme për kriteret dhe mënyrat e vlerësimit përmes syllabuseve të lëndëve. Në ditën e parë të çdo moduli, syllabus diskutohet me studentët për të siguruar kuptueshmëri të plotë (Evidenca 1.10.1). Sipas Rregullores së programit të studimit (Evidenca 1.6), vlerësimi i studentëve bazohet në një sistem pikësh që përfshin pjesëmarrjen në leksione, provimet e ndërmjetme, detyrat e kursit, aktivitetet laboratorike dhe provimin përfundimtar (Evidenca 2.17). Pas korrigjimit të provimit, studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatet e detajuara, në rast mospajtimi, ata mund të paraqesin ankesë brenda 24 orëve nga momenti i njoftimit të notës (Evidenca 1.6).
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Departamenti Kimise Industriale bazuar në dokumentacionin e paraqitur informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e diplomimit në programin Master i Shkencave "Inxhinieria e Proceseve Kimike", në përputhje me Statutin e UT-së (Evidenca 1.1), Rregulloren e programit të studimit dhe diplomimit të Masterit IPK (Evidenca 1.6, Evidenca 1.10.3) dhe Rregulloren e Diplomimit të universitetit të Tiranës (Evidenca 5.5). Në përfundim, studenti pajiset me diplomën përkatëse (Evidenca 1.10.4), si dëshmi e përmbylljes së suksesshme të studimeve.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Para fillimit të vitit akademik, FSHN publikon afatet e aplikimit, kriteret dhe dokumentacionin për programet master në faqen e saj zyrtare dhe përmes broshurave informuese (Evidenca 5.8). Kujdestarët akademikë (Evidenca 1.29) organizojnë takime me studentët e vitit të tretë për t'i informuar mbi programin master dhe mundësitë e punësimit. Në ditën e parë të vitit, departamenti zhvillon orë orientuese me studentët. Gjithashtu, Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës ofron këshillim për karrierën dhe ndihmon në lidhjen e studentëve me tregun e punës (Evidenca 5.17; 5.18).
Konkluzione	<i>Institucioni i Arsimit të Lartë ka vendosur në dispozicion të studentëve informacion të plotë, të saktë dhe të aksesueshëm mbi të gjitha aspektet që lidhen me përparimin akademik, njohjen dhe vlerësimin e dijeve, si dhe diplomimin në programin Master i</i>

	<i>Shkencave në "Inxhinieri të Proceseve Kimike". Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik janë të detajuara në rregulloret institucionale dhe komunikohen rregullisht përmes faqeve zyrtare dhe takimeve me kujdestarët akademikë. Ekziston transparencë dhe funksionalitet në procesin e njohjes së kualifikimeve të mëparshme dhe ekuivalentimit të lëndëve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullat institucionale. Vlerësimi i studentëve është i strukturuar dhe i njohur për ta që në fillim të çdo lënde, përmes syllabuseve të diskutuara, ndërsa procedurat e diplomimit dhe përgatitjes së temës janë të qarta dhe të mirëpërcaktuara. Institucioni ofron gjithashtu udhëzues informues dhe organizon takime për orientimin e studentëve të rinj dhe të ardhshëm, duke përfshirë elemente të këshillimit akademik dhe të karrierës. Të gjitha këto dëshmojnë një sistem të mirëinformuar dhe të ndërtuar për t'i shërbyer nevojave akademike dhe profesionale të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjatë gjithë ciklit të studimeve, studentët e programit Master i Shkencave "Inxhinieria e Proceseve Kimike" marrin informacion të vazhdueshëm mbi organizimin, strukturën dhe kohëzgjatjen e programit (Evidenca 1.5; 1.9). Procesi i tyre akademik shoqërohet nga ndihma e sekretarisë mësimore pranë DKI/FSHN, e cila i asiston që nga regjistrimi fillestar deri në përfundimin me diplomim (Evidenca 4.18). Koordinator i programit u ofron këshillim fillestar dhe i nxit të kërkojnë ndihmë individuale kur kanë nevojë (Evidenca 1.5). Kujdestari akademik krijon kontakt që në ditën e parë dhe i udhëzon mbi rregulloret, syllabuset, kalendarin akademik, format e vlerësimit, bursat, mundësitë e punësimit etj. (Evidenca 1.29). Ai raporton rregullisht tek Përgjegjësi i Departamentit për ecurinë dhe problematikat e studentëve. Pedagogët e çdo lënde prezantojnë syllabus-in përkatës në fillim të çdo semestri (Evidenca 5.43). Gjatë pandemisë,

	komunikimi dhe mësimi u zhvilluan përmes Google Classroom dhe Microsoft Teams (Evidenca 3.1).
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Për studentët e programit Master Shkencor “Inxhinieria e Proceseve Kimike”, Departamenti i Kimisë Industriale në FSHN vë në dispozicion një sërë materialesh informuese, si guida e fakultetit (Evidenca 5.6), rregullorja e departamentit (Evidenca 1.5), rregullorja e programit (Evidenca 1.6) dhe planet mësimore (Evidenca 2.20). Këto dokumente ofrojnë të dhëna të hollësishme mbi modulet, lëndët, përmbajtjen dhe aktivitetet mësimore. Përveç kësaj, studentët kanë mundësi të konsultohen me informacion shtesë në faqen zyrtare të FSHN dhe në platformën elektronike (Evidenca 4.16).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në kuadër të akreditimit (Evidenca 2.12), Universiteti i Tiranës realizoi në vitin 2022 një studim mbi tregun e punës (Evidenca 1.8), i cili tregoi që kërkesa për Masterin “Inxhinieria e Proceseve Kimike” mbetet e qëndrueshme dhe një pjesë e studentëve punësohen gjatë studimeve. Departamenti i Kimisë Industriale ka integruar ish-studentë si staf akademik (Evidenca 1.15; 1.16) dhe zhvillon anketime për ndjekjen e punësimit (Evidenca 1.8.3; 1.8.4). Struktura të dedikuara si Dega e Karrierës mbështesin studentët me informacion mbi punësimin, leksione të hapura, internship-e dhe aktivitete si panairë karriere (Evidenca 5.17; 5.19; 5.22). UT ofron gjithashtu mundësi shkëmbimi ndërkombëtar përmes programit ERASMUS.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në fillim të çdo viti akademik, raportohet që studentët pajisen me informacion të plotë mbi institucionin, programet e studimit të ofruara, statusin e akreditimit, organizimin e procesit mësimor, vlefshmërinë e diplomës dhe infrastrukturën në dispozicion. Ky informacion aksesohet përmes faqes zyrtare të fakultetit dhe të departamentit, ku studentët mund të gjejnë oraret, njoftimet, provimet dhe dokumentet e nevojshme administrative. Përveç kësaj, secili student pajiset me një adresë personale e-maili, që përdoret për komunikim zyrtar lidhur me ndryshime në orare, regjistrime në provime dhe njoftime mbi vlerësimet. Sekretaria mësimore ofron gjithashtu asistencë të drejtpërdrejtë për çdo informacion apo shërbim që studentët mund të kenë nevojë gjatë rrugëtimit akademik (Faqa zyrtare e ËEB FSHN).
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe	Gjatë periudhës së pandemisë (Evidenca 3.2), mësimi në Universitetin e Tiranës u zhvillua në distancë për dy vite (Evidenca 3.1), fillimisht përmes platformave Google Classroom dhe Google Meet, dhe më pas duke përdorur Microsoft Teams. Për të ndihmuar

duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	studentët në përdorimin e këtyre platformave, u përgatitën manuale udhëzuese (Evidenca 5.23) për të mbështetur realizimin e programeve të studimit. Studentët (Evidenca 4.17) dhe stafi akademik (Evidenca 4.17.1) patën gjithashtu akses në sistemin elektronik <i>e-Student</i> . Përmes këtij sistemi, studentët mund të informohen mbi lëndët dhe modulet, grupet mësimore, listat e notave, hapjen e sezoneve të provimeve, regjistrimin në provime dhe historikun e tyre akademik. Nga ana tjetër, stafi akademik përdor sistemin për të përditësuar të dhënat personale, për të menaxhuar grupet mësimore, për të hedhur notat, si dhe për të administruar kërkesat për përmirësim ose ankimim të vlerësimeve nga studentët.			
Konkluzione	<i>Institucioni i Arsimit të Lartë ka vendosur një sistem të mirëstrukturuar dhe funksional për informimin dhe mbështetjen e studentëve në lidhje me objektivat formuese, strukturën dhe organizimin e programit të studimit Master në “Inxhinieri të Proceseve Kimike”. Studentët marrin informacion të qartë dhe të vazhdueshëm për strukturën e programit, modulet dhe lëndët përmes rregulloreve, syllabuseve dhe komunikimeve të drejtpërdrejta me stafin akademik. Dokumentacioni informues, si udhëzuesit, rregulloret dhe planet mësimore, janë të aksesueshme online dhe fizikisht, duke përmbyllur standardet e transparencës akademike. Institucioni demonstroi përkushtim në përgatitjen e studentëve për tregun e punës, duke ofruar këshillim karriere, aktivitete promovuese dhe mundësi për shkëmbim ndërkombëtar. Gjithashtu, sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit funksionon në mënyrë efektive dhe mbështet komunikimin dypalësh, qoftë në kushte normale, qoftë në situata të veçanta si pandemia. Platforma si e-Student, Microsoft Teams dhe ëeb-i zyrtar sigurojnë akses të lehtë dhe në kohë reale për të gjitha informacionet e nevojshme akademike e administrative.</i>			
Shkalla e përmbylljes së standardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Dokumentacioni mësimor dhe të dhënat e studentëve në Universitetin e Tiranës rregullohen nga Ligji për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015 dhe Rregullorja e UT-së, në nenet 55, 56, 71 dhe 76. Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, sekretaria mësimore mban dhe arkivon Regjistrin Themeltar të Studentëve (Evidenca 3.28), Regjistrin e të Dhënave Akademike (Evidenca 3.29) dhe Regjistrin e Lëshimit të Diplomave (Evidenca 3.30), të cilat ruhen në Arkivat e Shtetit. Gjithashtu, sekretaria administron dosjet e regjistrimit të studentëve, procesverbalet e rezultateve, dosjet e transferimeve dhe statistikat mbi ecurinë e studentëve, që nga pranimi deri në diplomim. Të gjitha dokumentet origjinale (Evidenca 4.22) dhe shërbejnë për lëshimin e vërtetimeve për studentët dhe institucionet përkatëse. UT përpunon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve (Evidenca 5.45), të regjistruarve (Evidenca 5.44) dhe për të dhënat mbi tërheqjet apo transferimet, të cilat përdoren në raporte dhe analiza në nivel fakulteti dhe universiteti (Evidenca 1.35).
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Informacioni për këtë kriter është dhënë te kriteri nr 1. Standarti V.4
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria mësimore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës administron dhe ruan të dhënat mbi ecurinë akademike të studentëve (Evidenca 4.18), të cilat janë të përputhshme me dokumentacionin përkatës si procesverbalet e provimeve (Evidenca 4.19). Siguria e tyre garantohehet përmes platformave mbrojtëse dhe verifikohen vetëm nga persona të autorizuar. Të dhënat e studentëve menaxhohen në databazën e sekretarisë, ndërsa pedagogët mbajnë regjistra të veçantë për zhvillimin e orëve të mësimi dhe frekuentimin e studentëve (Evidenca 2.38). Vlerësimet regjistrohen në sistemin <i>e-Student</i> (Evidenca 4.17) dhe dorëzohen të firmosura në sekretari pas çdo sezoni provimesh. Informacioni akademik pasqyrohet në Regjistrin Themeltar, në Regjistrin e Rezultateve Akademike dhe në Regjistrin e Diplomave, duke u ruajtur edhe në databaza të posaçme, gjithnjë duke respektuar konfidencialitetin (Evidenca 4.16).

Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	GVB raporton që institucioni kujdeset në mënyrë të vazhdueshme për funksionimin e strukturave përgjegjëse si sekretaritë mësimore dhe sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit, duke organizuar mbledhje të rregullta në nivel grupi mësimor, departamenti dhe fakulteti për të trajtuar çështjet që dalin dhe për të gjetur zgjidhje. Drejtuesit në nivel fakulteti (dekanati, zv. Dekani, kryetarja e degës mësimore) dhe në nivel departamenti (përgjegjësi i departamentit dhe grupit mësimor) kryejnë kontrolle periodike për të vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen dhe saktësinë e të dhënave që lidhen me studentët dhe veprimtarinë përkatëse akademike.			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Universiteti i Tiranës, në zbatim të Udhëzimit të MAS (Evidenca 5.25), përgatit çdo vit Raportin Vjetor (Evidenca 5.26), ku vlerësohet veprimtaria mësimore dhe shkencore, si dhe ecuria e programeve të studimit. Raporti përmban të dhëna mbi cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje (Evidenca 1.35), si dhe shkallën e punësimit të tyre, duke propozuar masa për përmirësim. Gjurmimi i punësimit është kryer përmes studimeve të tregut në nivel universiteti dhe departamenti (Evidenca 1.8), të shoqëruara me rekomandime për rritjen e cilësisë. Tregues të tjerë përfshijnë mesataren e studentëve në hyrje, kalueshmërinë dhe cilësinë e vlerësimeve. Departamenti, në analizat vjetore, pasqyron numrin e të regjistruarve dhe të diplomuarve (Evidenca 1.40).			
Konkluzione	<i>Institucioni i Arsimit të Lartë, në përputhje me kërkesat e Standardit V.4, ka ngritur dhe administron një sistem funksional për menaxhimin e të dhënave mbi studentët që nga momenti i pranimit deri në diplomim dhe përtej tij, në ndjekje të punësimit. Evidencat e paraqitura tregojnë për një sistem të konsoliduar të ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave statistikore (Regjistri Themeltar, Regjistri i Diplomave, sistemi e-Student, etj.), të menaxhuara në mënyrë të sigurt dhe të verifikueshme nga persona të autorizuar. Sekretaritë mësimore dhe strukturat drejtuese kryejnë kontrolle të rregullta për verifikimin e saktësisë së informacionit dhe ndërhyjnë me masa përmirësuese kur është e nevojshme. Gjithashtu, përgatiten raporte periodike analitike mbi ecurinë e studentëve dhe shkallën e punësimit të tyre, duke u bazuar në të dhëna dhe studime tregu.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në Universitetin e Tiranës, studentët gëzojnë të drejtën për të marrë pjesë aktive në proceset e vendimmarrjes, duke respektuar ligjin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore në fuqi. Përfshirja dhe angazhimi i tyre janë të përcaktuara qartë në Statutin e Universitetit (Evidenca 1.1; 3.13), ku parashikohet pjesëmarrja e studentëve në organet kryesore drejtuese dhe audituse. Studentët kanë përfaqësues të tyre në Senatin Akademik me katër anëtarë, në Këshillat Studentorë, në Këshillin e Etikës me dy anëtarë, në Komisionin e Marrëdhënieve me Studentët me tre anëtarë, në Komisionin e Kurrikulës me dy anëtarë dhe në Komisionin e Sigurimit të Cilësisë me tre anëtarë. Po ashtu, ata janë pjesë e grupeve të vlerësimit të procesit akademik, duke kontribuar në monitorimin e cilësisë së arsimit (Evidenca 5.27; 5.28; 5.29; 1.36; 1.37). Këshillat studentore në nivel institucioni dhe fakulteti janë krijuar përmes një procesi zgjedhor të administruar nga Komisioni Institucional Zgjedhor i Studentëve (KIZS) (Evidenca 5.30; 5.31), ku studentët vetëkandidohen dhe zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Zgjedhjet e fundit u zhvilluan më 16 dhjetor 2021 (Evidenca 5.32), me pjesëmarrjen e të gjithë studentëve të cikleve të parë dhe të dytë të studimeve. Përveç pjesëmarrjes në organet drejtuese, studentët japin kontributin e tyre edhe në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të proceseve akademike, përmes pyetësorëve të ndryshëm që shpërndahen dhe plotësohen online (Evidenca 5.33; 5.34). Përgjigjet e mbledhura përpunohen në formën e raporteve dhe statistikave (Evidenca 2.42; 2.43; 6.6), duke i dhënë studentëve një zë të qartë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit në Universitetin e Tiranës.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Informacioni për këtë kriter është i ngjashëm me kriterin nr 1 të Standartit V.5 dhe shpjegimi mund të lexohet me sipër
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe	Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Departamentin e Kimisë Industriale janë ngritur mekanizma për komunikimin me studentët,

përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	përmes Kujdestarit ose Koordinatorit Akademik që organizon takime të rregullta ose sipas nevojës. Studentët përfshihen në komisionet institucionale (Evidenca 3.13), ku japin mendime për hartimin dhe përmirësimin e kurrikulave dhe programeve të studimit. Nëpërmjet pyetësorëve të ndryshëm, studentët shprehin vlerësimet e tyre për programet dhe lëndët, përfshirë mësimdhënien online. Përgjigjet e tyre përpunohen në forma raportesh dhe statistikash (Evidenca 2.42; 2.43; 6.6), duke identifikuar problematika dhe ndihmuar në hartimin e planeve të masave për përmirësim (Evidenca 6.10).
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Gjatë semestrit, studentët informohen rregullisht nga pedagogët për rezultatet e provimeve të ndërmjetme, pjesëmarrjen në seminare, detyrat e kursit dhe vlerësimin përfundimtar, si edhe përmes sistemit <i>e-Student</i> dhe sekretarive mësimore. Në rast ankesash, procedurat janë të qarta dhe të përcaktuara në rregulloret e Universitetit të Tiranës (Evidenca 1.3), të departamentit (Evidenca 1.5) dhe të programit të studimit (Evidenca 1.6). Studenti mund të ankimojë shkeljet e provimit brenda 24 orëve dhe rezultatit përfundimtar brenda 48 orëve, duke paraqitur kërkesë me shkrim te Përgjegjësi i Departamentit. Nëse ankesa nuk zgjidhet në nivel departamenti, çështja i kalon dekanit, i cili brenda 48 orësh ngre një komision <i>ad hoc</i> prej tre anëtarësh për të rivlerësuar provimin. Në rast ndryshimi të vlerësimit, hartohet një procesverbal i ri që i bashkëngjitet atij ekzistues.
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë ka vendosur mekanizma të qartë dhe funksionale për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në proceset vendimmarrëse, këshilluese dhe në vlerësimin e cilësisë së arsimit. Studentët janë të përfaqësuar në të gjitha strukturat kryesore institucionale, si Senati Akademik, Këshillat Studentore, Komisionet e Etikës, të Marrëdhënieve me Studentët, të Sigurimit të Cilësisë dhe të Kurrikulës. Zgjedhjet për përfaqësuesit studentorë janë zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe transparente. Institucioni garanton që përfshirja e studentëve është reale dhe produktive, përmes pjesëmarrjes në komisione, pyetësorëve periodikë dhe raporteve analitike që reflektojnë mendimet e tyre. Këto të dhëna përdoren për rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit dhe metodave të mësimdhënies. Gjithashtu, ekzistojnë procedura të qarta për ankimimin e vlerësimeve, duke i mundësuar studentëve një proces transparent dhe të drejtë për shqyrtimin e rezultateve.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Departamenti, në bashkëpunim me njësi dhe struktura të tjera, kujdeset që studentët të informohen qartë për programin e studimit, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve, akreditimin dhe mundësitë për punësim pas diplomimit. Gjithashtu, përmes dokumentacionit përkatës (Evidenca 4.18), studentët orientohen mbi kalendarin akademik, sezonet e provimeve, si dhe datat e fillimit dhe përfundimit të vitit akademik. Në këtë proces, rol kyç luan Sekretaria Mësimore, që mbulon të gjithë ciklin nga regjistrimi deri në diplomim (Evidenca 4.18), si dhe Kujdestari Akademik, i cili këshillon dhe mbështet studentët gjatë gjithë viteve të studimit (Evidenca 1.29). Shërbimi i kujdestarisë funksionon me përkushtim, duke ndihmuar në mënyrë intensive jo vetëm studentët e vitit të parë, por edhe ata të viteve pasuese. Një tjetër kanal shumë efikas informimi është faqja zyrtare e fakultetit. Në seksionin "Njoftime", studentët marrin në kohë reale informacione mbi oraret, provimet, aplikimet për programe ndërkombëtare si ERASMUS dhe njoftime të tjera të rëndësishme. Departamenti, përveç informimit, u qëndron pranë studentëve që hasin vështirësi akademike, duke organizuar orë konsultimi dhe seanca shtesë laboratorike me pedagogët për të garantuar suksesin e tyre në përmbushjen e kërkesave të programit.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Departamenti, në bashkëpunim me njësi dhe struktura të tjera, kujdeset që studentët të informohen qartë për programin e studimit, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve, akreditimin dhe mundësitë për punësim pas diplomimit. Shërbimi i kujdestarisë funksionon me përkushtim, duke ndihmuar në mënyrë intensive jo vetëm studentët e vitit të parë, por edhe ata të viteve pasuese. Një tjetër kanal shumë efikas informimi është faqja zyrtare e fakultetit. Në seksionin "Njoftime", studentët marrin në kohë reale informacione mbi oraret, provimet, aplikimet për programe ndërkombëtare si ERASMUS dhe njoftime të tjera të

	rëndësishme (Evidencat për këto kriter gjenden te Kriteri 1 i Standartit V.6).
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, studentët gjejnë mbështetje të vazhdueshme në ndërtimin e rrugëtimit të tyre akademik dhe profesional. Përmes Degës së Sigurimit të Cilësisë dhe Karrierës, e cila funksionon si zyra zyrtare e këshillimit të karrierës, studentët mirëprehen në mënyrë të rregullt dhe marrin informacion të posaçëm për çdo hap të rëndësishëm që duhet të ndërmarrin. Ata orientohen në kompletimin e studimeve, në zgjedhjen e praktikave profesionale, në kuptimin e vlerës së diplomës dhe në mënyrën më të mirë për t'u futur në tregun e punës (Evidenca 5.22). Kjo mbështetje realizohet përmes aktiviteteve të organizuara dhe leksioneve të hapura (Evidenca 1.24.2), ku studentët ndihmohen të identifikojnë interesat dhe preferencat e tyre individuale, duke u orientuar drejt mundësive të praktikave pranë institucioneve dhe kompanive (Evidenca 1.22). Një pjesë e rëndësishme e këtyre takimeve është edhe njohja me pritshmëritë, kërkesat dhe standardet e tregut të punës (Evidenca 1.24.1), shpesh përmes ndarjes së historive të ish-studentëve të suksesshëm të DKI-së. Për të qenë sa më të përgatitur, studentët këshillohen edhe për hartimin e CV-ve, letrave motivuese dhe për zhvillimin e intervistave të punës (Evidenca 5.18). Ata informohen në mënyrë të vazhdueshme mbi mundësitë për të ndjekur internship-e të ndryshme (Evidenca 5.35; 5.19; 5.20), si dhe ndërtojnë së bashku me këshilluesit një plan të qartë për zhvillimin e karrierës së tyre (Evidenca 5.17). Në këtë rrugëtim, Departamenti ndërmjetëson aktivisht për punësimin e studentëve dhe i orienton ata drejt programeve ndërkombëtare si Erasmus+ apo shkollave verore (Evidenca 5.36; 1.23.2). Në Universitetin e Tiranës funksionon edhe Qendra e Zhvillimit Profesional, e cila organizon trajnime si për stafin akademik (Evidenca 3.9), ashtu edhe për studentët (Evidenca 5.37), duke ndihmuar në përvetësimin e aftësive të domosdoshme për tregun modern të punës. Për të krijuar ura më të forta midis universiteteve dhe tregut të punës, studentët kanë në dispozicion Platformën Gradua (Evidenca 5.38), që mundëson kontakte direkte me kompanitë dhe institucionet përmes regjistrimeve të tyre individuale. Ndërkohë, Qendra e Karrierës Alumni kujdeset të mbajë aktive lidhjet midis studentëve aktualë, profesorëve dhe të diplomuarve të Universitetit të Tiranës (Evidenca 5.39; 5.40; 5.41). Përmes sondazheve dhe pyetësorëve të rregullt (Evidenca 5.42), Alumni ndjek rrugëtimin profesional të të diplomuarve, duke

	ruajtur një marrëdhënie të vazhdueshme me ta dhe duke ndihmuar në përmirësimin e mëtejshëm të programeve dhe shërbimeve që universiteti ofron.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, studentët marrin mbështetje të vazhdueshme për ndërtimin e rrugëtimit akademik dhe profesional. Përmes Degës së Sigurimit të Cilësisë dhe Karrierës, e cila shërben si zyrë këshillimi, ata marrin udhëzime për përfundimin e studimeve, zgjedhjen e praktikave dhe orientimin drejt tregut të punës (Evidenca 5.22). Kjo mbështetje ofrohet nëpërmjet aktiviteteve, leksioneve të hapura dhe takimeve informuese, ku studentët mësojnë të identifikojnë interesat e tyre dhe të lidhen me institucione e kompani për praktika (Evidenca 1.24.2; 1.22; 1.24.1). Një fokus i veçantë është përgatitja për punësim, përmes këshillimit mbi hartimin e CV-ve, letrave motivuese dhe zhvillimin e intervistave (Evidenca 5.18). Studentët njoftohen rregullisht për mundësi internship-esh (Evidenca 5.35; 5.19; 5.20) dhe mbështeten për të ndërtuar një plan karriere (Evidenca 5.17), duke përfutur edhe nga programe ndërkombëtare si Erasmus+ dhe shkollat verore (Evidenca 5.36; 1.23.2). Në këtë kuadër, Qendra e Zhvillimit Profesional ofron trajnime për studentë e staf akademik (Evidenca 3.9; 5.37), ndërsa platforma Gradua lidh drejtpërdrejt studentët me tregun e punës (Evidenca 5.38). Po ashtu, Alumni i UT mban aktive kontaktet mes studentëve, pedagogëve dhe të diplomuarve, duke ndjekur rrugëtimin e tyre profesional përmes sondazheve e pyetësorëve dhe duke ndihmuar në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve (Evidenca 5.39; 5.40; 5.41; 5.42).
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë ka ngritur struktura të dedikuara dhe ka vendosur procedura funksionale për të garantuar informimin, orientimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve. Sekretaritetë mësimorë, kujdestarët akademikë dhe njësitë e sigurimit të cilësisë dhe karrierës ofrojnë shërbime të vazhdueshme për studentët në çdo fazë të formimit të tyre akademik dhe profesional. Informacionet bazë si struktura e programit, kalendari akademik dhe njoftimet institucionale janë të qarta, të aksesueshme dhe të përditësuara. Përmes Degës së Karrierës, studentëve u ofrohet një mbështetje e vazhdueshme për orientimin në praktikën profesionale, përgatitjen për tregun e punës dhe për ndjekjen e rrugëtimit të tyre pas diplomimit. Aktivitetet e shumta si leksione të hapura, trajnimet, ndërmjetësimi për internship-e, këshillimi për hartimin e dokumentacionit të karrierës, dhe</i>

	<i>funksionimi i platformave si Gradua apo rrjetit Alumni, dëshmojnë për një angazhim të strukturuar dhe efektiv të institucionit. Të dhënat për punësimin e të diplomuarve përpunohen dhe përdoren për të përmirësuar më tej ofertën akademike dhe shërbimet ndaj studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në Universitetin e Tiranës, sispas dokumentacionit të paraqitur, liria akademike është një parim themelor që garanton zhvillimin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe inovacionit (Evidenca 1.1; 6.1). Programi Master i Shkencave në “Inxhinieria e Proceseve Kimike” zhvillohet duke respektuar të gjitha rregulloret ligjore dhe aktet e brendshme të universitetit, të cilat janë ndërtuar në përputhje me standardet e akreditimit (Evidenca 1.6). Në mbështetje të kërkimit dhe inovacionit, UT ka hartuar Udhëzuesin për Programin “UT–Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion” (Evidenca 3.14; 6.1; 2.40), i cili fuqizon njësitë akademike të universitetit për të avancuar fushat e kërkimit dhe për të lidhur drejtpërdrejt rezultatet e tyre me procesin mësimor. Për sa i përket përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie, UT ka miratuar Strategjinë Institucionale për Mësimdhënien 2022–2027 dhe Planin Strategjik për Zhvillimin Profesional të Personelit 2023–2028 (Evidenca 1.2.4; 6.2). Këto dokumente synojnë rishikimin e vazhdueshëm të programeve, përcaktimin e rezultateve të të nxënit dhe aplikimin e metodave inovative që i japin përparësi praktikës në mësimdhënie (Evidenca 1.2.4). Një hap tjetër i rëndësishëm ishte miratimi i udhëzuesit për

	mësimin në distancë (Evidenca 3.1), i cili u bë një mjet esencial gjatë periudhës së pandemisë (Evidenca 1.3), duke mundësuar vijimin e mësimi online nëpërmjet platformës Microsoft Teams (Evidenca 3.3) dhe duke ndjekur një rregullore të posaçme për zhvillimin e provimeve online (Evidenca 3.2). Në mënyrë që studentët të përfitojnë edhe nga mësimi praktik, pranë Departamentit të Kimisë Industriale janë krijuar laboratorë të specializuar si Laboratori i Inxhinierisë Kimike 1 (Evidenca 1.13.1) dhe Laboratori i Inxhinierisë Kimike 2 (Evidenca 1.13.2), ku studentët angazhohen me metoda bashkëkohore të modelimit dhe stimulimit në fushën e inxhinierisë kimike.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Universiteti i Tiranës synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe përvetësimin efektiv të njohurive, përmes zhvillimit të burimeve njerëzore. Të gjitha programet e studimit, përfshirë edhe Masterin në “Inxhinieria e Proceseve Kimike”, kanë si qëllim të formojnë studentë drejt te menduarit analitik dhe aftësive ndërdisiplinore, të aftë për tregun e punës (Evidenca 1.2.3; 1.7). Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një komponent i sanksionuar në Statutin e UT dhe menaxhohet nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), i cili bashkëpunon me njësitë përkatëse në të gjitha nivelet e strukturës universitare (Evidenca 1.1; 3.13). Këto mekanizma funksionojnë sipas udhëzimeve të ASCAL dhe përfshijnë edhe stafin akademik të DKI në vlerësimin e praktikave mësimore dhe inovative (Evidenca 5.46). Anëtarët e fakultetit janë pjesë e komisioneve institucionale si ai i kurrikulës dhe promovimit të personelit akademik (Evidenca 3.13; 1.36; 5.29). Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Dega përkatëse në FSHN, në bashkëpunim me Zv. Dekanin për kurrikulen, organizojnë pyetësorët e studenteve për vlerësimin e mësimdhënies në fund të çdo semestri (Evidenca 6.3; 6.4; 6.5; 6.6 2.42; 2.43). Rezultatet e pyetësorëve përpunohen në mënyrë statistikore dhe përdoren për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor (Evidenca 2.44; 6.21). Studentët njoftohen për plotësimin e pyetësorëve përmes faqes zyrtare të fakultetit (Evidenca 6.7). Raportet e analizave i përcillen fillimisht drejtuesit të departamentit nga dekanati, i cili më pas i ndan me stafin akademik dhe organizon takime për të përcaktuar masat për përmirësim (Evidenca 6.8; 6.9; 6.10; 1.40). Gjithashtu, Senati Akademik ka miratuar Manualin e Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik (Evidenca 6.13), që përcakton qartë mënyrën, kriteret dhe periudhat e

	vlërësimit. UT ofron gjithashtu trajnime për lektorët e rinj përmes programit “Bazat e Mësimdhënies në Arsimin e Lartë” (Evidenca 6.13).
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të përfshirë studentët në këtë proces, Universiteti i Tiranës organizon çdo vit pyetësorë vlerësues për studentët. Këto pyetësorë zhvillohen në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, dhe synojnë të mbledhin opinione për cilësinë e mësimdhënies në çdo lëndë (Evidenca 1.6; 1.1). Procesi mbështetet nga Statuti i Universitetit dhe rregulloret e programeve të studimit, si dhe zbatohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Dega përkatëse në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (Evidenca 1.12). Rezultatet përpunohen në raporte që shërbejnë si bazë për vlerësime të jashtme dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë akademike (Evidenca 2.42; 2.43; 6.6; 2.44; 6.21). Studentët përfshihen gjithashtu në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (Evidenca 5.46; 3.13), kanë të drejtën të shprehin opinionet për punën e stafit akademik (Evidenca 1.1; 2.42; 2.43; 6.6; 2.44; 6.21), si dhe të ankimojnë rezultatet e vlerësimeve nëse është e nevojshme (Evidenca 1.6). Për më tepër, çdo studenti i caktohet një kujdestar akademik, i cili e ndihmon në adresimin e problemeve pranë strukturave përkatëse të universitetit (Evidenca 1.1; 1.29). Në këtë mënyrë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës siguron pjesëmarrje aktive të studentëve në garantimin dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, së bashku me Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (Evidenca 6.4), kanë përgjegjësinë për të ndjekur dhe garantuar standardet në procesin e mësimdhënies. Në kuadër të kësaj detyre, ato publikojnë në mënyrë të rregullt raportet e analizës së pyetësorëve që përdoren për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies në çdo program studimi. Ky proces kryhet duke respektuar plotësisht legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, konkretisht Ligjin Nr. 48/2012.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në Departamentin e Kimisë Industriale (DKI), çdo vit realizohet analiza periodike e veprimtarisë, ku një ndër pikat kryesore është edhe vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies (Evidenca 6.10; 1.40). Këto analiza shërbejnë si bazë për të identifikuar dhe promovuar praktikën e mira brenda departamentit. Shembuj të tillë përfshijnë pjesëmarrjen e stafit akademik në programin Erasmus+ për mobilitet, mbështetjen financiare për konferenca dhe botime shkencore, si dhe përfshirjen në projekte të ndryshme

	bashkëpunimi (Evidenca 6.10; 1.40). Nëpërmjet këtyre mundësive, stafit akademik ka patur hapësirë për zhvillim profesional dhe janë vlerësuar për angazhimin e tyre aktiv (Evidenca 1.35). Në periudhën 2021–2024, Departamenti i DKI ka realizuar rreth disa mobilitete për qëllime kërkimi shkencor dhe mësimdhënieje përmes programeve Erasmus+ dhe të tjera (Evidenca 2.37). Këto përvoja kanë shërbyer për shkëmbimin e praktikave akademike dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës mbështesin vazhdimisht stafin akademik në zhvillimin profesional përmes rimbursimeve të kostove për pjesëmarrje në konferenca dhe publikime në revista shkencore, nga të cilat ka përfituar edhe stafi i Departamentit të DKI (Evidenca 1.35). Po ashtu, janë mbështetur një numër i konsiderueshëm punimesh shkencore gjatë periudhës 2021–2024 (Evidenca 2.27).
Konkluzione	<i>Universiteti i Tiranës tregon një angazhim të strukturuar në drejtim të garantimit dhe promovimit të cilësisë së mësimdhënies, duke u mbështetur në politika të qarta institucionale dhe dokumentacion përkatës. Strategjitë dhe udhëzuesit e hartuar, si Strategjia Institucionale për Mësimdhënien 2022–2027 dhe Plani Strategjik për Zhvillimin Profesional të Personelit 2023–2028, dëshmojnë për një përpjekje të mirëkoordinuar drejt zhvillimit të vazhdueshëm të praktikave akademike dhe përmirësimit të rezultateve të të nxënit. Mekanizmat e brendshëm të monitorimit, të menaxhuar nga struktura të dedikuara si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, funksionojnë në përputhje me udhëzimet e institucioneve përkatëse kombëtare, dhe përfshijnë vlerësime të rregullta të performancës akademike. Studentët janë aktivisht të përfshirë në këtë proces përmes pyetësorëve periodikë, pjesëmarrjes në struktura vendimmarrëse dhe të drejtës për ankimim. Gjithashtu, publikimi i rezultateve të vlerësimeve dhe promovimi i praktikave të mira brenda departamenteve, si dhe mbështetja për mobilitet ndërkombëtar, pjesëmarrje në konferenca dhe publikime shkencore, dëshmojnë për një mjedis universitar që nxit përmirësimin profesional dhe cilësinë në mësimdhënie. Bazuar në evidencat e paraqitura dhe përmbushjen e plotë të të gjitha kriterëve të standardit, vlerësohet se Universiteti i Tiranës ka krijuar dhe funksionalizuar në mënyrë efektive një sistem të qëndrueshëm për sigurimin dhe zhvillimin cilësor të procesit mësimor.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Universiteti i Tiranës është i përkushtuar për sigurimin e cilësisë në të gjitha fushat e veprimtarisë së tij (Evidenca 1.2.2). Statuti i UT përcakton strukturat dhe parimet që udhëheqin këtë proces (Evidenca 1.1), ndërsa Senati Akademik ka miratuar Manualin e Sigurimit të Cilësisë dhe dokumentet mbështetëse si Rregullorja dhe Paketa e Instrumenteve të Cilësisë (Evidenca 6.14; 6.15; 6.5; 6.3). Në nivel institucional janë ngritur struktura të dedikuara si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni i Kurrikulës (Evidenca 3.13), me funksionet dhe përbërjen e përcaktuara në Statut (Evidenca 1.1). Neni 141 i Statutit parashikon gjithashtu ngritjen e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në çdo njësi kryesore. Këto njësi organizojnë pyetësorët studentorë për cilësinë e mësimdhënies në fund të çdo semestri dhe përgatisin raportet përkatëse që shërbejnë për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Me Vendimin Nr. 39 të Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018, janë miratuar strukturat për njësitë e UT (Evidenca 6.4). Në përputhje me këtë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Degën për Sigurimin e Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) (Evidenca 6.16). Këto struktura, së bashku me Zv. Dekanin për kurrikulat, organizojnë pyetësorët dhe hartojnë raportet për çdo program studimi (Evidenca 6.7; 1.1).
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) është struktura përgjegjëse e caktuar nga Senati Akademik për të garantuar cilësinë institucionale dhe atë të programeve të studimit në Universitetin e Tiranës. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, përkatësisht 8 nga personeli akademik dhe 3 përfaqësues studentë, ndërsa Fakulteti i Shkencave të Natyrës përfaqësohet nga një anëtar akademik (Evidenca 3.13). Për të mbështetur punën e KPSSC dhe të Njësive të Sigurimit të

	Brendshëm të Cilësisë në njësitë kryesore, UT ka krijuar Sektorin e Sigurimit të Cilësisë si një strukturë ndihmëse-akademike që zbaton politikat institucionale të cilësisë (Evidenca 5.46). Në nivel fakulteti, një ndër mekanizmat kryesorë për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Dega për Sigurimin e Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) në FSHN (Evidenca 6.4; 6.16). Kjo njësi vepron në përputhje me “Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës”, e mbështetur nga Manuali i Cilësisë dhe Paketa e Instrumenteve të miratuara nga Senati Akademik (Evidenca 6.14; 6.15; 6.5; 6.3).
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Bazuar në nenin 104 të Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015, Universiteti i Tiranës (UT) është i angazhuar në sigurimin e jashtëm të cilësisë përmes dy mekanizmave ligjorë: Akreditimi Institucional dhe Akreditimi i Programeve të Studimit (Evidenca 2.12). Në vitin 2018, UT i nënshtrohet një procesi të vlerësimit të jashtëm institucional, që rezultoi me një akreditim pozitiv për katër vite akademike. Në vitin 2023, pas procesit të riakreditimit, UT mori sërish një vlerësim përfundimtar pozitiv, kësaj here për një periudhë prej gjashtë vitesh, sipas vendimit të ASCAL të datës 27 janar 2023 (Evidenca 2.12). Departamenti i Kimisë Industriale ka përfunduar me sukses akreditimin për programet Bachelor në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore” dhe “Kimi Industriale e Mjedisore”, secili me një vlerësim pozitiv për pesë vjet. Vendimet përkatëse të Bordit të Akreditimit dhe raportet përkatëse të vlerësimit janë të publikuara në faqet zyrtare të UT dhe ASCAL. Me vendimin Nr. 26, datë 21.10.2020, Senati Akademik miratoi planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore, ku ndër të tjera përfshihej analiza e programeve dhe kurrikulave, me objektivin për përmirësim të paktën në masën 20%, si dhe përdorimi i dokumentacionit të unifikuar për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë (Evidenca 6.17). Në funksion të këtyre synimeve, UT ka hartuar edhe Planin e Veprimit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për periudhën 2021–2024 (Evidenca 6.18). Në nivel fakulteti, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Dega për Sigurimin e Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) në FSHN bashkëpunojnë ngushtë me njësitë bazë për të garantuar vlerësimin e brendshëm. Studentët ftohen periodikisht të plotësojnë pyetësorë për vlerësimin e lëndëve të programit, bazuar në modelet e hartuara nga Paketa e Instrumentave të Cilësisë (Evidenca 6.3; 1.1; 6.7). Departamenti i Kimisë Industriale përgatit

	analizat vjetore të aktiviteteve, ku përfshihen rezultatet e këtyre pyetësorëve dhe konkluzionet përkatëse (Evidenca 1.40).
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Universiteti i Tiranës ka ndërtuar një sistem të brendshëm sigurimi cilësie, i cili funksionon mbi bazën e procedurave të rregullta me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Në Statutin e UT-së përcaktohen qartë mekanizmat dhe praktikrat që lidhen me garantimin dhe zhvillimin e cilësisë (Evidenca 1.1; 3.13; 6.19), ndërsa Rregullorja e Sigurimit të Cilësisë përshkruan mjetet, burimet dhe afatet kohore që zbatohen në këtë proces (Evidenca 6.5). Përveç pyetësorëve të rregullt që përdoren për vlerësimin e mësimdhënies, Departamenti i Kimisë Industriale harton çdo vit analizën vjetore të veprimtarisë së tij, si një mjet për të identifikuar pikat e forta dhe ato që kërkojnë përmirësim (Evidenca 1.40). Bazuar në këto vlerësime, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) ndërmeret nisma konkrete për të nxitur cilësinë akademike. Një prej këtyre është mbështetja financiare për punimet shkencore të stafit akademik, e cila është ofruar për një numër të konsiderueshëm punimesh të Departamentit të Kimisë Industriale gjatë periudhës 2021–2024 (Evidenca 2.27).
Konkluzione	<i>Universiteti i Tiranës ka ndërtuar dhe zbatuar në mënyrë të plotë një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë, të mbështetur në politika të qarta, struktura të qëndrueshme dhe procedura transparente. Këto mekanizma janë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Strukturat si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në fakultete dhe Sektori për Sigurimin e Cilësisë në nivel institucional funksionojnë në mënyrë të koordinuar për të monitoruar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e programeve të studimit. Për më tepër, përfshirja aktive e studentëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm në vlerësimet periodike e bën këtë sistem gjithëpërfshirës dhe të besueshëm. Gjithashtu, universiteti përdor instrumente dhe tregues të matshëm për vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, të cilët ndihmojnë në identifikimin e arritjeve dhe nevojave për përmirësim. Vlerësimet e brendshme dhe të jashtme janë përdorur në mënyrë efektive për të ndërmarrë masa konkrete në drejtim të rritjes së cilësisë akademike. Mbështetja për punimet shkencore dhe promovimi i praktikave të mira dëshmojnë për një përkushtim të vazhdueshëm institucional ndaj ekselencës.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Për të garantuar cilësinë e programeve të studimit, Universiteti i Tiranës ka ngritur struktura të posaçme që merren me monitorimin, vlerësimin dhe rishikimin e tyre të vazhdueshëm. Në nivel institucional, këtë rol e mbajnë Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës, të cilët kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike (Evidenca 3.13). Në nivelin e njësive kryesore, funksionojnë Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) si dhe Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), të cilat mbulojnë procesin e sigurimit të cilësisë për programet e ciklit të dytë (Evidenca 6.4; 6.16). Përveç kësaj, drejtuesit e departamenteve bashkëpunojnë me zëvendësdekanët përgjegjës për kurrikulat e ciklit të parë e të dytë, si edhe me zëvendësdekanin që mbulon formimin kerkimin shkencor dhe ciklin e tretë. Kjo bashkëveprimtari siguron koordinim dhe planifikim më të mirë të punës akademike e kërkimore, e cila pasqyrohet në raportet vjetore të njësive kryesore (Evidenca 1.35), të bazuara në analizat e përgatitura nga njësitë bazë (Evidenca 1.40).
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe konkretisht në Departamentin e Kimisë Industriale, përdoren disa mekanizma për të garantuar shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të cilësisë së programeve të studimit. Një nga mjetet kryesore është raporti vjetor institucional i Universitetit të Tiranës, si dhe raportet e përvitshme të fakultetit dhe departamentit (Evidenca 6.20; 1.35), të cilat përmbledhin analizat mbi procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore, duke identifikuar rezultatet, sfidat dhe masat për përmirësim të mëtejshëm. Ndër të tjera, plani vjetor i veprimtarive akademike dhe shkencore, si edhe plani i veprimtarive për sigurimin e cilësisë së brendshme (Evidenca 6.18), shërbejnë si udhërrëfyes për menaxhimin dhe zhvillimin e programeve. Një tjetër element thelbësor është realizimi i pyetësorëve studentorë për

	vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në çdo semestër, për çdo lëndë. Nga këto vlerësime hartohen raporte të cilat ndihmojnë në hartimin e planeve të ndërhyrjes për rritjen e cilësisë (Evidenca 1.1; 2.42; 2.43; 2.44; 6.6; 6.7; 6.10; 6.21). Raportet vjetore të DSBCK mbi cilësinë përmbledhin gjetjet kryesore të këtij procesi dhe publikohen në mënyrë transparente në faqen zyrtare të FSHN-së (Evidenca 6.6).
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe njësitë e tij bazë zbatojnë një sërë metodash të drejtpërdrejta për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të siguruar mbarëvajtjen e programeve të studimit. Çdo vit akademik përgatiten raportet vjetore institucionale që analizojnë në mënyrë të detajuar procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore, duke përfshirë të gjithë komponentët përkatës (Evidenca 1.35). Departamenti i Kimisë Industriale përgatit analizat e veta vjetore për të vlerësuar ecurinë e programeve të studimit, të cilat më pas përfshihen në raportin e përgjithshëm të fakultetit (Evidenca 1.40). Kur është e nevojshme, realizohen ndryshime deri në masën 20% në planet mësimore për të përmirësuar përmbajtjen e tyre (Evidenca 2.31; 2.32). Dekanati, nga ana e tij, kryen kontrole periodike për të siguruar zhvillimin korrekt të procesit mësimor (Evidenca 3.15). Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) administron çdo vit pyetësorë për vlerësimin e mësimdhënies dhe përpunon analizat përkatëse, duke hartuar gjithashtu raportet vjetore për cilësinë, të cilat publikohen në faqet zyrtare (Evidenca 6.6). Përgjegjësit e departamenteve, në bashkëpunim me titullarët e grup-lëndëve, ndjekin nga afër përmbushjen e programeve mësimore dhe kërkimore, si dhe monitorojnë punën e stafit akademik e ndihmës akademik. Ata gjithashtu vëzhgojnë në mënyrë aktive përfshirjen e studentëve në orët laboratorike, në realizimin e detyrave të kursit dhe në testimet gjatë vitit akademik (Evidenca 2.13, 3.17).
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të	Fakulteti i Shkencave të Natyrës, përmes Departamentit të Kimisë Industriale, përdor mjete të tërthorta për të vlerësuar realizimin, cilësinë dhe ecurinë e programeve të studimit. Gjatë periudhës së diplomimit, zakonisht në muajin korrik, studentët që përfundojnë studimet plotësojnë pyetësorët “Vlerësimi i studentëve që diplomohen” dhe “Raporti i Studentit”, për të ofruar një feedback kritik mbi cilësinë e programeve të ndjekura (Evidenca 2.43). Për më tepër, Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) organizon rregullisht takime me ish-studentët (ALUMNI) të Departamentit të Kimisë Industriale (Evidenca 5.41),

tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	duke i përfshirë ata në diskutime dhe duke mbajtur kontakt të vazhdueshëm për të mbledhur mendime që ndihmojnë në përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit (Evidenca 5.41). Opinionet e të diplomuarve mbledhen gjithashtu përmes analizës së statistikave të punësimit. Universiteti i Tiranës ka realizuar Studimin e Tregut në nivel institucional (Evidenca 1.8), ndërsa stafi akademik i programit “Master i Shkencave në Inxhinierinë e Proceseve Kimike” ka zhvilluar një pyetësor të dedikuar për studentët që kanë përfunduar ose janë në përfundim të studimeve. Këto të dhëna janë analizuar nga një grup pune i ngritur me vendim të Senatit Akademik (Nr. 4, datë 22.02.2018), i cili përpiloi një raport të detajuar mbi pozicionimin e të diplomuarve në tregun e punës (Evidenca 1.8). Një raport i dytë mbi tregun e punës u përgatit në kuadër të ri-akreditimit institucional të vitit 2023. Po ashtu, DSBCK ka përpiluar raporte për ndjekjen e karrierës së studentëve të diplomuar në FSHN (Evidenca 1.8.2; 2.44). Këto raporte ofrojnë një pasqyrë të fushave të studimit që ofron Universiteti i Tiranës dhe rolin e tyre në përgatitjen e të diplomuarve për tregun e punës, duke reflektuar tendencat aktuale të kërkesës dhe ofertës në punësim. Në analizat përfshihen edhe faktorë si vështirësitë në punësim dhe ndikimi i cilësisë së programeve të studimit në lehtësimin e këtij procesi (Evidenca 1.8.1). Përveç kësaj, në fund të çdo semestri, çdo pedagog plotëson pyetësorin e vetëvlerësimit për lëndët që mbulon, duke reflektuar mbi rezultatet e studentëve dhe shpërndarjen e notave, dhe duke dhënë sugjerime për përmirësime në përputhje me standardet e ASCAL (Evidenca 6.3). Në mënyrë të ngjashme, me miratimin e Rregullores për vlerësimin e performancës së personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT (Evidenca 6.12), edhe ky kontingjent është përfshirë në procesin e vlerësimit të cilësisë së programeve mësimore (Evidenca 6.12).
Konkluzione	<i>Universiteti i Tiranës ka ndërtuar dhe zbatuar një sistem funksional e gjithëpërfshirës për monitorimin dhe vlerësimin periodik të programeve të studimit, me qëllim garantimin e arritjes së objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet. Procesi i vlerësimit kryhet në mënyrë të dokumentuar, të strukturuar dhe me pjesëmarrjen e të gjitha njësive përkatëse në nivel institucional dhe fakulteti. Raportet e analizave përfshijnë identifikimin e praktikave të mira, evidentimin e dobësive dhe marrjen e masave për përmirësim të cilësisë akademike. Për më tepër, përdoren metoda të ndryshme vlerësimi, si ato të</i>

	drejtpërdrejta (pyetësorë, analiza të mësimdhënies, vëzhgime dhe testime) dhe të tërthorta (sondazhe me studentë, alumni, punëdhënës dhe staf). Këto mjete vlerësimi sigurojnë një pasqyrë të qartë dhe të qëndrueshme mbi performancën e programeve, përputhshmërinë me nevojat e tregut të punës dhe përshtatjen e përhershme me standardet kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVJ) vlerëson se Universiteti i Tiranës, nëpërmjet Fakultetit të Shkencave të Natyrës, ka arritur të krijojë një mekanizëm funksional për përfshirjen e aktorëve të ndryshëm në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Përfaqësues të departamenteve marrin pjesë në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe në Komisionin e Kurrikulës, duke kontribuar në mbikëqyrjen dhe zhvillimin e programeve (Evidenca 1.36; 3.13). Studentët kanë një rol aktiv në këtë proces, përmes plotësimit të pyetësorëve periodikë të vlerësimit, të cilët ofrojnë të dhëna të rëndësishme për përmirësimin e mësimdhënies dhe të përvojës së tyre akademike (Evidenca 2.42; 2.43; 6.6; 2.44; 6.21; 6.7). GVJ vlerëson pozitivisht edhe përfshirjen e aktorëve të jashtëm, e cila realizohet kryesisht përmes takimeve me ALUMNI, të organizuara nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës. Këto takime krijojnë mundësi të vlefshme komunikimi me ish-studentët dhe institucionet ku ata punojnë, duke e bërë të mundur që feedback-u i tyre të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit (Evidenca 5.41).
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë	Në nivel universiteti, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) është struktura e caktuar nga Senati Akademik për të garantuar standardet e cilësisë në institucion dhe në programet e studimit. Ai përbëhet nga 11

të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	anëtarë: 8 janë pjesë e stafit akademik dhe 3 janë studentë. Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) përfaqësohet në këtë komision nga një anëtar akademik (Evidenca 3.13). Universiteti i Tiranës ka ngritur Sektorin e Sigurimit të Cilësisë (Evidenca 5.46), një strukturë ndihmëse-akademike që zbaton politikat për cilësinë dhe mbështet veprimtarinë e KPSSC dhe Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në njësitë kryesore. Për të garantuar mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë, FSHN ka krijuar NJSBC dhe Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) (Evidenca 6.4; 6.16). Këto struktura gëzojnë pavarësi operacionale dhe akses në të dhënat e njësive kryesore (Evidenca 5.46). Veprimtaria e tyre bazohet në “Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës”, si dhe në “Manualin e Cilësisë” dhe “Paketën e Instrumenteve të Cilësisë”, të miratuara nga Senati Akademik (Evidenca 6.14; 6.15; 6.5; 6.3). Për monitorimin dhe rishikimin e programeve të ciklit të dytë, drejtuesit e departamenteve bashkëpunojnë me zëvendësdekanët për kurrikulat dhe për kualifikimin shkencor, të cilët koordinojnë raportimet mbi aktivitetin mësimor dhe kërkimor (Evidenca 1.35).
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Grupi i Vlerësimit të jashtëm vlerëson se sigurimi i cilësisë në programet e studimit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës është i strukturuar mirë dhe mbështetet në bashkëpunimin mes njësive kryesore dhe atyre bazë. Në këtë kuadër, FSHN për gatit raporte vjetore ku pasqyrohet në mënyrë të detajuar veprimtaria akademike dhe kërkimore, duke përdorur tregues të qartë për vlerësimin e cilësisë (Evidenca 1.35). Në të njëjtën linjë, Departamenti i Kimisë Industriale harton analizat e veta vjetore, duke vlerësuar ecurinë e programeve mbi bazën e indikatorëve matës të përcaktuar (Evidenca 1.40). Një rol të rëndësishëm në këtë proces e kanë edhe studentët, të cilët plotësojnë pyetësorë vlerësimi në fund të çdo semestri. Këto të dhëna përdoren për të identifikuar pikat që duhen përmirësuar dhe për të hartuar masa konkrete për rritjen e cilësisë së mësimdhënies (Evidenca 1.1; 2.42; 2.43; 6.6; 2.44; 6.21; 6.10). GVJ vëren se praktika e lejuar për ndryshime deri në 20% të planit mësimor, kur ka rekomandime të justifikuara, është një mekanizëm fleksibil që ndihmon përshtatjen e kurrikulave me nevojat reale (Evidenca 2.31; 2.32). Për më tepër, Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) kontribuon përmes raporteve të saj vjetore, duke rritur transparencën dhe duke

	garantuar një proces të qëndrueshëm përmirësimi (Evidenca 6.6; 6.14). Në këtë kuadër, përgjegjësit e departamenteve, së bashku me titullarët e grup-lëndëve dhe stafin akademik e ndihmës-akademik, angazhohen në monitorimin e zbatimit të programeve, të veprimtarive kërkimore dhe zhvillimeve të tjera akademike (Evidenca 2.13).
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Konstatohet se Universiteti i Tiranës ka ngritur struktura të posaçme që garantojnë funksionimin e proceseve të rregullta të sigurimit të cilësisë. Në këtë kuadër, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës (Evidenca 3.13; 1.36), në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (Evidenca 6.4; 6.16), mbulojnë zbatimin dhe monitorimin e proceseve periodike të vlerësimit. GVJ thekson se këto struktura funksionojnë mbi bazën e parimeve të integritetit akademik, duke garantuar trajtim të barabartë për stafin dhe studentët dhe duke shmangur çdo formë diskriminimi (Evidenca 3.12). Veprimtaria e tyre udhëhiqet nga dokumente themelore si “Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë në UT”, e miratuar nga Senati Akademik, “Manuali i Cilësisë”, “Paketa e Instrumenteve të Cilësisë” dhe “Kodi i Etikës” (Evidenca 6.14; 6.15; 6.5; 6.3). GVJ vlerëson se këto instrumente rregullative krijojnë bazën për një përmirësim të vazhdueshëm të standardeve akademike dhe të cilësisë së arsimit të lartë.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Bashkëpunëtorët e jashtëm luajnë një rol të rëndësishëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këtë drejtim, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) bashkëpunon me institucione të ndryshme, përfaqësues të biznesit dhe kompani, përmes marrëveshjeve që synojnë ofrimin e ekspertizës dhe kontributeve të vlefshme për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit (Evidenca 1.22; 1.48; 1.35; 5.21). Një tjetër formë e përfshirjes së aktorëve të jashtëm realizohet përmes organizimit të Panairit të Karrierës nga Universiteti i Tiranës dhe FSHN, që synon t'i ndihmojë studentët në orientimin drejt tregut të punës dhe të krijojë mundësi konkrete për punësim apo praktika profesionale (Evidenca 5.22). Në këto evente marrin pjesë institucione publike dhe kompani private, të cilat prezantojnë pozicionet e tyre vakante dhe diskutojnë mundësi për bashkëpunime të mëtejshme (Evidenca 1.22), si dhe ofrojnë sugjerime për përmirësimin e përmbajtjes së kurrikulave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Për më

	tepër, FSHN ka marrë pjesë në Panairin “Ëork and Study – Punë dhe Aftësi”, një aktivitet ku janë të pranishëm edhe përfaqësues të Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (Evidenca 6.20), duke thelluar kështu bashkëpunimin me faktorët jashtë akademisë për të forcuar lidhjen midis arsimit dhe punësimit.			
Konkluzione	<i>Universiteti i Tiranës ka ndërtuar dhe zbatuar me sukses një sistem të hapur dhe gjithëpërfshirës për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ku aktorët kryesorë të brendshëm dhe të jashtëm – përfshirë stafin akademik, studentët, njësitë akademike dhe bashkëpunëtorët institucionalë – luajnë një rol aktiv dhe të strukturuar në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Proceset e sigurimit të cilësisë mbështeten në një kornizë të qartë rregullatore, në struktura të përcaktuara qartësisht dhe në dokumente udhëzuese si Manuali i Cilësisë dhe Paketa e Instrumenteve të Cilësisë. Përfshirja e studentëve nëpërmjet pyetësorëve periodikë dhe pjesëmarrjes së tyre në komisione përfaqëson një përfshirje reale në proceset vendimmarrëse. Po ashtu, përfshirja e bashkëpunëtorëve të jashtëm përmes takimeve me alumni, marrëveshjeve me kompani dhe organizimit të aktiviteteve si Panairi i Karrierës, forcon lidhjen mes arsimit dhe tregut të punës. Gjithashtu, të gjitha proceset e vlerësimit dhe përmirësimit zbatohen në përputhje me parimet e integritetit akademik, duke garantuar barazi, transparencë dhe respekt ndaj të gjitha palëve të përfshira. Kjo tregon për një qasje të konsoliduar ndaj cilësisë në arsimin e lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për	Transparenca është një element i dukshëm në politikat, strategjitë dhe aktivitetet e Universitetit të Tiranës dhe të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Informacioni i nevojshëm për personelin akademik dhe studentët publikohet në mënyrë të rregullt në faqet zyrtare të internetit, duke garantuar akses të plotë dhe komunikim

studentët dhe të gjithë të interesuarit.	të hapur. Përveç kësaj, dokumente të rëndësishme institucionale si Statuti, rregulloret, raportet vjetore të UT-së (Evidenca 6.20), raportet e përvitshme të Fakultetit (Evidenca 1.35) dhe analizat e detajuara të departamenteve (Evidenca 1.40) pasqyrojnë qartë këtë angazhim për llogaridhënie. GVJ vëren gjithashtu se një rol të rëndësishëm luajnë raportet periodike të përgatitura nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), të cilat mbështeten në pyetësorët e plotësuar nga studentët (Evidenca 1.1; 2.42; 2.43; 6.6; 2.44; 6.21; 6.7; 6.10). Këto raporte jo vetëm që ofrojnë një panoramë mbi gjendjen aktuale të cilësisë, por shërbejnë edhe si instrument për përmirësimin e saj të vazhdueshëm. GVJ e konsideron të rëndësishme faktin se raportet vjetore të DSBCK kontribuojnë në forcimin e kulturës së përgjegjshmërisë dhe në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të strukturave akademike.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Grupi i Vlerësimit të Jahtem vlerëson se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (Evidenca 6.4; 6.16) luajnë një rol kyç në monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Përmes analizimit dhe publikimit periodik të rezultateve të pyetësorëve të studentëve, ato sigurojnë që për çdo lëndë të programeve të studimit të ketë një pasqyrim të qartë të performancës dhe të elementëve që kërkojnë përmirësim. GVJ thekson se këto raporte hartohen dhe shpërndahen në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht me kërkesat e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, të ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Kjo tregon përkushtimin e institucionit jo vetëm për transparencë dhe cilësi, por edhe për respektimin e standardeve ligjore që garantojnë mbrojtjen e të dhënave të studentëve dhe stafit.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Procesi i shpërndarjes dhe përdorimit të raporteve të cilësisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës është i strukturuar në mënyrë funksionale dhe ndihmon në qarkullimin e informacionit brenda të gjitha niveleve. Raportet e hartuara nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) i përcillen fillimisht Dekanatit, i cili më pas ua dërgon drejtuesve të departamenteve (Evidenca 6.8). Këta të fundit bëjnë prezantimin e përmbajtjes për personelin akademik, thërrasin mbledhje dhe koordinojnë diskutimet me titullarët e grupeve mësimore-kërkimore (Evidenca 6.9; 2.13). Vlerësohet se ky mekanizëm ndihmon që gjetjet e raporteve të përkthehen në veprime konkrete. Kjo reflektohet në analizat vjetore të departamenteve (Evidenca 1.39) dhe në planet e masave që hartohen për adresimin e dobësive të evidentuara gjatë

	procesit të vlerësimit (Evidenca 1.40). Në këtë mënyrë sigurohet që feedback-u i mbledhur të mos mbetet formal, por të shndërrohet në një instrument real për përmirësimin e cilësisë akademike dhe organizative.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në procesin e monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) ka mundësi të bëjë rishikime në planet mësimore, kur kjo konsiderohet e nevojshme, deri në një kufi maksimal prej 20% (Evidenca 2.31; 2.32). Këto përditësime synojnë përmirësimin e përmbajtjes së lëndëve dhe përshtatjen e tyre me standardet bashkëkohore (Evidenca 1.30). FSHN, nëpërmjet Departamentit të Kimisë Industriale, zhvillon dhe rishikon programet e studimit duke u mbështetur në sugjerimet e marra dhe në bashkëpunim me kompani dhe institucione partnere me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi (Evidenca 1.22).
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Departamenti i Kimisë Industriale ka krijuar një kulturë pune të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. Mbledhjet e rregullta të departamentit shërbejnë si forume diskutimi ku shqyrtohen çështje me rëndësi për zhvillimin afatgjatë të programeve (Evidenca 6.22). GVJ e konsideron gjithashtu të vlefshme përfshirjen e ish-studentëve (ALUMNI) në këto procese, pasi takimet e organizuara me ta, ku marrin pjesë edhe pedagogët e departamentit, ofrojnë mundësi për shkëmbim përvojash dhe sugjerimesh praktike (Evidenca 5.41). Një tjetër element i rëndësishëm është bashkëpunimi me kompani dhe institucione të jashtme, i cili ndihmon në përshtatjen e programeve akademike me kërkesat reale të tregut të punës dhe rrit lidhjen mes universitetit dhe sektorit profesional (Evidenca 1.22).
Konkluzione	<i>Universiteti i Tiranës, nëpërmjet strukturave përgjegjëse si Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe në veçanti Departamenti i Kimisë Industriale, ka ngritur dhe zbatuar një sistem të brendshëm sigurimi cilësie që karakterizohet nga transparenca, përfshirja dhe efektiviteti, duke synuar krijimin dhe forcimin e një kulture të qëndrueshme cilësie. Politikat dhe aktivitetet e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë janë të dokumentuara dhe publikohen rregullisht në faqet zyrtare, duke i bërë ato të aksesueshme për studentët, stafin dhe palët e tjera të interesuara. Publikimi i rezultateve të vlerësimeve respekton integritetin akademik dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Çdo raport i vlerësimit shoqërohet me një plan konkret masash që adreson dobësitë dhe synon përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Për më tepër, universiteti vlerëson ndikimin e këtyre veprimtarive</i>

	<i>përmes rishikimit të vazhdueshëm të përmbajtjeve kurrikulare dhe adaptimit të tyre ndaj zhvillimeve shkencore dhe kërkesave të tregut të punës. Organizimi i aktiviteteve me studentë, alumni dhe partnerë të jashtëm ndihmon në ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të të gjithë aktorëve në përmirësimin afatgjatë të cilësisë akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave, Program i Integruar i Nivelit të Dytë “Inxhinieri e Proceseve Kimike” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi Master Shkencor në “Inxhinieri të Proceseve Kimike” është konceptuar për të ofruar një formim të plotë teorik dhe praktik, në përputhje me nevojat e tregut të punës. (Standardi I.1, Kriteri 2, 3 dhe 4; si dhe Standardi II.1, Kriteri 2)
2. Literatura është e përditësuar, stafi akademik plotëson kriteret ligjore për mbulimin e programit të studimit dhe kontribuojnë në ofrimin e njohurive të thelluara dhe kompetencave profesionale bashkëkohore. (Standardi II.1, Kriteri 2; Standardi II.4, Kriteri 4; Standardin II.2, Kriteri 1, 2 dhe 3; Standardi IV.3 Kriteret 1 dhe 2; Standardi IV.1, Kriteret 1 dhe 2)
3. Angazhimi i vazhdueshëm i stafit për përmirësimin e cilësisë, bashkëpunimi me industrinë dhe përfshirja në projekte ndërkombëtare si Erasmus+, e bëjnë programin tërheqës për tregun e punës. (Standardi I.3, Kriteri 2 dhe 3; Standardi VI.1, Kriteri 1; Standardi VI, Kriteri 5)
4. Të diplomuarit integrohen me sukses në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar dhe arrijnë pozicione të rëndësishme në sektorin publik dhe privat. (Standardi V.3, kriteret 1,2,3 dhe 4; Standard V.6, Kriteri 3 dhe 4)

Pika të dobëta

1. Raportet e vlerësimit të brendshëm për cilësinë dhe ndikimi i tyre në përmirësimin konkret të kurrikulës kërkojnë pjesmarrjen e një numri më të madh të studentëve gjatë plotësimit të pyetësorëve. (Standardi VI.1, Kriteret 1,2,3 dhe 4)
2. Në këtë program studimi ka të angazhuar edhe staf akademik me MSC në mosopërputhje me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik. (Standardi II.2, Kriteri 1 dhe 2; Standardi IV.1, Kriteri 1)

Rekomandime

1. Përforcimi i përdorimit të teknologjive moderne në procesin mësimor dhe vlerësues, me qëllim rritjen e interaktivitetit dhe përfshirjes së studentëve. (Standardi IV.2, Kriteret 1, 2, 3, 4); Standardi V.5, Kriteri 4; Standardi III.1, Kriteri 2)
2. Formalizimi i mekanizmave të mbledhjes së të dhënave për vlerësimin e cilësisë, dhe përfshirja më e gjerë e studentëve, alumni-t dhe aktorëve të jashtëm në përmirësimin e programit. (Standardi II.5, Kriteri 1,2 dhe 3)

3. Vijimi i bashkëpunimit me industrinë dhe shoqatat profesionale për të përmirësuar përmbajtjen e kurrikulës dhe për të forcuar komponentin praktik të programit. (Standardi I.3, Kriteri 2–3)
4. Përfshirja në Kurrikul e modulit “Praktikë Profesionale”. (Standardi II.4, Kriteri 2,3,4,5 dhe 6); Standardi II.3, Kriteri 1,2)
5. Gjatë shpalljes për rekrutim të stafit akademik rekomandohet që të publikohen pikët që përfaqëson dosja e kandidatit dhe pikët e intervistës paraparkisht për të rritur transparencën. (Standardi IV.1, Kriteri 4)
6. Institucioni në këtë program studimi, të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik. (Standardi II.2, Kriteri 1 dhe 2; Standardi IV.1, Kriteri 1)

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master of Science, Integrated Second Level Program "Chemical Process Engineering" offered by the Higher Education Institution "University of Tirana"

Strengths and affirmations

1. The Master of Science program in "Chemical Process Engineering" is designed to provide a complete theoretical and practical training, in line with the needs of the labor market. (Standard I.1, Criteria 2, 3 and 4; Standard II.1, Criteria 2)
2. The literature is up-to-date, the academic staff meets the legal criteria for covering the study program and contributes to the development of in-depth knowledge and contemporary professional competencies. (Standard II.1, Criteria 2; Standard II.4, Criteria 4; Standard II.2, Criteria 1, 2 and 3; Standard IV.3, Criteria 1 and 2; Standard IV.1, Criteria 1 and 2)
3. The continuous commitment of the staff to improve quality, cooperation with industry and involvement in international projects such as Erasmus+, make the program attractive for the labor market. (Standard I.3, Criteria 2 and 3; Standard VI.1, Criteria 1; Standard VI, Criteria 5)
4. Graduates successfully integrate into the national and international labor market and reach important positions in the public and private sectors. (Standard V.3, Criteria 1, 2, 3 and 4 Standard V.6, Criteria 3 and 4)

Weaknesses

1. Internal evaluation reports on their quality and impact on concrete curriculum improvement require the participation of a larger number of student's when completing questionnaires (Standard VI.1, Criteria 1, 2, 3 and 4).
2. This study program engages academic staff with MSc Degree, which is not in compliance with the applicable legal requirements for the appropriate level of academic qualification. (Standard II.2, Criteria 1 and 2; Standard IV.1, Criteria 1)

Recommendation

1. To strengthen the use of modern technologies in the teaching and assessment process, in order to increase the interactivity and involvement of students. (Standard IV.2, Criteria 1, 2, 3, 4; Standard V.5, Criteria 4; Standard III.1, Criteria 2)
2. Formalizing data collection mechanisms for quality assessment, and involving students, alumni, and external stakeholders in improving the program. (Standard II.5, Criteria 1, 2 and 3)
3. Continuing to collaborate with industry and professional associations to improve curriculum content and strengthen the practical component of the program. (Standard I.3, Criteria 2-3)

4. Inclusion in the Curriculum of the "Professional Practice" module. **(Standard II.4, Criteria 2, 3, 4, 5 and 6; Standard II.3, Criteria 1 and 2)**
5. During the announcement for recruitment of academic staff, it is recommended to publish the points represented by the candidate's file and the interview points in advance to increase transparency. **(Standard IV.1, Criteria 4)**
6. In this study program, the institution shall engage in teaching academic staff holding at least the scientific degree of Doctor (PhD) (Or higher than PHD), in accordance with the legal requirements in force for the appropriate level of academic qualification. **(Standard II.2, Criteria 1 and 2; Standard IV.1, Criteria 1)**

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

